

**DHUNA NË FAMILJE**  
**NË SHQIPËRI**  
VROJTIM KOMBËTAR

# **DHUNA NË FAMILJE NË SHQIPËRI VROJTIM KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN**

**Instituti i Statistikave (INSTAT) Shqipëri**



**Mars 2009**

**Raport i përgatitur nga:**

Dr. Robin N. Haarr  
Konsulente Ndërkombëtare

dhe

Dr. Milika Dhamo  
Profesor i Asociuar



Ky projekt u mbështet nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (UNDP) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)

Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) apo Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

**TABELA E PËRMBAJTJES**

Falënderime .....	5
Lista e stafit të përfshirë në vrojtim .....	7

**Kapitulli 1: Hyrje**

Përshkrim i studimit .....	8
Ligjet shqiptare lidhur me dhunën në familje .....	10
Përse duhet të ndërmerret një studim kombëtar mbi dhunën në familje në Shqipëri .....	12
Referenca .....	13

**Kapitulli 2: Ndërtimi i kërkimit**

Përkufizime .....	14
Matja e dhunës në familje .....	15
Zhvillimi i vrojtimit .....	16
Struktura e vrojtimit .....	16
Marrja maksimale e informacionit .....	18
Ndërtimi i kampionit .....	18
Intervistuesit .....	19
Kryerja e vrojtimit në terren .....	19
Përpunimi dhe analizimi i të dhënave .....	19
Referenca .....	20

**Kapitulli 3: Demografia e kampionëve**

Demografia e familjeve .....	21
Demografia e grave .....	21
Demografia e fëmijëve .....	23

**Kapitulli 4: Dhuna në familje ndaj grave**

Dhuna në familje ndaj grave .....	25
Abuzimi emocional .....	25
Abuzimi psikologjik .....	29
Dhuna fizike .....	32
Dhuna seksuale .....	35
Llojet e ndryshme të dhunës në familje .....	38
Viti i martesës/lidhjes në të cilin fillon dhuna në familje .....	40
Dëmtimet që lidhen me dhunën në familje .....	41
Alkooli dhe dhuna në familje .....	44
Dhuna në familje dhe niveli arsimor i bashkëshortit .....	45
Dhuna në familje dhe statusi i punësimit të bashkëshortit .....	46
Dhuna në familje nga anëtarët e saj .....	47

Ndikimi i dhunës në familje te fëmijët .....	47
Kërkimi i ndihmës nga gratë e dhunuara .....	48
Referenca .....	49

### **Kapitulli 5: Dhuna në familje ndaj fëmijëve**

Dhuna në familje ndaj fëmijëve .....	51
Cilët anëtarë të familjes abuzojnë me fëmijët? .....	54
Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e abuzuar .....	55
Vetëdija e fëmijës për dhunën në familje ndaj nënës së tij/saj .....	56
Referenca .....	56

### **Kapitulli 6: Përfundime dhe rekomandime**

Dhuna në familje ndaj grave .....	57
Dhuna në familje dhe niveli arsimor .....	58
Dhuna në familje dhe statusi i punësimit .....	59
Dhuna në familje dhe mosha .....	59
Dhuna në familje dhe gjendja civile .....	59
Dhuna në familje dhe vendbanimi .....	60
Dhuna në familje ndaj fëmijëve .....	60
Teoritë mbi dhunën në familje .....	60
Referenca .....	63

Tabelat e shtojcës

## Falënderime

Ky raport kërkimi mbi dhunën në familje në Shqipëri është fryt i bashkëpunimit të ngushtë të shumë institucioneve dhe aktorëve. Ky projekt bazohet në pranimin e faktit që të dhënat kombëtare mbi dhunën në familje në Shqipëri janë të domosdoshme për zhvillimin e politikave dhe të planeve të veprimit për reagimin, ndërhyrjen dhe mbrojtjen në rastet e dhunës në familje.

Ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen dhe të falënderojmë UNICEF-in dhe PNUD-in për financimin dhe mbështetjen e këtij projekti kërkimi, si dhe punën e Komitetit Drejtues, të ekipit të ekspertëve, të ekspertëve të ndryshëm të ftuar, të kërkuesve këshillues dhe të konsulentëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Gjithashtu, ne dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen dhe t'i bëjmë një falënderim të veçantë Institutit të Statistikave në Shqipëri (INSTAT) si institucioni kryesor teknik që ka planifikuar dhe ka realizuar vrojtimin për herë të parë në Shqipëri dhe veçanërisht Dr. Ines Nurja, Drejtoreshë e Përgjithshme, për menaxhimin administrativ dhe teknik të këtij projekti. Përfshirja e ekspertëve të statistikave nga INSTAT-i ishte një bekim për Komitetin Drejtues dhe për ekipin e ekspertëve. Ekspertët e INSTAT-it shqyrtuan dhe hoqën pjesët e panevojshme të të dhënave, përcaktuan mënyrat e analizimit të të dhënave, bënë analizimin e tyre dhe nxorën rezultatet e këtij vrojtimi.

Anëtarët e Komitetit Drejtues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nga Universiteti i Tiranës dhe nga organizatat e shoqërisë civile ofruan gjithashtu një mbështetje dhe ndihmë të paçmueshme në hartimin dhe administrimin e këtij vrojtimi kombëtar mbi dhunën në familje, duke përfshirë përcaktimin e standardeve etike dhe të procedurave të sigurisë për intervistimin e grave dhe të fëmijëve.

Ne gjithashtu dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen dhe t'i bëjmë një falënderim të veçantë ekipit të ekspertëve të përbërë nga – Dr. Milika Dharmo, Dr. Edmond Dragoti, Lantona Sado, Aurela Bozo dhe Ledia Thomo – si edhe të kërkuesve këshillues të përbërë nga – Entela Lako, Floriana Hima dhe Emira Shkurti. Gjithashtu, dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen dhe t'i bëjmë një falënderim të veçantë konsulentës ndërkombëtare, Dr. Robin Haarr, e cila ka bërë analizimin përfundimtar të të dhënave, ka krijuar tabelat dhe shifrat përfundimtare, si dhe ka hartuar raportin përfundimtar.

Së fundmi, dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen dhe të falënderojmë familjet, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, të cilët morën pjesë në këtë kërkim, dhe që shpenzuan kohën e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve tona dhe ndanë me ne njohuritë dhe përvojën e tyre. I kërkojmë ndjesë kujtdo që mund të ketë mbetur pa u përmendur në mënyrë të paqëllimshme.

### **Rreth konsulentës ndërkombëtare**

Dr. Robin Haarr është eksperte e kriminologjisë/sociologe dhe Profesore e Asociuar e Studimeve të Drejtësisë Penale dhe Policore, si dhe Drejtoreshë e Institutit për Drejtësi dhe Siguri Globale pranë Universitetit të Eastern Kentucky. Dr. Haarr ka një përvojë shumë të madhe në hartimin dhe kryerjen e vrojtimit dhe të kërkimeve në terren, në analizimin e të dhënave cilësore dhe sasiore, në hartimin e raporteve teknike dhe kërkimore, si edhe në kryerjen e aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve në të gjithë ish-Bashkimin Sovjetik dhe në Azi mbi problemet e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, të dhunës në familje, të trafikut dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, të mbrojtjes së fëmijëve, të shërbimeve në mbështetje të viktimave për gratë e dhunuara dhe të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, si dhe zhvillimin e programeve dhe politikave sociale. Që prej vitit 2003, ajo ka punuar si konsulente ndërkombëtare pranë UNICEF-it, ILO-s, PNUD-it, OSBE-së dhe pranë Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim. Dr. Haarr ka punuar gjithashtu gjerësisht me Ambasadën e SHBA-së në Kinë, Vietnam, Kamboxhia, Laos, Malajzi, Burma/Mianmar, Indi dhe Pakistan për çështjet e dhunës ndaj grave dhe çështjet e trafikut të qenieve njerëzore. Dedikimi dhe drejtimi i saj për të reduktuar aspektet sociale, kulturore dhe institucionale të kësaj dhune dhe të këtij shfrytëzimi ka sjellë një ndryshim nga i cili përfitojnë gratë dhe fëmijët, familjet dhe komunitetet.

**[robinhaarr@yahoo.com](mailto:robinhaarr@yahoo.com)**

## **Lista e stafit të përfshirë në vrojtim**

---

### **Anëtarët e Komitetit Drejtues**

Prof. Dr. Bashkim Ruseti, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës  
Prof. Dr. Bukurie Dumani, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës  
Prof. Dr. Theodhori Karaj, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës  
Anna Xheka, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta  
Iris Luarasi, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza

### **Drejtor i projektit**

Dr. Ines Nurja, Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT)

### **Mbeshtetja nga OKB**

Entela Lako, PNUD Shqipëri  
Floriana Hima, UNICEF Shqipëri  
Alketa Zazo, UNICEF Shqipëri  
Dajena Pollo, UNICEF Shqipëri  
Emira Shkurti, PNUD Shqipëri

### **Koordinatorë e vrojtimeve**

Lantona Sado, Qendra për Kërkime Sociale, INSTAT

### **Ekipi i ekspertëve**

Dr. Milika Dharmo  
Dr. Edmond Dragoti  
Lantona Sado  
Aurela Bozo  
Ledia Thomo

### **Shkrimi i raportit (Rezultatet Paraprake)**

Dr. Milika Dharmo  
Aurela Bozo

### **Përpunimi/programimi i të dhënave**

Alma Spaho  
Ledia Thomo, INSTAT

### **Mbikëqyrëse e punës në terren**

Lorena Kola

### **Konsulente Ndërkombëtare**

Dr. Robin N. Haarr



## Kapitulli 1: Hyrje

### Përshkrim i studimit

Në Shqipëri, dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek individët, familjet dhe komunitetet (1). Megjithatë, shqiptarët janë të prirur ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare dhe si pjesë normale të jetës martesore dhe familjare. Duke qenë se dhuna në familje shpesh ndodh prapa dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, nuk rrëfëhet ose nuk trajtohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat vuajnë në mënyrë tipike në heshtje (2).

Dhuna në familje doli si çështje shqetësuese në Shqipëri në vitet '90 kur vendi po pësonte një ndryshim domethënës politik dhe shoqëror. Në vitin 1992, Partia e Punës së Shqipërisë, parti komuniste, ia dorëzoi pushtetin parlamentit të zgjedhur në mënyrë demokratike. Ky ndryshim i rëndësishëm politik i hapi rrugën Shqipërisë për asistencë, ekspertizë dhe investime të huaja, me qenë se vendi filloi procesin e tranzicionit dhe të reformimit të strukturave të tij ekonomike, ligjore dhe politike (3). Së bashku me këtë tranzicion erdhi edhe një fluks organizatash ndërkombëtare për të mbështetur reformën dhe riorganizimin, dhe solli edhe krijimin e organizatave lokale joqeveritare (OJQ). Disa nga këto organizata u fokusuan në çështjet e grave, duke përfshirë dhunën ndaj tyre dhe të drejtat e grave. Megjithëse dhuna në familje ka ekzistuar shumë kohë përpara kësaj periudhe tranzicioni, sipas raporteve numri i rasteve të dhunës në familje u përshkallëzua në vitet '90 duke qenë se familjet u përballën me një stres dhe presion të madh të lidhur me tranzicionin (p.sh. nivelet e larta të papunësisë, mungesa e strehimit, përshkallëzimi i shqetësimeve sociale dhe krimet e dhunshme në rrugë).

Është e rëndësishme të theksohet se dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve nuk është një fenomen i ri në Shqipëri, por ajo ka rrënjë të thella kulturore në shoqëri. Rrënjët e saj shtrihen

në traditat dhe zakonet patriarkale të rrënjësura thellë, si për shembull identitetet dhe rolet e rrepta gjinore, autoriteti patriarkal, zbatimi i një sistemi nderi dhe turpi, dhe zakonet e rendit hierarkik në familje, si dhe kontrolli i anëtarëve të familjes, elemente të cilat kanë zënë vend për një kohë të gjatë në shoqërinë shqiptare.

Sundimi komunist dyzetvjeçar në Shqipëri (1946 – 1991) nuk i zhduku plotësisht qëndrimet patriarkale të rrënjësura thellë, duke përfshirë edhe ato që lidhen me Kanunin e Lekë Dukagjinit, të cilat zbatoheshin në disa zona të Shqipërisë. Në fakt, burrat dhe gratë në disa pjesë të Shqipërisë ende i referohen Kanunit për të shpjeguar qëndrimet dhe opinionet në lidhje me rolet gjinore dhe autoritetin patriarkal, duke përfshirë të drejtën e burrit për ta “ndëshkuar” gruan e tij, e cila konsiderohet si pronë e tij (3,4).

Që prej rënies së komunizmit në vitin 1991, qeveria e sapokrijuar e Republikës së Shqipërisë ratifikoi një sërë konventash të rëndësishme, ku përfshihen:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar më 27 shkurt 1992.
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, e ratifikuar më 11 maj 1994.
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e ratifikuar më 11 maj 1994.
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollit përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të ratifikuara më 10 shkurt 1996.

- Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese, e ratifikuar më 10 shkurt 1996.

Në vitin 1994, qeveria e Republikës së Shqipërisë ratifikoi Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Që atëherë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të lokale kanë punuar në bashkëpunim me qeverinë shqiptare për të trajtuar çështje të dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën ndaj grave në familje. Përpjekjet e bashkëpunimit përfshijnë zhvillimin e masave parandaluese (p.sh. iniciativat edukative dhe fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit publik), masat mbrojtëse (p.sh. shërbimet për mbrojtjen e viktimave, shërbimet këshilluese dhe qendrat e strehimit për dhunën në familje) dhe masat ligjore (p.sh. legjislatiioni për dhunën në familje, i cili mbron viktimat e dhunës në familje dhe dënon dhunuesit) për trajtimin e dhunës në familje. Ky vrojtim kombëtar mbi dhunën në familje është vetëm një nga iniciativat bashkëpunuese, i ndërmarrë me qëllimin e nxjerrjes së të dhënave dhe të rezultateve të besueshme rreth natyrës dhe përhapjes së dhunës në familje në Shqipëri. Objektivi i vrojtimit është të nxjerrë rezultate që mund të përdoren për të nxitur zhvillimin e politikave dhe masave efikase parandaluese, mbrojtëse dhe atyre ligjore.

Në vitin 1992, qeveria e Shqipërisë ratifikoi Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC). KDF e OKB-së përcakton një autorizim të qartë të shtetit për t'i mbrojtur fëmijët nga të gjitha llojet e dhunës në shtëpi dhe familje, dhe përcakton rolin e tij si arbitrin përfundimtar të mirëqenies së fëmijës në ambientin familjar. Me qenë se shteti nuk mund të konsiderohet drejtpërdrejt përgjegjës për aktet e veçanta të dhunës ndaj fëmijëve nga ana e prindërve, atij i kërkohet të përcaktojë një kuadër ligjor dhe masa të tjera të nevojshme për të siguruar mbrojtje të përshtatshme, duke përfshirë parandalimin efikas (5).

Në vitin 1998, shteti shqiptar miratoi Kushtetutën e re të Shqipërisë. Kushtetuta garanton parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si edhe mbrojtjen dhe respektin për dinjitetin, të drejtat dhe liritë e njeriut. Kështu për shembull, nëni 18 pika 2 përcakton, “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të

diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës dhe të bindjeve politike, fetare apo filozofike, si dhe të gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale”. Neni 54 pika 3 përcakton më tej se çdo fëmijë, veçanërisht nën moshën minimale për punë, ka të drejtë të jetë “i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe detyrimi për punë, që mund të dëmtojnë shëndetin dhe moralin ose të rrezikojnë jetën apo zhvillimin e tij normal”.

Në vitin 2006, për të trajtuar në mënyrë specifike dhunën në familje, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta hartoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje për periudhën 2007-2010, së bashku me një Plan Veprimi Kombëtar. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit ishin një “tregues i angazhimit politik të qeverisë shqiptare për të siguruar lëvizjen dhe arritjen e barazisë gjinore me një instrument politikash të sinkronizuara me iniciativat e shoqërisë civile” (6). Strategjia Kombëtare synon të:

- arrijë barazinë gjinore nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e politikave të zhvilluara dhe të zbatuara (pra, pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në sferën sociale, ekonomike dhe politike), me mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat dhe për të vendosur potencialin e tyre individual në shërbim të shoqërisë dhe;
- përmirësojë mbrojtjen, performancën e sistemit gjyqësor dhe mbështetjen për viktimat e dhunës në familje, si edhe të fokusohet në mënyrë më specifike te parandalimi duke goditur shkaqet rrënjësore të dhunës në familje.

Aktualisht në Shqipëri një numër relativisht i vogël organizatash ndërkombëtare dhe OJQ-sh lokale po punojnë për të trajtuar dhunën në familje dhe ato po kërkojnë me ngulm rritjen e mbështetjes për gratë e dhunuara. Këto organizata po zhvillojnë trajnime për avokatët e viktimave, këshilluesit për krizat, punonjësit e kujdesit shëndetësor, forcat e rendit publik, dhe magjistratët dhe oficerët gjyqësorë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për dhunën në familje, për të rritur të kuptuarit nga ana e tyre të viktimave dhe të autorëve të dhunës, për të rritur kualifikimet e tyre për reagimin ndaj dhunës në familje dhe për të ofruar mbështetje për gratë e dhunuara dhe për fëmijët e tyre, si edhe për të zgjeruar njohuritë e tyre dhe kuptimin e ligjit të ri “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet

Familjare”. Këto organizata po ndërmarrin gjithashtu hapa për të shtuar shërbimet në mbështetje të viktimave për gratë e dhunuara dhe për fëmijët e tyre; megjithatë, qendrat e krizave dhe të strehimit për gratë e dhunuara dhe për fëmijët e tyre janë të pakta dhe larg njëra-tjetrës në Shqipëri.

### Ligjet shqiptare lidhur me dhunën në familje

Në vitin 2006, parlamenti shqiptar kaloi ligjin “Për Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i cili kishte si qëllim të parandalonte dhe të reduktonte dhunën në familje në të gjitha format e saj nëpërmjet masave të përshtatshme ligjore dhe t’u garantonte mbrojtje nëpërmjet mjeteve ligjore anëtarëve të familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje.<sup>1</sup>

Ligji ka katër objektiva kryesore:

1. krijimin e një rrjeti të koordinuar autoritetesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
2. orientimin e përpjekjeve për krijimin e strukturave dhe të autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për mbështetjen e viktimave dhe për parandalimin e dhunës në familje;
3. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje; dhe
4. sigurimin/garantimin e shërbimeve të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta për viktimat e dhunës në familje të ofruara nga gjykatat dhe nga agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit, në përputhje me ligjin.

Ligji përkufizon si dhunë “çdo veprim ose mosveprim të një personi ndaj një tjetri, që sjell si pasojë një cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik”. Në vijim, si dhunë në familje përkufizohet “çdo akt dhune i ushtruar ndërmjet personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”. Sipas ligjit, te pjesëtarët e familjes përfshihen:

- a. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesit ose ish-bashkëshorti/ja ose ish-partneri/ja bashkëjetues;
- b. vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë,

- a. përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
- c. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;
- d. gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es;
- e. vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;
- f. fëmijët e bashkëshortëve apo të partnerëve bashkëjetues.

Ligji parashikon masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga gjykata (një vendim i lëshuar nga gjykata, i cili parashikon masat mbrojtëse për viktimën) dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (një urdhër i përkohshëm nga gjykata, i cili është i vlefshëm derisa ajo të lëshojë një urdhër mbrojtjeje). Kur kërkesa për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje paraqitet nga policia ose nga prokurori, edhe nëse viktimë (nën presion) dëshiron ta tërheqë padinë/paditë ose ta pushojë çështjen, kjo nuk do të ndikojë në vazhdimin e procesit gjyqësor. Dhe meqë gruaja e dhunuar është dëshmitarja kryesore, ligji e përkufizon atë si “dëshmitare e detyruar për të dëshmuar”.

Moszbatimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje përbën vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal; për pasojë, autori i saj mund të arrestohet pa mandat arresti.

Në Shqipëri, megjithëse kompetencat e policisë për të hyrë në ambientet private janë përgjithësisht të kufizuara, ky ligj parashikon që policia mund të hyjë në një banesë private në kushtet e dhunës në familje nëse një gjë e tillë kërkohet nga një person, i cili në dukje banon në atë ambient ose nëse punonjësi i policisë ka arsye të besojë që një person në ambient është subjekt i një sulmi ose rrezikon të sulmohet.

Është e rëndësishme të theksohet se ligji organizon gjashtë institucione qeveritare në një rrjet të koordinuar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, për lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Autoriteti drejtues sipas këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë

<sup>1</sup> Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006.

Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Sipas ligjit “Për Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, lëshimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk i ndalon palët e interesuara të nisin gjithashtu një proces penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që klasifikohen si vepra penale. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, ekzistojnë dispozita të tjera që mund të zbatohen për të trajtuar krimet lidhur me dhunën në familje; disa prej tyre lidhen me abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve. Këto vepra penale përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- Neni 76: Vrasja e kryer me dashje (dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet).
- Neni 77: Vrasja me dashje që lidhet me një krim tjetër (vrasje me dashje që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me jo më pak se 20 vjet burgim).
- Neni 78: Vrasja me paramendim (vrasja me paramendim dënohet me burgim nga 15 deri në 20 vjet; vrasja e kryer për interes, hakmarrje ose gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se 25 vjet ose me burgim të përjetshëm).
- Neni 79: Vrasja me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës (e kryer ndaj një të mituri, ndaj një personi me aftësi të kufizuara fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; kundër një dëshmitari denoncues [të veprës penale], viktimës, palëve të tjera ndërgjyqëse; më shumë se një herë; kundër dy ose më shumë personave; në mënyrë të tillë që i shkakton vuajtje të veçanta viktimës, dënohet me jo më pak se 25 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm).
- Neni 84: Kanosja (kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit).<sup>2</sup>
- Neni 88: Plagosja e rëndë me dashje (plagosja

e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, shkaktimin e ndërprerjes së shtatzënisë ose që ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet; kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet).

- Neni 89: Plagosja e lehtë me dashje (plagosja e lehtë me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet).
- Neni 90: Dëmtime të tjera me dashje (rrahja), si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë; kur kjo vepër ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj).
- Neni 91: Plagosja e rëndë nga pakujdesia (plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit).
- Neni 92: Plagosja e lehtë nga pakujdesia (plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë).
- Neni 93: Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas (ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet).
- Neni 102: Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet; kur marrëdhënia seksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasojat të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë deri në 15 vjet; kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen apo vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet).
- Neni 106: Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale midis prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini, ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo birësimi, dënohet me burgim deri në shtatë vjet).

<sup>2</sup> Zyra për Monitorimin e Veprimtarisë së Prokurorisë pohon se midis rasteve të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Tiranë në periudhën 2000-2004, shumica e rasteve të shqyrtuara nga gjykata ishin për dhunë (47%), për dëmtim të lehtë të qëllimshëm (19,6%) dhe për kanosje (15,8%).

- Neni 124: Braktisja e fëmijëve të mitur (braktisja e fëmijës nën moshën 16 vjeç nga prindi ose nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet; kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet).
- Neni 125: Mosdhënia e mjeteve për jetesë (mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit).

Sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 dhe 106 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e palës së dëmtuar, e cila mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Me fjalë të tjera, çështja shqyrtohet vetëm nëse viktimë paraqet një ankim, dhe zakonisht përgatitja e të gjithë çështjes është përgjegjësi e viktimës. Viktimë duhet të mbledhë prova dhe dëshmitarë dhe ta paraqesë çështjen në gjykatë. Shteti përgjithësisht nuk asiston në ndjekjen penale (7).

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përmban gjithashtu një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj një bashkëshorti dhe fëmijës/fëmijëve. Kodi i Familjes trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve. Për shembull, neni 62 parashikon që “bashkëshorti abuzues mund të detyrohet të largohet nga banesa bashkëshortore”. Megjithatë, ky nen nuk ka dispozita të tjera procedurale.

Gjithashtu, ligji “Për Shëndetin Riprodhues” përcakton që çdo grua duhet të vendosë me vullnetin e saj të lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, presioni, ose dhune, për të gjitha çështjet në lidhje me seksualitetin e saj dhe me shëndetin e saj seksual dhe riprodhues.<sup>3</sup>

## **Përse duhet të ndërmerret një studim kombëtar mbi dhunën në familje në Shqipëri?**

Kërkimet mbi dhunën në familje në Shqipëri janë tepër të kufizuara, dhe të dhënat rreth llojit dhe shtrirjes së dhunës në familje në Shqipëri janë të pakta. Rrjedhimisht, nuk ekziston një tablo e qartë e gjendjes së dhunës në familje në Shqipëri.

Qëllimi i këtij vrojtimi kombëtar të popullatës ishte mbledhja e të dhënave të besueshme dhe nxjerrja e rezultateve që do të mundësonin një kuptim më të mirë të llojit dhe të shtrirjes së dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në familje në Shqipëri. Gjithashtu objektivat kryesore të këtij kërkimi ishin:

- zhvillimi i një matjeje pikënisjeje për dhunën në familje ndaj grave dhe fëmijëve në Shqipëri, kundrejt së cilës mund të krahasohen matjet në të ardhmen; dhe
- nxjerrja e të dhënave dhe e rezultateve të besueshme mbi dhunën në familje ndaj grave dhe fëmijëve në Shqipëri, të cilat mund të shfrytëzohen për zhvillimin e politikave dhe masave efikase parandaluese, mbrojtëse dhe atyre ligjore.

Njëkohësisht, ky kërkim do të plotësojë boshllëkun e madh që ekziston në kërkimin e kufizuar të dhunës në familje në Shqipëri.

Ky projekt kërkimi përfshiu bashkëpunimin e disa organizatave – UNICEF-it, PNUD-it, dhe të Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) – dhe të ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

INSTAT-i ishte organizata drejtuese e kërkimit në nivel kombëtar. Sipas ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT-i është përgjegjës për publikimin e të dhënave dhe për të siguruar që instrumentet e krijuara për mbledhjen e të dhënave janë të besueshme, të vlefshme dhe teknikisht të përshtatshme.<sup>4</sup> Përveç kësaj, INSTAT-i është përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e metodologjisë së duhur të kërkimit dhe të proceseve të mbledhjes së kampioneve, dhe për të siguruar se janë përdorur programet e duhura për përpunimin e të dhënave dhe sintaksat përkatëse të përditësuara të programeve për të garantuar që analizimi i të dhënave të jetë i besueshëm, i paanshëm, objektiv, i detajuar dhe

<sup>3</sup> Ligji nr. 8876, datë 4 prill 2002.

<sup>4</sup> Ligji nr. 9180, datë 2 mars 2004

i interpretueshëm,. Që prej vitit 2004, INSTAT-i ka publikuar sistematikisht të dhëna kombëtare në bazë të gjinisë për personat e interesuar për t'i ndihmuar ata në procesin e zhvillimit të politikave gjinore.

## Referenca

---

1. Minnesota Advocates for Human Rights (1996). *Domestic Violence in Albania*. Minneapolis, Minnesota: Minnesota Advocates for Human Rights.
2. UNICEF (2000). Mapping of Existing Information on Domestic Violence in Albania. Retrieved on March 8, 2009 from <http://www.unicef.org/stats/gender/publications/Albania/DomesticViolence.pdf>
3. Minnesota Advocates for Human Rights, 1996.
4. UNICEF, 2000.
5. Paulo Sergio Pinheiro (2006). *World Report on Violence Against Children*. Geneva, Switzerland: UNICEF.
6. National Strategy on Gender Equality and Domestic Violence, 2007-2010.
7. Minnesota Advocates for Human Rights, 1996.

## Kapitulli 2: Ndërtimi i kërkimit

Kryerja e kërkimit studiues mbi dhunën në familje është sfiduese pasi dhuna në familje ndodh në mënyrë tipike prapa dyerve të mbyllura dhe viktimat e saj – në mënyrë tipike gratë dhe fëmijët – shpesh ngurrojnë ose kanë frikë të raportojnë rastet e dhunës në familje pasi frikësohen nga hakmarrja e abuzuesit ose nga reagimi negativ i familjes dhe i miqve. Shumë shpesh gratë që flasin ose që kërkohen ndihmë në lidhje me dhunën në familje fajësohen për viktimizimin e tyre.

Dy sfida të tjera kryesore me të cilat përballen studiuesit të cilët studiojnë dhunën në familje është krijimi i përkufizimeve të qarta funksionale të llojeve të ndryshme të dhunës në familje dhe i mjeteve për vlerësimin e natyrës dhe të shtrirjes së secilit prej këtyre llojeve të dhunës në familje (1).

Pavarësisht sfidave të kryerjes së kërkimeve studiuese mbi dhunën në familje, janë bërë përpjekje për të kryer një vrojtım kombëtar të popullatës mbi dhunën në familje në Shqipëri. Një prej qëllimeve kryesore të këtij kërkimi studiues ishte mbledhja e të dhënave të besueshme mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje në Shqipëri në një përpjekje për të filluar plotësimin e boshllëkut në të dhëna. Një tjetër qëllim kryesor ishte analizimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve që do të rrisnin njohuritë dhe kuptimin e natyrës dhe të shtrirjes së dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve në Shqipëri. Studimi përshkruet kërkon gjithashtu që të bëjë një krahasim midis zonave urbane dhe atyre rurale mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje dhe të bazuar te mosha, niveli arsimor dhe statusi i punësimit. Njohuritë në bazë të të dhënave dhe të kuptuarit e këtij lloji do t'i ndihmojnë institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të lokale në përpjekjet e tyre për zhvillimin e politikave dhe të masave parandaluese, mbrojtëse dhe atyre ligjore në lidhje me dhunën në familje dhe mbështetjen e viktimave.

### Përkufizime

Dhuna në familje është një formë e dhunës ndaj grave, të cilën Deklarata e OKB-së për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave e përkufizon si “çdo akt dhune në bazë të gjinisë që ka si pasojë ose që mund të çojë në lëndim ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, duke përfshirë kanosjet për veprime të tilla, për shtrëngime ose për privim arbitrar të lirisë, që ndodhin qoftë në jetën publike, qoftë në atë private” (2).

Dhuna në familje është gjithashtu një formë e dhunës ndaj fëmijëve. Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën Ndaj Fëmijëve tregoi se dhuna në familje ndaj fëmijëve është një problem me përmasa globale.<sup>5</sup> Në mjedisin e shtëpisë dhe të familjes, fëmijët janë subjekt i veprimeve të dhunës fizike, abuzimit seksual, praktikave të dëmshme tradicionale, poshtëritit dhe llojeve të tjera të dhunës psikologjike, si edhe të neglizhencës nga prindërit dhe njerktë, kujdestarët alternativë, personat në gjini dhe vëllezërit dhe motrat. (3)

Për qëllime të këtij studimi, dhuna në familje i referohet “një modeli të sjelljes abuzive në çdo marrëdhënie, e cila ushtrohet nga një partner intim ose nga anëtarët e familjes për të marrë dhe për të ruajtur autoritet dhe kontroll mbi një tjetër partner intim ose anëtar të familjes”. Dhuna në familje përfshin aktet ose kanosjen për akte fizike, seksuale, emocionale dhe psikologjike që ndikojnë te një person tjetër. Kjo përfshin çdo sjellje që tremb, manipulon, poshtëron, izolon, frikëson, terrorizon, shtrëngon, kanos, dëmton, lëndon ose plagos dikë (4).

Kërkuesit në mbarë botën kanë shfrytëzuar kritere të ndryshme për të përkufizuar dhunën në familje; megjithatë, një metodë e zakonshme ka qenë

5 Sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), fëmijë është çdo individ nën moshën 18 vjeç.

klasifikimi i dhunës sipas llojit të aktit. Kutia 2.1 identifikon dhe përkufizon secilin prej llojeve të dhunës në familje që është marrë në konsideratë në këtë studim.

Pavarësisht natyrës tepër delikate të dhunës në familje dhe hezitimit të shqiptarëve për të folur hapur rreth përvojave të tyre të dhunshme në martesën dhe familjen e tyre, vrojtimi është

### Kutia 2.1: Llojet e dhunës në familje

**Abuzimi emocional** – shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit të një individi Kjo mund të përfshijë kritikimin e vazhdueshëm, poshtërimin, përçmimin e aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.

**Abuzimi psikologjik** – përfshin shkatërrimin e frikës nëpërmjet trembjes; kërcënimit për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve ose të familjes së partnerit apo të miqve; kërcënimit për braktisje; vrasjen e kafshëve shtëpiake dhe shkatërrimin e pronës; kërcënimet për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve; izolimin e dhunshëm nga familja, miqtë, shkolla dhe/ose puna dhe mohimin e mundësisë për para ose mbështetje ekonomike.

**Dhuna fizike** – përfshin, por nuk kufizohet me: çjerrjen, shtyrjen, goditjen, kapjen, rrahjen, asfiksimin, pickimin, shpimin, shkuljen e flokëve, përdredhjen e krahut, goditjen me shuplakë, gjuajtjen, djegien, therjen dhe mbytjen. Dhuna fizike mund të përfshijë përdorimin e madhësisë dhe të forcës fizike të një personi, shtrëngimet ose armët (p.sh. pistoletë, thikë ose një objekt tjetër) për të marrë dhe për të ruajtur kontrollin mbi personin tjetër. Dhuna fizike shpesh shkakton disa forma dëmtimi ose lëndimi dhe mund të shkaktojë edhe vdekje.

**Dhuna seksuale** – përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit. Abuzimi seksual përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin martesor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimit të personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe të familjes.

### Matja e dhunës në familje

Vrojtimi kombëtar është zhvilluar për të matur natyrën dhe shtrirjen e katër llojeve të ndryshme të dhunës në familje të përkufizuara në kutinë 2.1.

Përkufizimet e secilit prej këtyre llojeve të dhunës në familje janë përfshirë në vrojtim duke shfrytëzuar një sërë pyetjesh specifike të sjelljes në lidhje me secilin lloj të dhunës. Ky studim nuk është përpjekur të masë një listë gjithëpërfshirëse të akteve të dhunës, por në vend të kësaj, ka bërë një sërë pyetjesh rreth akteve specifike që ndodhin përgjithësisht në martesë dhe familje të dhunshme. Aktet e përdorura për të përkufizuar secilin prej katër llojeve të dhunës në familje ndaj grave, të matura në këtë vrojtim, janë përmbledhur në kutinë 2.3, dhe ato që lidhen me dhunën në familje ndaj fëmijëve janë përmbledhur në kutinë 2.2.

zhvilluar për t'i nxitur gratë ta raportojnë vetë natyrën dhe shtrirjen e dhunës që kanë përjetuar në një marrëdhënie intime dhe/ose në martesën e tyre, dhe fëmijët ta raportojnë vetë natyrën dhe shtrirjen e dhunës që kanë përjetuar në familjen e tyre.

### Kutia 2.2: Llojet e dhunës në familje ndaj fëmijëve nga një anëtar i familjes

#### Dhuna fizike

- Goditja me objekte
- Goditja me shuplakë, me grusht, me shkelm
- Djegia me cigare ose me diçka të nxehtë

#### Abuzimi psikologjik

- Kanosja me armë ose me thikë



### Kutia 2.3: Llojet e dhunës në familje ndaj grave nga bashkëshorti/partneri intim

#### Abuzimi emocional

- Xhelozia ose zemërim nëse jeni parë duke folur me burra të tjerë
- Ju akuzon për tradhti
- Dyshon në besnikërinë tuaj ndaj tij
- Ju bërtet dhe ju ofendon
- Thotë ose bën gjëra për t'ju poshtëruar përpara të tjerëve
- Ju injoron
- Ju flet në një mënyrë që ju bën të ndiheni keq ose e pavlerë

#### Abuzimi psikologjik

- Nuk ju jep para
- Nuk ju lejon të takoni shoqet tuaja
- Ju kufizon kontaktin me familjen tuaj
- Këmbëngul që ta dijë në çdo kohë se ku jeni
- Kërcënon t'ju lëndojë ose t'ju dëmtojë juve ose ndonjë të afërmin tuaj
- Ju kërcënon me thikë ose me ndonjë armë tjetër

#### Dhuna fizike

- Ju hedh ose ju shtyn
- Ju rreh
- Ju shkul flokët
- Ju godet me një objekt ose diçka tjetër që mund t'ju dëmtojë
- Ju gjuan me shkelm ose ju tërheq zvarrë
- Ka tentuar t'ju mbysë ose t'ju djegë

#### Dhuna seksuale

- Ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale pa dëshirën tuaj
- Ju detyron me forcë të kryeni akte seksuale poshtëruese dhe të padëshiruara

### Zhvillimi i vërtimit

INSTAT-i e zhvilloi vërtimin pas një rishikimi të gjerë të literaturës ndërkombëtare mbi dhunën në familje dhe të një rishikimi të instrumenteve ekzistuese të vërtitimeve, të përdorur në Shtetet e Bashkuara, në Europë dhe Afrikë.<sup>6</sup> INSTAT-i gjithashtu ka rishikuar të dhënat e publikuara nga Ministria e Brendshme për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2007, si dhe të dhënat dhe informacionet mbi dhunën në familje të publikuara nga OJQ-të anëtarë të Rrjetit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit Njerëzor.<sup>fn</sup> Përveç kësaj, INSTAT-i ka rishikuar publikimin e vitit 1996 të avokatëve të Minesotës për të Drejtat e Njeriut, të titulluar *Dhuna në Familje në Shqipëri*

<sup>6</sup> Burimi kryesor ishin dokumentet dhe pyetësorët e vërtimit DHS, në mënyrë specifike Moduli mbi Dhunën në Familje.

### Struktura e vërtimit

Vërtimi Kombëtar mbi Dhunën në Familje përbëhej nga një seri pyetjesh me përgjigje të përcaktuara (po/jo) që ishin zhvilluar në dhjetë module të veçanta:

- Moduli 1: Moduli i informacionit (MODHH)
- Moduli 2: Moduli i Strukturës së Familjes (MODHL)
- Moduli 2: Moduli i Karakteristikave Social-Ekonomike (MODSE)
- Moduli 3: Moduli i Dhunës Ndaj Grave (MVAW)
- Moduli 4: Moduli i Përzgjedhjes së Grave të Moshës 15-49 Vjeç (MODSEL WM)
- Moduli 5: Moduli i Martesës dhe i Sjelljes Seksuale (MODMA)
- Moduli 6: Moduli i Dhunës në Familje Ndaj Grave (MODDV)
- Moduli 7: Moduli i Përdorimit të Armëve (MODSALW)

- Moduli 8: Moduli i Përzgjedhjes së Fëmijëve të Moshës 10-14 Vjeç (MODSEL)
- Moduli 9: Moduli i Dhunës në Familje ndaj Fëmijëve të Moshës 10-14 Vjeç (MODDV CH)
- Moduli 10: Moduli i Përdorimit të Armëve në Prani ose Ndaj Fëmijëve (MODSALW CH)

Moduli 1 i vrojtimit përbëhet nga një seri prej 11 zërash të përcaktuar, duke përfshirë të dhënat e intervistuesit dhe të të intervistuarit (pra, datën e intervistës, rezultatet e vrojtimit, kodet e identifikimit për gratë dhe fëmijët e intervistuar dhe numrin total të anëtarëve të familjes).

Moduli 2 i vrojtimit përbëhet nga një seri pyetjesh me përgjigje të përcaktuara që i mundësonin intervistuesit të regjistronin të gjithë anëtarët e familjes që jetojnë aktualisht në familje, duke përfshirë marrëdhëniet, seksin, moshën, vitin e lindjes, gjendjen civile, besimin fetar, nivelin e arsimit dhe statusin e punësimit të secilit anëtar të familjes.

Moduli 3 i vrojtimit përbëhet nga një seri pyetjesh me përgjigje të përcaktuara që i mundësonin intervistuesit të regjistronin kushtet e jetesës së familjes, duke përfshirë pronësinë e shtëpisë, numrin e dhomave në shtëpi, praninë e pajisjeve të ndryshme shtëpiake, burimin kryesor të ujit të pijshëm dhe disponueshmërinë e energjisë elektrike.

Moduli 4 i vrojtimit i lejonte intervistuesit të listonte secilën nga gratë në moshën 15 vjeç deri në 49 vjeç në familje dhe e pajiste intervistuesin me një metodë për përzgjedhjen e rastësishme të një gruaje në familje për të plotësuar Modulet 5 deri në 7.

Moduli 5 i vrojtimit përbëhet nga një seri prej 16 pyetjesh me përgjigje të përcaktuara rreth martesës dhe sjelljeve seksuale, për t'u plotësuar nga një grua në moshën nga 15 deri në 49 vjeç në familje. Pyetjet u zhvilluan për të matur: historinë e martesës ose të jetesës së gruas me një burrë; moshën e bashkëshortit; vitin dhe moshën kur ajo ka filluar të jetojë me bashkëshortin ose me partnerin intim të parë; marrëdhëniet seksuale; shfrytëzimin e metodave për kontrollin e lindjeve; refuzimin e përdorimit të kontraktivëve nga bashkëshorti/partneri intim; marrëdhëniet seksuale të detyruara me bashkëshortin/partnerin intim;

rreziku i HIV-it ose i sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe testimi ose përvoja e mëparshme me sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Moduli 6 i vrojtimit përbëhet nga një seri prej 36 pyetjesh me përgjigje të përcaktuara rreth përvojave të dhunës në familje të raportuara nga vetë gratë, për t'u plotësuar nga një grua në moshën nga 15 deri në 49 vjeç në familje. Pyetjet u zhvilluan për të matur përvojat e grave lidhur me abuzimin fizik, seksual, emocional dhe psikologjik nga bashkëshorti/partneri intim; kur ka ndodhur për herë të parë abuzimi; dëmtimet e shkaktuara si pasojë e abuzimit; abuzimi fizik gjatë shtatzënisë; përdorimi i alkoolit nga bashkëshorti; abuzues të tjerë në familje; sjelljet për kërkimin e ndihmës dhe ndikimi i perceptuar i dhunës të fëmija/fëmijët.

Moduli 6 i vrojtimit fokusohet gjithashtu në sigurimin e vlerësimeve të besueshme të përvojave të grave me llojet e ndryshme të dhunës në familje, duke përfshirë përvojat gjatë gjithë jetës (që nga moshën 15 vjeçare) dhe përvojat aktuale (gjatë 12 muajve përpara intervistës) me dhunën në familje, si dhe shpeshësinë e kësaj dhune.

Moduli 7 i vrojtimit përbëhet nga 42 pyetje me përgjigje të përcaktuara rreth pranisë dhe përdorimit të armëve në shtëpi, për t'u plotësuar nga një grua në shtëpi në moshën 15 deri në 49 vjeç.<sup>7</sup> Pyetjet u zhvilluan për të matur: praninë e armëve në shtëpi; llojin e armëve në shtëpi; përdoruesit abuzues të armëve; dijeninë e fëmijëve për praninë e armëve në shtëpi; përvojat e kërcënimit me armë në shtëpi nga anëtarët e familjes; llojet e dëshmitarëve të kërcënimeve me armë; kur ka ndodhur kërcënim me armë; dëmtimet dhe ndikimet e tjera nga kërcënim me armë ose përdorimi i viktimeve; përdorimin e armës së zjarrit në shtëpi (kundër kujt, ku ka ndodhur qitja në shtëpi, dëshmitarët, lloji i armës); përdorimin e alkoolit nga autori i krimit gjatë kërcënimit apo gjatë përdorimit të armës. Moduli 7 përfshinte gjithashtu pyetje rreth sjelljeve për

<sup>7</sup> Shqipëria është unike për sa i përket faktit që shumë familje mbajnë armë pa leje në shtëpinë e tyre. Në Shqipëri ka një numër të llogaritur prej 400 000 armësh në shtëpi; ky është një krahasim me 300 000 armë në shtëpitë në Kosovë dhe 2 300 000 armë në shtëpitë në Serbi.

kërkim ndihme në lidhje me kërcënimet apo me përdorimin e armës në shtëpi dhe mendimet e përdorimit të armëve për të kryer vetëvrasje.

Moduli 8 i vrotimit i lejonte intervistuesit të listonte secilin nga fëmijët në moshën 10 vjeç deri në 14 vjeç në familje dhe e pajiste intervistuesin me një metodë për përzgjedhjen e rastësishme të një fëmije në familje për të plotësuar Modulet 9 deri në 10 të vrotimit.

Moduli 9 i përbëhej nga një seri prej 11 pyetjesh me përgjigje të përcaktuara rreth përvojave të fëmijëve lidhur me dhunën në familje, për t'u plotësuar nga një fëmijë në moshën nga 10 deri në 14 vjeç në familje. Pyetjet u zhvilluan për të matur përvojën e një fëmije lidhur me dhunën fizike nga një anëtar i familjes; kush është abuzuesi në familje; sjelljet për kërkimin e ndihmës të fëmijës viktimë; dijenia mbi abuzimin fizik ndaj nënës ose midis prindërve; dhe nëse ata e kanë raportuar këtë dhunë te dikush.

Si përfundim, Moduli 10 i përbëhet nga një seri prej 9 pyetjesh me përgjigje të përcaktuara rreth përdorimit të armëve në prani ose ndaj fëmijëve, për t'u plotësuar nga një fëmijë në moshën nga 10 deri në 14 vjeç në familje. Pyetjet u zhvilluan për të matur: nëse një fëmijë ka qenë dëshmitar gjatë një kërcënimi ose përdorimi të një arme ndaj një anëtari të familjes nga një tjetër anëtar i familjes; përvojën e të qenit i kërcënuar ose i qëlluar me armë (duke përfshirë numrin e herëve dhe herën e fundit kur ka ndodhur kjo gjë); llojin e abuzuesit; armët që kanë shkaktuar dëmtimet; dhe mendimet e përdorimit të armëve në shtëpi për të kryer vetëvrasje.

Kryerja e vrotimit nga intervistuesit me të intervistuar ballë për ballë kërkonte mesatarisht 40 minuta.

### **Marrja maksimale e informacionit**

Që në fillim të vrotimit, është pranuar se dhuna në familje është një çështje shumë delikate, dhe se gratë dhe fëmijët do të hezitonin të tregonin përvojat e tyre të dhunës në familje. Për këto arsye, u bënë përpjekje për strukturimin e vrotimit për të siguruar që gratë dhe fëmijët të ndiheshin të qetë dhe të mund të tregonin çdo

përvojë dhune. Në mënyrë të veçantë, vrotimi u strukturua në mënyrë të tillë që seksionet e fillimit të mbledhnin informacion për çështje më pak delikate (demografia dhe komoditetet e strehimit), dhe çështjet më delikate (p.sh. vetë-raportimi i dhunës në familje dhe i përdorimit ose i kërcënimeve për përdorim të armëve në shtëpi nga bashkëshortët ose nga anëtarët e tjerë të familjes) të shqyrtoheshin më vonë në vrotim. Përveç kësaj, vëmendje i është kushtuar formulimit të drejtimeve të vrotimit. Të anketuarit paralajmëroheshin rreth fokusit të vrotimit dhe natyrës delikate të pyetjeve të përfshira në të; megjithatë, fokusi i vrotimit nuk bëhej i ditur për anëtarët e tjerë të familjes. Të anketuarit gjithashtu informoheshin se përgjigjet e tyre do të mbeteshin konfidenciale.

### **Ndërtimi i kampionit**

Studimi përbëhej nga një vrotim të njëkohshëm familjar me bazë popullatën, të kryer në nivel kombëtar në të 12 prefekturat në Shqipëri.

Në përgjithësi, në secilën familje janë anketuar një deri në dy persona. Në mënyrë të veçantë, është vendosur që vetëm një person (vetëm gruaja) ose dy persona (nëna dhe fëmija) do të intervistoheshin veçmas për çdo familje. Në bazë të kriterëve të parapërcaktuara, gruaja konsiderohej e përshtatshme për vrotimin nëse ajo ishte në moshën 15 deri në 49 vjeç dhe nëse normalisht jetonte në familje. Gjatë vizitave në familje, një grua përzgjidhej në mënyrë të rastësishme duke shfrytëzuar Modulin 4. Përveç kësaj, një fëmijë konsiderohej i përshtatshëm për t'u anketuar nëse ai ose ajo ishte në moshën 10 deri në 14 vjeç dhe nëse normalisht jetonte në familje. Fëmija përzgjidhej në mënyrë të rastësishme gjatë vizitave në familje, duke shfrytëzuar Modulin 8.

Gjatë zhvillimit të kriterëve të përzgjedhjes për kampionin, një vëmendje e veçantë iu kushtua përcaktimit të popullatës së studimit dhe karakteristikave të saj. Synimi ishte të nxirrej një kampion i familjeve që do të lejonin krijimin e vlerësimeve të besueshme statistikore për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve në nivel kombëtar dhe që do të mundësonte krahasimet midis zonave urbane dhe atyre rurale.

Përlllogaritjet fillestare të madhësisë së modelit propozonin që një model me madhësi prej 2600 familjesh do të jepte një mundësi të mjaftueshme për të arritur objektivat e studimit.

Për të përzgjedhur familjet u shfrytëzua një skemë anketimi në grupe, e ndarë në shumë faza. Në fillim u përzgjodhën rrethet, pastaj u përzgjodhën grupet nga rrethet e zgjedhur.<sup>8</sup>

## Intervistuesit

Përpara realizimit të vrojtimit, INSTAT-i përzgjodhi dhe trajnoi me kujdes 14 ekipe kërkimi – 14 mbikëqyrës rajonale dhe 31 intervistues – për të realizuar vrojtimin.<sup>9</sup> Secili pjesëtar i ekipit të kërkimit u trajnuar për një periudhë katër deri në pesë ditë në tetor të vitit 2007. Trajnimi mbulonte qëllimin dhe përmbajtjen e vrojtimit, përkufizimet bazë, çështjet e dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve, procedurat e marrjes së kampioneve dhe të vrojtimit, mënyrën e realizimit të vrojtimit në një intervistim ballë për ballë, mënyrën e ndihmës për të intervistuarit për të kujtuar saktë ngjarjet e dhunshme,<sup>10</sup> dhe faktorët etikë dhe të sigurisë për intervistimin e grave dhe të fëmijëve të dhunuar. Pjesëtarët e ekipit të kërkimit gjithashtu u pajisën me mbështetje të vazhdueshme gjatë të gjithë ciklit të studimit.

Siguria e të intervistuarve dhe e ekipit të kërkimit ishte e një rëndësie të madhe; për pasojë, faktorët etikë për vrojtimin të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë u përfshinë në

8 Për të përzgjedhur grupet u shfrytëzuan të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2001. Zonat e numërimit të popullsisë u përcaktuan si njësitë kryesore të marrjes së kampioneve (PSU-të) dhe u përzgjodhën nga secila fushë e marrjes së kampioneve duke shfrytëzuar procedurat sistematike të PPS-së. Numri i familjeve në PSU u shfrytëzua si matës i madhësisë. Faza e parë e marrjes së kampioneve përfundoi me përzgjedhjen e numrit të kërkuar të zonave të numërimit, veçmas nga secila prej zonave urbane dhe rurale.

9 INSTAT-i ka një ekip të kualifikuar grumbulluesish të të dhënave ose intervistuesish, kështu që shumica e intervistuesve në këtë projekt kërkimi u punësuan nga INSTAT-i.

10 Intervistuesit janë trajnuar për t'i ndihmuar të intervistuarit të kujtojnë saktë ngjarjet e dhunshme duke i vënë ata përballë ngjarjeve të tjera të mëdha (p.sh. lindja e një fëmije, një ngjarje ose pushimet e rëndësishme të familjes ose zhvendosja në një vend të ri).

modelin e kampionit të vrojtimit, në procedurat e administrimit dhe në trajnimin për intervistuesit (5).

Intervistuesit u udhëzuan mbi rëndësinë e garantimit të konfidencialitetit dhe të fshehtësisë së të anketuarve për të ruajtur sigurinë e të anketuarve dhe për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Për të ruajtur konfidencialitetin, intervistuesit u trajnuar për t'i intervistuar privatisht të anketuarit. Secili nga intervistuesit e INSTAT-it shoqërohej nga një punonjës social, psikolog ose mësues.

Koordinatori i projektit në INSTAT dhe mbikëqyrësit e ekipeve monitoruan rregullisht performancën e intervistuesve dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura.

## Kryerja e vrojtimit në terren

Kryerja e vrojtimit në terren filloi në nëntor të vitit 2007 dhe vazhdoi deri në dhjetor të vitit 2007. Vrojtimet u kryen ballë për ballë në shtëpitë e të anketuarve. Të anketuarit nuk u paguan për pjesëmarrjen në intervistë.

## Përpunimi dhe analizimi i të dhënave

Procedurat e hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave ishin rigorozë dhe u mbikëqyrën në mënyrë të kujdesshme nga INSTAT-i. U miratua një përjasje e standardizuar për kodimin dhe në softuerin CPro u zhvillua një program për futjen e të dhënave. Kjo ndihmoi për të siguruar që të dhënat të futeshin saktë. Në përfundim të mbledhjes së të dhënave, të gjitha të dhënat u futën në pesë kompjuterë portativë duke shfrytëzuar programin kompjuterik CPro. Për të siguruar kontrollin e cilësisë, të gjithë pyetësorët u futën dy herë dhe u kryen rregullisht kontrolle për konsistencën e brendshme.

Përpunimi i të dhënave ka filluar në dhjetor të vitit 2007 dhe ka përfunduar në shkurt të vitit 2008. Baza e pastër e të dhënave u përdor për analizimin e të dhënave duke përdorur SPSS-në. Është e rëndësishme të theksohet se INSTAT-i ka standarde profesionale për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave që janë zbatuar në këtë vrojtimit kombëtar mbi dhunën në familje.

Kampioni nuk vlerësohej vetë; kështu, probabiliteti i përzgjedhjes së një grupi nuk ishte në proporcion me përmasat e tij.

## Referenca

---

1. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence against Women*. Geneva, Switzerland: World Health Organization.
2. United Nations General Assembly, 1993, p. 2
3. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children*. Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
4. US Department of Justice, Office on Violence Against Women. Retrieved on March 11, 2009 from <http://www.ovw.usdoj.gov/domviolence.htm>
5. Garcia-Moreno (1999). *Putting Women First: Ethical and Safety Recommendations for Research and Domestic Violence Against Women*. Geneva, Switzerland: World Health Organization.

## Kapitulli 3: Demografia e kampionëve

Ky kapitull përmban informacion mbi demografinë e familjeve të anketuara, si edhe të dhëna demografike për gratë e moshës 15 deri 49 vjeç dhe për fëmijët e moshës 10 deri në 14 vjeç që janë përzgjedhur për të plotësuar vrojtimin.

### Demografia e familjeve

Tabela 3.1 tregon 2590 familjet që janë anketuar në të 12 prefekturat në Shqipëri. Nga 2590 familje të anketuara, 43,1% ishin në zonat urbane dhe 56,9% në zonat rurale.

**Tabela 3.1. Demografia e familjeve**

	Nr= 2590	
	nr	%
<b>Rrethi</b>		
Berat	179	6.9
Dibër	159	6.1
Durrës	204	7.9
Elbasan	247	9.5
Fier	353	13.6
Gjirokastër	154	5.9
Korçë	206	8.0
Kukës	135	5.2
Lezhë	150	5.8
Shkodër	203	7.8
Tiranë	411	15.9
Vlorë	188	7.3
<b>Vendbanimi</b>		
Urban	1117	43.1
Rural	1473	56.9

**Tabela 3.2. Demografia e grave**

	Nr.=2590	
	nr	%
<b>Mosha</b>		
15-17 vjeç	168	6.5
18-21 vjeç	228	8.8
22-25 vjeç	259	10.0
26-29 vjeç	247	9.5
30-33 vjeç	316	12.2
34-37 vjeç	333	12.9
38-41 vjeç	327	12.6
42-45 vjeç	299	11.5
46-49 vjeç	413	15.9
<b>Gjendja civile</b>		
E martuar/Bashkëjeton	1,948	75.2
E ve	36	1.4
E divorcuar/E ndarë	51	2.0
Beqare	555	21.4
<b>Niveli arsimor</b>		
Pa arsim	5	.2
Arsim fillor	35	1.4
Arsim 9-vjeçar	1,238	47.9
Arsim të mesëm	995	38.5
Arsim universitar	308	11.9
<b>Statusi i punësimit</b>		
Punon jashtë shtëpisë	1,052	40.6
Me leje lindjeje	20	.8
Nuk punon jashtë shtëpisë	1,518	58.6
<b>Feja</b>		
Myslimane	1,961	75.7
Ortodokse	312	12.0
Katolike	260	10.0
Bektashije	35	1.4
Të tjera	4	.2
Ateiste	18	.7

## Demografia e grave


Tabela 3.2 tregon karakteristikat demografike të kampionit prej 2590 grash. Nga gratë e anketuara, ato varionin nga mosha 15 deri në 49 vjeç, me një shpërndarje tërësisht të barabartë të grave në secilën grupmoshë, përveç një mungese të vogël përfaqësimi të grave të grupmoshave 15 deri në 17 vjeç dhe 18 deri në 21 vjeç. Mosha mesatare ishte 33,7 vjeç.

Shumica e grave të anketuara ishin aktualisht të martuara ose jetonin me një partner intim (75,2%), dhe 21,4% ishin beqare, 2,0% të divorcuara/të ndara, dhe 1,4% të ve. Shumica e familjeve ishin

Në përfundim, tabela 3.2 tregon që vetëm 40,6% nga 2590 gra të anketuara punonin jashtë shtëpisë për të paktën 20 orë në javë në muajin përpara intervistës, ndërsa 58,6% e grave të anketuara nuk punonin jashtë shtëpisë në muajin përpara intervistës. Figura 3.2 tregon që gratë në zonat urbane (46,4%) punojnë më shumë jashtë shtëpisë sesa gratë në zonat rurale (32,9%); shihni gjithashtu tabelën 1 në shtojcë).

Tabela 3.3 tregon se nga 1518 gra që raportuan se nuk punonin jashtë shtëpisë në muajin përpara intervistës, 24,2% pohuan se përgjegjësitë për familjen i kufizonin mundësinë e tyre për të

**Figura 3.1. Niveli i arsimit sipas zonave urbane kundrejt atyre rurale**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

myslimane (75,7%).

Tabela 3.2 tregon që shumica e 2590 grave të intervistuar kishin një nivel arsimimi: 2% ishin të paarsimuara, 1,4% kishin vetëm arsim fillor (deri në klasë të 4-të), 47,9% kishin përfunduar arsimin 9-vjeçar (deri në klasë të 9-të), 38,5% kishin përfunduar arsimin e mesëm (deri në klasë të 12-të), dhe 11,9% kishin përfunduar arsimin e lartë.

Figura 3.1 tregon që gratë në zonat urbane rezultuan të kishin arsim të mesëm (46,5%) ose arsim të lartë (17,8%) në nivel më të madh sesa gratë nga zonat rurale (përkatësisht 28,0% dhe 4,1%) Gratë nga zonat rurale rezultuan të kishin vetëm arsimin e mesëm (66,7%) në krahasim me gratë nga zonat urbane (33,7%); shihni gjithashtu tabelën 1 në shtojcë).

**Figura 3.2. Statusi i punësimit sipas zonave urbane kundrejt atyre rurale**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

punuar jashtë shtëpisë. Përveç kësaj, 9,4% raportuan se nuk mund të punonin jashtë shtëpisë pasi po ndiqnin shkollën, 4,9% nuk mund të gjenin një person që të kujdesej për fëmijët, 1,5% kishin sëmundje kronike/paaftësi, 1,2% raportuan se prindërit nuk i lejonin të punonin jashtë shtëpisë, 1,0% raportuan se bashkëshorti nuk i lejonte të punonin jashtë shtëpisë, 8% nuk kishin dëshirë ose nevojë të punonin, 4% ishin kthyer së fundmi nga puna si emigrante dhe 4% punonin më

**Tabela 3.3. Arsyet pse gratë nuk punonin jashtë shtëpisë**

	Nr=1518	
	nr	%
Përgjegjësitë në familje	626	24.2
Duke kërkuar një punë	263	14.0
Duke ndjekur shkollën	244	9.4
Pamundësia për të gjetur dikë që të kujdesej për fëmijët	128	4.9
Sëmundje kronike/paaftësi	38	1.5
Prindërit nuk më lejojnë të punoj	32	1.2
Bashkëshorti nuk më lejon të punoj	27	1.0
Nuk dëshiroj ose nuk kam nevojë të punoj	22	.8
Jam kthyer nga puna si emigrante	10	.4
Punoj më pak se 20 orë në javë	10	.4

pak se 20 orë në javë. Përveç kësaj, 14% e grave pohuan se ishin të papuna dhe në kërkim të një pune në kohën e vrotimit.

### Demografia e fëmijëve


Tabela 3.4 tregon karakteristikat demografike të kampionit për fëmijët. Nga 991 fëmijë të anketuar, 50,7% ishin meshkuj dhe 49,3% ishin femra. Ato varionin nga mosha 10 deri në 14 vjeç, me një

**Tabela 3.4. Demografia e fëmijëve**

	Nr=991	
	nr	%
<b>Seksi</b>		
Femra	489	49.3
Meshkuj	502	50.7
<b>Mosha</b>		
10 vjeç	191	19.3
11 vjeç	202	20.4
12 vjeç	190	19.2
13 vjeç	206	20.8
14 vjeç	202	20.4
<b>Vendbanimi</b>		
Urban	510	51.5
Rural	481	48.5

shpërndarje tërësisht të barabartë të fëmijëve për secilën kategori moshe. Mosha mesatare ishte 12 vjeç.

**Figura 3.3. Mosha e fëmijëve si pas gjinisë**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.



Figura 3.3 tregon që ka pasur gjithashtu një shpërndarje tërësisht të barabartë të fëmijëve femra dhe meshkuj në secilën prej kategorive të moshës. Kështu që, çdo ndryshim në kategoritë e moshës për sa i përket përvojës së fëmijëve në lidhje me dhunën në familje, nuk do të bazohet në ndryshimet e përfaqësimit gjinor në kategoritë e moshës (shihni gjithashtu tabelën 2 në shtojcë).

Në përfundim, figura 3.4 tregon që ka pasur një përfaqësim tërësisht të barabartë të fëmijëve meshkuj dhe femra në zonat urbane dhe ato rurale. Kështu që, çdo ndryshim ndërmjet zonave urbane dhe rurale për sa i përket përvojës së fëmijëve në lidhje me dhunën në familje nuk do

**Figura 3.4. Zonat urbane kundrejt atyre rurale sipas gjinisë së fëmijëve**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

të bazohen në ndryshimet e përfaqësimit gjinor në zonat rurale dhe ato urbane (shihni gjithashtu tabelën 2 në shtojcë).

## Kapitulli 4: Dhuna në familje ndaj grave

Dhuna në familje ndodh në mënyrë tipike prapa dverve të mbyllura dhe kalon pa u raportuar. Ky kapitull fokusohet në hapjen e dverve dhe në zbulimin e formave të shumta të dhunës dhe të abuzimit që përjetojnë gratë gjatë martesës dhe lidhjeve intime. Për më tepër, ky kapitull u jep zë shumë grave që vuajnë në heshtje me dhunën dhe abuzimin gjatë martesës dhe lidhjeve intime.

Dhuna në familje mund t'ju ndodhë grave pavarësisht moshës, nivelit arsimor, statusit të punësimit, fesë dhe vendit të banimit (urban ose rural). Dhuna në familje mund të ndodhë mes çifteve të martuar ose partnerëve intimë që jetojnë ose që shoqërohen bashkë. Dhuna në familje ndikon jo vetëm te gratë që abuzohen, por gjithashtu ka një ndikim thelbësor tek anëtarët e tjerë të familjes dhe te fëmijët, miqtë, dëshmitarët e tjerë dhe te komuniteti më i gjerë. Fëmijët të cilët rriten duke qenë dëshmitarë të dhunës në familje, shpesh ndikohen seriozisht nga ky krim. Në mënyrë të veçantë, ekspozimi i shpeshtë ndaj dhunës në shtëpi bën që fëmijët të jenë të predispozuar drejt problemeve sociale dhe fizike, u mëson atyre që dhuna është një mënyrë normale jetese dhe rrit rrezikun që ata të bëhen brezi i ardhshëm i viktimave dhe i abuzuesve të shoqërisë (1).

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje të përjetuar nga gratë e moshave 15 deri 49 vjeç. Ky kapitull përfshin gjithashtu krahasime të përvojës së grave lidhur me dhunën në familje në bazë të vendbanimit (ndryshimet midis zonave urbane kundrejt atyre rurale), moshës, nivelit arsimor dhe statusit të punësimit.

### Dhuna në familje ndaj grave

Nga 2590 gra të anketuara, 50,6% raportuan që kanë përjetuar ndonjëherë abuzim emocional në martesën ose në lidhjet e tyre intime, 39,1% kanë

përjetuar abuzim psikologjik, 31,2% kanë përjetuar dhunë fizike, dhe 12,7% kanë përjetuar dhunë seksuale (shihni tabelën 4.1). Të paktën 56% e grave kanë përjetuar një nga format e dhunës në familje të matura në vrojtim.

**Tabela 4.1. Përqindja e grave të moshës 15 deri në 49 vjeç që përjetojnë dhunë në familje**

	Nr.=2590	
	nr	%
Abuzimi emocional	1,311	50.6
Abuzimi psikologjik	1,013	39.1
Dhuna fizike	808	31.2
Dhuna seksuale	330	12.7

Është e rëndësishme të përmendet se ka pasur një numër të madh grash që nuk u janë përgjigjur pyetjeve rreth abuzimit në martesën ose në lidhjet e tyre intime. Përqindja e grave që nuk u përgjigjen varion në 35,9% për abuzimin emocional, 29,6% për dhunën fizike dhe abuzimin psikologjik dhe 23,2% për dhunën seksuale. Gratë që nuk u përgjigjen nuk dëshironin ose hezitonin të raportonin dhe të flisnin rreth përvojës së tyre lidhur me dhunën në familje. Për pasojë, vlerësimet e shtrirjes në tabelën 4.1 mund të jenë përllogaritje jo të sakta.

### Abuzimi emocional

Abuzimi emocional përfshin një sërë sjelljesh që synojnë të prekin karakterin e gruas dhe të shkatërrojnë ndjenjën e tyre të vetëvlerësimit dhe të vetëbesimit. Në fillim, një grua e dhunuar mund të reagojë ndaj kritikave dhe injorimit duke u përpjekur të ndryshojë veten ose për sjelljet abuzive të bashkëshortit/partnerit të saj, ajo mund t'ia hedhë fajin faktit që ai konsumon alkool. Megjithatë, me kalimin e kohës shumë gra kuptojnë se asgjë që ato bëjnë nuk sjell ndonjë ndryshim dhe ndjenja e tyre për sigurinë në marrëdhënie minimizohet (2).

Kërkimi tregon që efektet e abuzimit emocional te gratë e dhunuara mund të jenë po aq të dëmshme sa edhe dhuna fizike, duke çuar në ndjesi dyshimi te vetja, ndjesi të mungesës së vlerave, në ankth dhe në depresion. Viktimat e abuzimit emocional shpesh mendojnë që nuk ka asnjë mënyrë për të dalë nga marrëdhënia ose që pa partnerin e tyre abuzues ato janë asgjë. Gratë e abuzuara emocionalisht shpesh e jetojnë jetën me frikë dhe i ndryshojnë shpesh mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e tyre. Ato gjithashtu prirën të mohojnë nevojat e tyre në përpjekje për të shmangur abuzimin e mëtejshëm (3).

Në lidhje me abuzimin emocional, tabela 4.2 tregon format e ndryshme të abuzimit emocional që u matën në vrojtim dhe që janë përjetuar nga gra të moshës 15 deri në 49 vjeç në martesën ose në lidhjet e tyre intime. Format më të zakonshme të abuzimit emocional të përjetuara nga gratë përfshijnë format e abuzimit verbal (p.sh. fyerja, xhelozia dhe poshtërimi). Nga 2590 gra të anketuara, 57,1% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri intim u bërtet dhe i fyer, 35,7% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri intim bëhet xheloz ose inatoset nëse i shikojnë ato duke folur me një ose disa burra të tjerë, 22,6% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri intim u flet në një mënyrë që i bën të ndihen keq me veten ose të pavlera dhe 20,9% e grave raportuan

që bashkëshorti/partneri intim u ka thënë ose ka bërë gjëra për t'i poshtëruar ata përpara të tjerëve. Abuzimi verbal, si tallja, fyerja dhe poshtërimi shkakton frikë te gratë e dhunuara (4).

Përveç kësaj, 17,0% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri intim i injoron. Injorimi si formë abuzimi duhet marrë seriozisht pasi ai mund të ketë pasoja negative afatgjata. Të qenit e injoruar mund të jetë një nga mesazhet më negative të mundshme rreth vetëvlerësimit pasi ajo mbart mesazhin që ju nuk ekzistoni (5).

Disa gra raportuan gjithashtu që bashkëshorti/partneri intim i ka akuzuar për tradhti (5,1%) dhe dyshon në besnikërinë e tyre (4,2%).

Gratë që raportuan se kanë përjetuar abuzim emocional u pyetën nëse ato e kishin përjetuar këtë abuzim nga bashkëshorti/partneri intim gjatë 12 muajve të fundit dhe mbi shpeshësinë e këtij abuzimi (p.sh. "Sa shpesh ju ka ndodhur kjo gjë gjatë 12 muajve të fundit?"). Tabela 4.2 tregon që 54,4% e grave kanë raportuar që bashkëshorti/partneri intim u ka bërtitur dhe i ka fyer në disa raste (nga rrallëherë deri në raste të shpeshta) gjatë 12 muajve të fundit (aktualisht). Përveç kësaj, një pjesë e madhe e grave kanë raportuar që gjatë 12 muajve të fundit, në disa raste (nga rrallëherë deri në raste të shpeshta), bashkëshorti/partneri

**Tabela 4.2. Abuzimi emocional i përjetuar nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç**

	Nr.=2590									
	Ndonjëherë		Aktualisht		Shpeshësia gjatë 12 muajve të kaluar					
					Shpesh		Ndonjëherë		Aspak	
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Abuzimi emocional										
Xhelozia ose zemërim nëse jeni parë duke folur me burra të tjerë	925	35.7	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Ju akuzon për tradhti	133	5.1	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Dyshon në besnikërinë tuaj ndaj tij	110	4.2	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Ju bërtet dhe ju ofendon	1,479	57.1	1,409	54.4	222	8.6	1,187	45.8	70	2.7
Thotë ose bën gjëra për t'ju poshtëruar përpara të tjerëve	542	20.9	495	19.1	63	2.4	432	16.7	47	1.8
Ju injoron	440	17.0	370	14.3	56	2.2	314	12.1	70	2.7
Ju flet në një mënyrë që ju bën të ndiheni keq ose e pavlerë	585	22.6	524	20.2	79	3.1	445	17.2	61	2.4

\*NA = Jo e disponueshme (nuk është matur)

intim u ka folur në një mënyrë që i ka bërë ato të ndihen keq ose të pavlera (20,2%), që ai ka thënë ose ka bërë gjëra për t'i poshtëruar ato përpara të tjerëve (19,1%) dhe i ka injoruar ato (14,3%).


Është e rëndësishme të kuptojmë që gratë e dhunuara në mënyrë tipike nuk përjetojnë vetëm një formë të abuzimit emocional në marrëdhënien e tyre, por shpesh përjetojnë shumë forma të tij. Figura 4.1 tregon përqindjen e grave që kanë raportuar se kanë përjetuar një ose më shumë nga shtatë format e abuzimit emocional të identifikuar në tabelën 4.1. Është e rëndësishme të theksojmë që ndërsa 50,6% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar abuzim emocional nga bashkëshorti/partneri intim, vetëm 13,5% e grave kanë raportuar që nuk kanë përjetuar asnjë nga format e abuzimit emocional që është matur në vërtetim. Megjithatë, këto gra mund të kenë përjetuar forma të tjera të abuzimit emocional që nuk janë matur në vërtetim.

Figura 4.1 tregon se nga 2590 gra të anketuara, 17,2% e grave të dhunuara raportuan që kishin përjetuar një prej formave të abuzimit emocional në tabelën 4.2, 13,7% kishin përjetuar dy forma të abuzimit emocional, 7,3% kishin përjetuar tre forma të abuzimit emocional, 6,7% kishin përjetuar katër forma të abuzimit emocional, dhe kështu me radhë. Ndikimet afatgjata të abuzimit emocional në format të ndryshme të tij janë të rënda për gratë e dhunuara (shihni gjithashtu tabelën 3 në shtojcë).

Për të kuptuar ndryshimet demografike në eksperiencat e grave me abuzimin emocional në martesat ose në lidhjet e tyre intime, të dhënat janë përdorur për të përcaktuar nëse një grua ka përjetuar ndonjëherë një ose më shumë nga format e ndryshme të abuzimit emocional të listuara në tabelën 4.2. Pas kësaj, janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore demografike të theksuara, të cilat mund të na ndihmonin për të kuptuar abuzimin emocional të grave në martesë ose në lidhjet intime.

Lidhur me abuzimin emocional, nuk ka pasur ndryshime të theksuara midis grupmohave – gratë në secilën prej grupmohave të ndryshme (shihni kapitullin 3 për grupmoshat) kanë përjetuar pothuajse të gjitha njëjloj ndonjëherë abuzim emocional në martesën ose lidhjen e tyre intime. Gjithashtu, nuk ka pasur as ndryshime të theksuara bazuar në gjendjen civile – gratë të cilat ishin të martuara ose që jetonin me dikë kishin përjetuar abuzim emocional njëjloj si gratë e divorcuara ose ato të ndara. Megjithatë, krahasuar me gratë e martuara, gratë e divorcuara ose të ndara ishin në mënyrë të theksuar shumë më pakta në numër që raportonin se “aktualisht” ato përjetonin një abuzim emocional (brenda 12 muajve para intervistës). Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet që 60% deri në 67% e grave të divorcuara ose të ndara raportuan që ato

**Figura 4.1. Format e ndryshme të abuzimit emocional të përjetuara nga gratë nga mosha 15 deri në 49 vjeç**




\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=929; 35,9%)

aktualisht përjetonin një prej formave të abuzimit emocional, krahasuar me 85% deri në 96% të grave të martuara ose të atyre që jetonin me një partner (shihni tabelën 4 në shtojcë).

Ka pasur ndryshime të theksuara që bazoheshin në nivelin e arsimit. Figura 4.2 tregon se nga 1661 gra të anketuara, ndonëse një përqindje e konsiderueshme e grave në të gjitha kategoritë e niveleve të arsimit kishte përjetuar ndonjëherë

Ka pasur gjithashtu ndryshime të theksuara që bazoheshin në statusin e punësimit të grave në eksperiencat e grave me abuzimin emocional nga bashkëshorti/partneri gjatë jetës së tyre. Figura 4.3 tregon se nga 1661 gra të anketuara, gratë të cilat nuk kanë punuar jashtë shtëpisë (82,5%) kishin dukshëm shumë më tepër mundësi të përjetonin ndonjëherë abuzim emocional sesa gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë në kohën e vërtetimit (74,3%; shihni gjithashtu tabelën 4 në shtojcë).

**Figura 4.2. Abuzimi emocional sipas nivelit të arsimit**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.


abuzim emocional, gratë me arsim universitar (61,2%) ishin në mënyrë të theksuar më të pakta se gratë me arsim të mesëm (78,6%), arsim nëntëvjeçar (83,5%), arsim fillor (77,3%) ose të paarsimuara (75,0%) që përjetonin abuzim emocional nga bashkëshortët/partnerët e tyre (shihni gjithashtu tabelën 4 në shtojcë).

Lidhur me abuzimin emocional, ka pasur gjithashtu ndryshime të theksuara mes grave që banonin në zonat rurale dhe ato urbane. Figura 4.4 tregon se nga 1661 gra të anketuara, gratë nga zonat rurale (83,2%) kishin dukshëm shumë më tepër mundësi të përjetonin ndonjëherë abuzim emocional krahasuar me gratë nga zonat urbane (75,4%; shihni gjithashtu tabelën 4 në shtojcë).

**Figura 4.3. Abuzimi emocional sipas statusit të punësimit të grave**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Figura 4.4. Abuzimi emocional sipas vendbanimit rural kundrejt atij urban**

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Shenjat e abuzimit emocional janë të vërteta dhe shpesh depërtojnë thellë te gratë e dhunuara. Për më tepër, në mënyrë tipike abuzimi emocional përkeqësohet me kalimin e kohës dhe në shumë raste përshkallëzohet deri në abuzim fizik. Kështu, gratë e abuzuara emocionalisht shpesh e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shqyrtojnë mundësitë e tyre dhe të organizojnë burimet që iu nevojiten për të braktisur një lidhje abuzive. Në zonat dhe krahinat rurale ku nuk ka ose ka shërbime të kufizuara për mbështetjen e viktimave, gratë e dhunuara kanë shumë më tepër mundësi

që të përjetojnë një ndjesi izolimi dhe ka shumë më pak mundësi që ato të marrin mbështetjen për të cilën kanë nevojë.

### Abuzimi psikologjik

Abuzimi psikologjik ndryshon nga abuzimi emocional, duke përfshirë një gamë sjelljesh që kanë si synim të trembin dhe të shkaktojnë frikë te gratë, t'i kontrollojnë dhe t'i izolojnë ato nga familja dhe miqtë, dhe t'u mohojnë atyre mundësinë për të punuar jashtë shtëpisë ose nëse ato punojnë jashtë shtëpisë, për t'u marrë dhe për të kontrolluar pagën e tyre. Gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh jetojnë në frikë, përjetojnë ankth dhe vështirësi në përqendrim, kanë performancë të dobët në punë, paraqesin probleme shëndetësore fizike dhe rrezikojnë seriozisht të kalojnë në depresion dhe gjithashtu janë të rrezikuara nga mendimet dhe përpjekjet për vetëvrasje.

Lidhur me abuzimin psikologjik, tabela 4.3 tregon format e ndryshme të abuzimit psikologjik që u matën në vrojtim dhe që ishin përjetuar nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç në martesën ose lidhjet e tyre intime. Format më të përhapura të abuzimit psikologjik të përjetuara nga gratë përfshijnë sjelljet dominuese. Nga 2590 gra

**Tabela 4.3. Abuzimi psikologjik i përjetuar nga gratë nga moshë 15 deri në 49 vjeç**

	Nr.=2590									
	Ndonjëherë		Aktualisht		Shpeshhtësia gjatë 12 muajve të kaluar					
					Shpesh		Ndonjëherë		Aspak	
Abuzimi psikologjik	nr	%	nr	%	Nr.	%	nr	%	nr	%
Nuk ju jep para	451	17.4	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Nuk ju lejon të takoni shoqet tuaja	410	15.8	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Ju kufizon takimin me familjen tuaj	120	4.6	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Këmbëngul që ta dijë në çdo kohë se ku jeni	861	33.2	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Kërcënon t'ju lëndoje ose t'ju dëmtojë juve ose ndonjë të afërmin tuaj	131	5.1	78	3.0	20	.8	58	2.2	53	2.0
Ju kërcënon me thikë ose me ndonjë armë tjetër	61	2.4	21	.8	6	.2	14	.6	10	.4

\*NA = Jo e disponueshme (nuk është matur)

të anketuara, 33,2% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri i tyre insiston të dijë gjatë gjithë kohës se ku ndodhen ato. Veç kësaj, 17,4% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri i tyre nuk u jep para ose nuk i lejon ata të kenë kontroll mbi paratë dhe 15,8% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri nuk i lejon të takojnë shoqet e tyre.

Kanosjet për plagosje janë një tjetër formë e abuzimit psikologjik që meshkujt abuzues përdorin për të ngjallur frikë dhe ankth dhe për të ruajtur kontrollin mbi gratë e tyre. Tabela 4.3 tregon që 5,1% e grave raportuan që bashkëshort/partneri i ka kërcënuar se do ta lëndojë ose do ta dëmtojë atë ose ndonjë të afërm të tyre dhe 2,4% raportuan që bashkëshorti/partneri i ka kërcënuar ato me thikë ose me ndonjë armë tjetër.

Shpeshherë gratë e dhunuara përjetojnë forma të ndryshme të abuzimit psikologjik në martesën ose në lidhjet e tyre. Figura 4.6 tregon përqindjen e grave të cilat kanë raportuar se kanë përjetuar një ose më shumë nga gjashtë format e abuzimit psikologjik të identifikuar në tabelën 4.3. Është e rëndësishme të theksohet që ndërkohë që 39,1% e grave raportuan se kishin përjetuar abuzim psikologjik nga ana e bashkëshortit/partnerit të tyre, vetëm 31,0% e grave raportuan se ato nuk kishin përjetuar ndonjë nga format e abuzimit psikologjik të matur në këtë vërtetim. Kjo do të thotë që një përqindje e konsiderueshme e grave (29,6%) nuk u përgjigj ose nuk kishte dëshirë të shprehte eksperiencat e tyre mbi abuzimin psikologjik. Është gjithashtu e rëndësishme të


kujtojmë që gratë mund të kenë përjetuar forma të tjera të abuzimit psikologjik, të cilat nuk janë matur në vërtetim.

Figura 4.5 tregon që nga 2590 gra të anketuara, 17,6% raportuan që kishin përjetuar një prej formave të abuzimit psikologjik në tabelën 4.3, 10,7% kishin përjetuar dy forma të abuzimit psikologjik, 6,0% kishin përjetuar tre forma të abuzimit psikologjik dhe 2,0% kishin përjetuar katër forma të abuzimit psikologjik. Ndikimet afatgjata të abuzimit psikologjik në format e tij të ndryshme janë të rënda për gratë e dhunuara (shihni gjithashtu tabelën 5 në shtojcë).

Për të kuptuar ndryshimet demografike në eksperiencat e grave me abuzimin psikologjik në martesën ose në lidhjen e tyre intime, të dhënat u përdorën për të përcaktuar nëse një grua ka përjetuar ndonjëherë një ose më shumë nga format e ndryshme të abuzimit psikologjik të listuara në tabelën 4.3. Pas kësaj, janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore demografike të theksuara, të cilat mund të na ndihmonin për të kuptuar abuzimin psikologjik të grave në martesë ose në lidhjet intime.

Lidhur me abuzimin psikologjik, nuk ka pasur ndryshime të theksuara midis grupmoshave – gratë në secilën prej grupmoshave të ndryshme kanë përjetuar pothuajse të gjitha njëjloj ndonjëherë abuzim psikologjik në martesën ose në lidhjen e tyre intime. Gjithashtu nuk ka pasur as ndryshime të theksuara në eksperiencat e grave me abuzimin

**Figura 4.5. Format e ndryshme të abuzimit psikologjik të përjetuara nga gratë nga moshë 15 deri në 49 vjeç**




\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=823; 31,8%)

psikologjik bazuar në statusin e punësimit – gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë kishin përjetuar njëloj abuzim psikologjik nga bashkëshorti/partneri sa edhe gratë të cilat nuk punonin jashtë shtëpisë në muajin para vërtimit (shihni tabelën 6 në shtojcë).

jetonin me dikë (55,0%). Është e rëndësishme të theksohet që nuk ka pasur ndonjë ndryshim të theksuar midis grave të martuara dhe atyre të divorcuara/ndara në lidhje me faktin nëse ato ishin duke përjetuar “aktualisht” abuzim psikologjik nga ana e partnerit (brenda 12 muajve para intervistës; shihni gjithashtu tabelën 6 në shtojcë).

**Figura 4.6. Abuzimi psikologjik sipas nivelit të arsimimit**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.


Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet që nuk ka pasur ndryshime të theksuara mes zonave urbane dhe rurale në lidhje me eksperiencat e grave me abuzimin psikologjik – gratë të cilat jetonin në zonat rurale nuk kishin më shumë gjasa të përjetonin abuzim psikologjik në krahasim me gratë që jetojnë në zonat urbane (shihni tabelën 6 në shtojcë).

Figura 4.6 tregon që ka pasur ndryshime të theksuara në eksperiencat e grave me abuzimin psikologjik bazuar në nivelin e arsimit. Veçanërisht, nga 1817 gra të anketuara, gratë me arsim universitar (46,0%) kishin më pak gjasa të përjetonin abuzim psikologjik krahasuar me gratë me arsim të mesëm (56,2%), me arsim nëntëvjeçar (56,9%), me arsim fillor (62,5%) dhe me ato të paarsimuara (66,7%; shihni gjithashtu tabelën 6 në shtojcë).

Gjithashtu ka pasur ndryshime të theksuara bazuar në gjendjen civile në lidhje me eksperiencat e grave me abuzimin psikologjik në martesën ose lidhjet e tyre intime. Figura 4.7 tregon që nga 1823 gra të anketuara, gratë e divorcuara ose të ndara (76,6%) ishin ato që kishin më shumë gjasa që të kishin përjetuar ndonjëherë abuzim psikologjik, krahasuar me gratë e martuara ose ato të cilat

abuzimi psikologjik shpesh shoqërohet me abuzimin emocional dhe përkeqësohet me kalimin e kohës. Në mënyrë të ngjashme me abuzimin emocional, shenjat e abuzimit psikologjik janë të vërteta dhe shpesh depërtojnë thellë te gratë e dhunuara. Gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shqyrtojnë mundësitë e tyre dhe të organizojnë burimet që iu nevojiten për të braktisur një lidhje abuzive.

**Figura 4.7. Abuzimi psikologjik sipas gjedjes civile të grave**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.



## Dhuna fizike

Kur njerëzit bisedojnë rreth dhunës në familje, shpesh i referohen abuzimit fizik të një bashkëshorti ose partneri intim. Abuzim fizik është përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që e lëndon ose e rrezikon atë person. Abuzimi fizik në situatat e dhunës në familje përfshin një gamë të gjerë sjelljesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në goditje, rrahje, rrëmbime, shkëmbim, mbytje, shkulje të flokëve dhe sulm me armë. Sulmi fizik ose rrahja e një partneri ose e një anëtarit të familjes konsiderohet krim qoftë kur ndodh brenda shtëpisë, qoftë kur ndodh jashtë saj.

Tabela 4.4 tregon format e ndryshme të dhunës fizike që u matën në vrojtim dhe që ishin përjetuar nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç në martesën ose në lidhjet e tyre intime. Nga 2590 gra të anketuara, 26,4% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri i ka gjuajtur ose shtyrë ato, 20,2% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri

mbyste ose t'i digjte ato. Dhuna fizike në këto forma të ndryshme shpesh rezulton në dëmtime të viktimës dhe këto dëmtime shpesh kanë efekte anësore në shëndetin fizik afatshkurtër dhe afatgjatë, si dhe mirëqenien e grave të dhunuara.

Gratë të cilat kanë raportuar që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë fizike në martesën ose lidhjet e tyre intime, janë pyetur nëse ato ishin aktualisht duke përjetuar një abuzim të tillë nga bashkëshorti/partneri i tyre, dhe për shpeshësinë e një dhune të tillë (p.sh. "Sa shpesh ju ka ndodhur gjatë 12 muajve të kaluar?"). Tabela 4.4 tregon që 23,8% e grave raportuan se në shumë raste bashkëshorti/partneri i tyre i ka hedhur ose i ka shtyrë ato (nga ndonjëherë deri në shpeshherë) gjatë 12 muajve të kaluar (aktualisht). Përveç kësaj, 17,3% e grave raportuan se në shumë raste bashkëshorti/partneri i tyre i ka goditur ato (nga ndonjëherë deri në shpeshherë) gjatë 12 muajve të kaluar. Gjithashtu, 9,3% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre i ka tërhequr ato nga flokët në shumë raste në 12 muajt e kaluar dhe

**Tabela 4.4. Dhuna fizike e përjetuar nga gratë nga moshë 15 deri në 49 vjeç**

	Nr.=2590									
	Ndonjëherë		Aktualisht		Shpeshësia gjatë 12 muajve të kaluar					
					Shpesh		Ndonjëherë		Aspak	
Dhuna fizike	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Ju hedh ose ju shtyn	683	26.4	616	23.8	91	3.5	525	20.3	67	2.6
Ju rreh	522	20.2	447	17.3	54	2.1	393	15.2	75	2.9
Ju shkul flokët	277	10.7	241	9.3	46	1.8	195	7.5	36	1.4
Ju godet me një objekt ose diçka tjetër që mund t'ju dëmtojë	114	4.4	101	3.9	25	1.0	76	2.9	14	.5
Ju ka gjuajtur me shkëlqim ose ju ka tërhequr zvarrë	61	2.4	50	1.9	21	.8	29	1.1	11	.4
Ka tentuar t'ju mbysë ose t'ju djegë	27	1.0	18	.7	8	.3	10	.4	9	.3

\*NA = Jo e disponueshme (nuk është matur)

i tyre i ka rrahur ato, 10,7% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre i ka tërhequr nga flokët, 4,4% raportuan se bashkëshorti/partneri i ka goditur ato me objekte të forta ose me sende të tjera të kësaj natyre që mund t'i lëndonte ato, 2,4% raportuan se ato ishin gjuajtur ose zvarritur nga bashkëshorti/partneri i tyre dhe 1,0% thanë se bashkëshorti/partneri i tyre ishte përpjekur t'i


3,9% e grave raportuan se në shumë raste gjatë 12 muajve të kaluar bashkëshorti/partneri i tyre i ka goditur ato me një objekt ose me diçka tjetër që mund t'i lëndonte ato.

Në mënyrë tipike gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një formë të dhunës fizike në martesën ose lidhjen e tyre intime, por shpesh përjetojnë forma

të ndryshme të dhunës fizike. Figura 4.10 tregon përqindjen e grave të cilat kanë raportuar se kanë përjetuar një ose më shumë nga gjashtë format e dhunës fizike të identifikuar në tabelën 4.4. Është e rëndësishme të theksohet që ndërkohë që 31,2% e grave raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike, 45,6% e grave raportuan se ato nuk kishin përjetuar ndonjë nga format e dhunës fizike të matura në vërtetim. Veç kësaj, 23,2% e grave nuk iu

përjetuar tre forma të dhunës fizike, 1,4% kanë përjetuar katër forma të dhunës fizike dhe kështu me radhë. Ndikimet e dhunës fizike në format e saj të ndryshme ndaj grave të dhunuara shpesh mund të jenë të rënda, të cilat mund të çojnë në probleme afatshkurtra ose afatgjata të shëndetit fizik, paaftësi, madje dhe vdekje të shkaktuar nga vrasja ose vetëvrasja (shihni gjithashtu tabelën 7 në shtojcë).

**Figura 4.8. Format e ndryshme të dhunës fizike të përjetuara nga grate e moshës 15 deri në 49 vjeç**




\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=602; 23,2%)

përgjigjën ose nuk kishin dëshirë t'u përgjigjeshin pyetjeve mbi dhunën fizike në martesën ose lidhjen e tyre intime. Nuk duhet harruar se gratë mund të përjetojnë forma të tjera të dhunës fizike, të cilat nuk janë matur në vërtetim. Figura 4.8 tregon që nga 2590 gra të dhunuara, 12,8% kanë përjetuar vetëm një formë të dhunës fizike të paraqitur në tabelën 4.4, ndërkohë që 9,8% kanë përjetuar dy forma të dhunës fizike, 5,0% kanë

Për të kuptuar ndryshimet demografike në eksperiencat e grave me dhunën fizike në martesën ose në lidhjen e tyre intime, të dhënat u përdorën për të përcaktuar nëse një grua ka përjetuar ndonjëherë një ose më shumë nga format e ndryshme të dhunës fizike të listuara në tabelën 4.4. Pas kësaj, janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore demografike të

**Figura 4.9. Dhuna fizike sipas nivelit të arsimit**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë


theksuara, të cilat mund të na ndihmonin për të kuptuar dhunën fizike të grave në martesë ose në lidhjet intime.

Lidhur me dhunën fizike, nuk ka pasur ndryshime të theksuara bazuar në statusin e punësimit – gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë kishin po aq gjasa që të përjetonin dhunë fizike nga bashkëshorti/partneri sa edhe gratë të cilat nuk punonin jashtë shtëpisë në muajin përpara intervistës (shihni tabelën 8 në shtojcë).

Megjithatë, ka pasur ndryshime të theksuara bazuar në nivelin e arsimit. Figura 4.9 tregon që megjithëse një përqindje e konsiderueshme e grave në secilën nga kategoritë e nivelit të arsimimit ka përjetuar dhunë fizike në martesën ose lidhjen e tyre intime, nga 1982 gra të anketuara, gratë me arsim universitar kishin shumë më pak gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë me një nivel më të ulët arsimor. Gratë me arsim fillor (70,4%) ishin ato që raportuan më së shumti dhunën fizike të ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti/partneri i tyre (shihni gjithashtu tabelën 8 në shtojcë).

Figura 4.10 tregon ndryshimin e theksuar në eksperiencat e grave me dhunën fizike bazuar në gjendjen civile të grave. Ndonëse një përqindje e konsiderueshme e grave në secilën kategori ka përjetuar dhunë fizike, nga 1988 gra të anketuara, gratë e divorcuara ose të ndara (66,7%) ishin në mënyrë të theksuar ato që raportuan më së shumti se ishin dhunuar ndonjëherë fizikisht nga

**Figura 4.10. Dhuna fizike sipas gjendjes civile**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë e martuara ose me ato që jetonin me një partner (40,0%; shihni gjithashtu tabelën 8 në shtojcë).

Është e rëndësishme të theksohet që gratë e martuara ose ato që jetonin me një partner ishin ato që raportuan më së shumti se “aktualisht” ato përjetonin dhunë fizike krahasuar me gratë e divorcuara ose të ndara; megjithatë, 44% deri në 68% e grave të divorcuara ose të ndara raportuan që kishin përjetuar dhunë fizike brenda 12 muajve para intervistës (përqindjet ishin të ndryshme midis gjashtë llojeve të ndryshme të dhunës fizike; shihni gjithashtu tabelën 8 në shtojcë).

**Figura 4.11. Dhuna fizike sipas vendbanimit rural kundrejt atij urban**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Gjithashtu ka pasur ndryshime të theksuara mes zonave urbane dhe rurale lidhur me eksperiencat e grave me dhunën fizike në martesën ose lidhjen e tyre intime. Figura 4.11 tregon se megjithëse një përqindje e konsiderueshme e grave në të dyja zonat, rurale dhe urbane, kishte përjetuar ndonjëherë dhunë fizike në martesën ose lidhjen e tyre intime, gratë që jetonin në zonat rurale (47,5%) kishin dukshëm shumë më tepër gjasa që të dhunoheshin fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë që jetonin në zonat urbane (35,1%; shihni gjithashtu tabelën 8 në shtojcë).

Figura 4.12 tregon gjithashtu ndryshimet e theksuara mes grupmoshave. Nga 1988 gra të anketuara, gratë nga mosha 26 vjeç e sipër ishin në mënyrë të theksuar ato që raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga bashkëshorti/partneri i

tyre, krahasuar me gratë në grupmoshat 15 deri në 17 vjeç, 18 deri në 21 vjeç dhe 22 deri në 25 vjeç (shihni gjithashtu tabelën 8 në shtojcë). Ky ndryshim mund të shpjegohet pjesërisht nga fakti që gratë nga mosha 26 vjeç e sipër në mënyrë të theksuar kishin më tepër mundësi të ishin të martuara ose të jetonin me një partner krahasuar me gratë nën moshën 26 vjeç, dhe kjo vlerë e lartë e dhunës fizike që duket të ndodhë në jetët e grave qëndron brenda kontekstit të martesës dhe lidhjeve intime.


Lëndimet dhe shenjat e dhunës fizike janë të vërteta te gratë e dhunuara dhe ato shpesh përpiqen t'i mbulojnë dhe t'i fshehin lëndimet dhe shenjat për arsye të turpfit dhe të sikletit. Megjithatë, dhuna fizike dhe lëndimet e lidhura me të, shpesh grumbullohen dhe çojnë në probleme të tjera afatshkurtra ose afatgjata të shëndetit fizik, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në shëndetin emocional dhe mirëqenien e gruas. Në zonat dhe krahinat rurale ku kujdesi shëndetësor i urgjencës ose nuk mund të sigurohet shpejt, ose madje është i pa disponueshëm, gratë e dhunuara fizikisht rrezikohen shumë nga lëndimi i vazhdueshëm, paaftësia ose edhe nga vdekja nga plagët e marra.

përjetojnë një ndjesi izolimi dhe kanë shumë më pak mundësi që të marrin mbështetjen për të cilën kanë aq shumë nevojë.

### Dhuna seksuale

Lloji i katërt dhe i fundit i dhunës në familje i matur në këtë vrojtim është dhuna seksuale. Dhuna seksuale përfshin çdo situatë në të cilën një grua detyrohet të marrë pjesë në një aktivitet seksual të degraduar, të padëshiruar ose të pasigurt (kjo përfshin seksin e detyruar nga ana e bashkëshortit/partnerit me të cilin gruaja kryen gjithashtu seks me pëlqimin e saj). Tabela 4.5 tregon dy forma të dhunës seksuale që u matur në vrojtim dhe që ishin përjetuar nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç në martesën ose në lidhjet e tyre intime. Nga 2590 gra të anketuara, 12,7% e grave raportuan që bashkëshorti/partneri i tyre i ka detyruar ato të kryejnë marrëdhënie seksuale të padëshiruara, dhe 1,3% raportuan që bashkëshorti/partneri i tyre i ka detyruar ato të kryejnë akte seksuale poshtëruese të padëshiruara nga ana e tyre. Veç kësaj, 12,1% e grave raportuan që gjatë 12 muajve para intervistës ato shpeshherë janë detyruar nga bashkëshorti/partneri i tyre

**Figura 4.12. Dhuna fizike sipas grupmoshës**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Gratë e dhunuara fizikisht shpesh e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shqyrtojnë mundësitë e tyre dhe të organizojnë burimet që iu nevojiten për të braktisur një lidhje abuzive. Gratë në zonat dhe krahinat rurale, ku nuk ka ose ka shërbime të kufizuara për mbështetjen e viktimave, kanë shumë më tepër mundësi që të

(nga ndonjëherë deri në shpeshherë) për të kryer marrëdhënie seksuale të padëshiruara.

Fakti që vetëm 13% deri në 14% e grave raportuan që kishin përjetuar dhunë seksuale në martesën ose lidhjen e tyre intime është një pasqyrim i faktit që dhunimet e trupit të gruas shpesh

justifikohen brenda kontekstit të martesës përmes vlerave kulturore dhe fetare që i përcaktojnë gratë si pronë e burrave dhe seksin si një

e dhunës seksuale të identifikuar në tabelën 4.5 (shihni gjithashtu tabelën 9 në shtojcë). Për të kuptuar ndryshimet demografike në

**Tabela 4.5. Dhuna seksuale e përjetuar nga gratë nga mosha 15 deri në 49 vjeç**

	Nr.=2590									
	Ndonjëherë		Aktualisht		Shpeshtësia gjatë 12 muajve të kaluar					
	nr	%	nr	%	Shpesh		Ndonjëherë		Aspak	
Dhuna seksuale	nr	%	nr	%	Nr	%	nr	%	nr	%
Ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale pa dëshirën tuaj	328	12.7	313	12.1	37	1.4	276	10.7	15	.6
Ju detyron me forcë të kryeni akte seksuale poshtëruese dhe të padëshiruara	34	1.3	24	.9	10	.4	14	.5	10	.4

\*NA = Jo e disponueshme (nuk është matur)


detyrim martesor të bashkëshorteve. Për më tepër, zhvirgjërimi me forcë gjatë natës së parë të martesës dhe si rrjedhojë marrëdhënia e detyruar nga bashkëshortët i bën gratë të nënshtruara ndaj marrëdhënies seksuale të padëshiruara gjatë gjithë martesës së tyre (6, 7). Kështu, gratë do të ishin më pak të prirura t'i përcaktojnë marrëdhëniet seksuale me forcë brenda kontekstit të martesës si një përdhunim martesor ose dhunë seksuale; kështu pra, shpjegohet pjesërisht se pse 64% e grave raportuan që ato nuk kishin përjetuar dhunë seksuale në martesën e tyre.

Figura 4.13 tregon se nga 2590 gra të anketuara, 11,5% e grave kishin përjetuar një formë të dhunës seksuale, dhe 1,2% kishin përjetuar dy nga format

eksperiencat e grave me dhunën seksuale në martesën ose në lidhjen e tyre intime, të dhënat janë përdorur për të përcaktuar nëse një grua ka përjetuar ndonjëherë një ose më shumë nga format e ndryshme të dhunës seksuale të listuara në tabelën 4.5. Pas kësaj, janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore të theksuara demografike, të cilat mund të na ndihmonin ne për të kuptuar abuzimin seksual të grave në martesën ose në lidhjet intime.

Lidhur me dhunën seksuale, nuk ka pasur ndryshime të theksuara bazuar në nivelin e arsimit të grave – gratë e paarsimuara ose pak të arsimuara kishin po aq gjasa sa edhe gratë me

**Figura 4.13. Format e ndryshme të dhunës seksuale të përjetuara nga gratë nga mosha 15 deri në 49 vjeç**



\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=602; 23,2%)


arsim të mesëm ose universitar që të përjetonin dhunë seksuale në martesën ose lidhjen e tyre intime. Gjithashtu nuk ka pasur ndryshime të theksuara bazuar në statusin e punësimit së grave – gratë të cilat kanë punuar jashtë shtëpisë kishin po aq gjasa sa edhe gratë të cilat nuk kishin punuar jashtë shtëpisë që të përjetonin dhunë seksuale nga bashkëshorti/partneri gjatë muajit para intervistës (shihni gjithashtu tabelën 10 në shtojcë).

Gjithashtu nuk ka pasur ndryshime të theksuara në eksperiencën e grave me dhunën seksuale në martesën ose lidhjen e tyre intime bazuar në zonat urbane dhe rurale – gratë që jetonin në zonat rurale raportuan se ishin abuzuar seksualisht nga bashkëshorti/partneri e tyre po aq sa edhe gratë që jetonin në zonat urbane (shihni gjithashtu tabelën 10 në shtojcë).

Gjithsesi, ka pasur ndryshime të theksuara në eksperiencat e grave me dhunën seksuale bazuar në gjendjen civile. Figura 4.14 tregon se nga 1988 gra të anketuara, gratë e divorcuara ose të ndara (33,3%) ishin në mënyrë të theksuar ato që kishin përjetuar dhunë seksuale nga bashkëshorti/partneri i tyre intim krahasuar me gratë e martuara ose me ato që jetonin me një partner intim (16,2%). Lidhur me dhunën seksuale aktuale, gratë e martuara ose ato që jetonin me një partner intim ishin ato që kishin më shumë gjasa që të përjetonin dhunë seksuale brenda 12 muajve para intervistës, krahasuar me gratë e divorcuara ose të ndara. Megjithatë, 44% deri në 53% e grave të divorcuara ose të ndara raportuan se ato kishin përjetuar një nga dy format e dhunës seksuale brenda 12 muajve para intervistës (shihni gjithashtu tabelën 10 në shtojcë).


Ka pasur gjithashtu ndryshime të theksuara sipas grupmoshave. Figura 4.15 tregon se nga 1988 gra të anketuara, gratë në grupmoshat 26 deri në 29 vjeç (18,0%), 30 deri në 33 vjeç (17,6%), 34 deri në 37 vjeç (16,0%), 38 deri në 41 vjeç (17,7%), 42 deri në 45 vjeç (17,5%), dhe 46 deri në 49 vjeç (19,5%) kishin më shumë gjasa që të përjetonin dhunë seksuale nga bashkëshorti/partneri i tyre intim, krahasuar me gratë në grupmoshat 15 deri në 17 vjeç (0,0%), 18 deri në 21 vjeç (6,3%) dhe 22 deri në 25 vjeç (7,6%). Ky ndryshim mund të shpjegohet pjesërisht nga fakti që gratë nga moshë 26 vjeç e sipër kishin më tepër mundësi që të ishin të martuara krahasuar me gratë nën moshën 26 vjeç, dhe kjo vlerë e lartë e dhunës seksuale që duket të ndodhë në jetët e grave qëndron brenda kontekstit të martesës (shihni gjithashtu tabelën 10 në shtojcë).

**Figura 4.14. Dhuna seksuale sipas gjendjes civile**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Figura 4.15. Dhuna seksuale sipas grupmoshës**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Në disa shoqëri dhe kultura, dhuna seksuale brenda kontekstit të martesës shpesh justifikohet nëpërmjet vlerave kulturore dhe fetare që e përcaktojnë gruan si pronë të burrit dhe seksin si një detyrim martesor të bashkëshorteve, dhe në rrethana të tilla gratë e dhunuara seksualisht do të jenë më pak të predispozuara ta përcaktojnë agresionin seksual të bashkëshortit të tyre ose sjelljet seksuale abuzive si dhunë seksuale ose përdhunim martesor. Shpeshherë gratë i nënshtrohen marrëdhënieve seksuale të padëshiruara me bashkëshortët e tyre (8,9).

Është e rëndësishme të theksohet që dhuna seksuale brenda kontekstit të martesës ose lidhjeve intime është një formë serioze dhe mjaft e përhapur e dhunës në familje ndaj grave. Studimi tregon që përdhunimi martesor shpesh ka pasoja të rënda për gruan, të cilat zgjasin për një kohë të gjatë. Rezultatet fizike të abuzimit seksual mund të përfshijnë dëmtime të organeve riprodhuese të gruas dhe të zonave rreth vaginës dhe anusit (p.sh. gërvishtje, dhimbje, mavijosje dhe tërheqje të muskujve). Gratë të cilat janë dhunuar seksualisht ose janë përdhunuar nga bashkëshorti/partneri i tyre intim vuajnë gjithashtu dëmtime të tjera fizike (p.sh. kocka të thyera, sy të nxirë, plagë me thikë) që ndodhin gjatë aktit të dhunës seksuale. Ato gjithashtu përjetojnë probleme specifike gjinekologjike, si për shembull zgjerim të vaginës, çarje të anusit, dhembje të legenit, infeksione të rrugëve urinare, aborte, lindje të vdekura, infeksione të fshikëzës së urinës dhe shterpësi. Studimi ka zbuluar gjithashtu se gratë të cilat janë dhunuar seksualisht ose janë përdhunuar nga bashkëshorti/partneri i tyre intim shpeshherë kufizohen nga bashkëshorti/partneri i tyre intim për të përdorur kontraktivët duke u rrezikuar kështu të përballen me shtatzënitë e padëshiruara dhe me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë këtu HIV/AIDS (10,11). Gratë e dhunuara

seksualisht ose të përdhunuar nga bashkëshorti/partneri i tyre intim kanë shumë gjasa të përjetojnë dhunime të ndryshme dhe sulme të plota seksuale. Ato përdhunohen nga dikush të cilin e duan dhe e respektojnë; kështu që nuk është e çuditshme që të mbijetuarat nga dhuna seksuale dhe përdhunimi martesor shpeshherë të vuajnë pasoja të rënda psikologjike që zgjasin për një kohë të gjatë, duke përfshirë këtu: ankthin, tronditjen, frikën e thellë, depresionin, mendimet dhe përpjekjet për vetëvrasje, çrregullimet me ushqimin dhe gjumin dhe çrregullimin *post* traumatik të stresit (12,13). Disa prej personave që i mbijetojnë përdhunimit martesor raportojnë gjithashtu kujtesë të fortë të ngjarjeve të kaluara, shqetësim dhe disfunktion seksual, si dhe vuajtje emocionale për vite me radhë pas dhunës (14,15).

### Llojet e ndryshme të dhunës në familje

Është e dokumentuar më së miri se gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një formë të dhunës në familje, – emocionale, psikologjike, fizike ose seksuale – por shpeshherë ato përjetojnë njëherazi lloje të ndryshme të dhunës. Për shembull, gratë e abuzuara emocionalisht shpeshherë përjetojnë edhe abuzim psikologjik. Gratë e abuzuara emocionalisht dhe/ose psikologjikisht shpeshherë janë të dhunuara edhe fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Në lidhjet abuzive, gratë e dhunuara seksualisht shpeshherë janë të dhunuara edhe fizikisht, si edhe të abuzuara emocionalisht dhe psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim (16, 17).

Tabela 4.6 tregon lidhjen mes abuzimit emocional dhe llojeve të tjera të dhunës në familje Gratë e abuzuara emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim kanë më shumë gjasa të

**Tabela 4.6. Lidhja mes abuzimit emocional dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

Abuzimi emocional	Nr.=1587				Nr.=1661				Nr.=1661			
	Abuzimi psikologjik				Dhuna fizike				Dhuna seksuale			
	Po		Jo		Po		Jo		Po		Jo	
	nr	%	nr	%	nr	%	Nr	%	nr	%	nr	%
Po	751	60.6	489	39.4	588	44.9	723	55.1	196	15.0	1,115	85.0
Jo	60	17.3	287	82.7	3	.9	347	99.1	1	.3	349	99.7

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

përrjetojnë abuzim psikologjik, dhunë fizike dhe dhunë seksuale në martesën ose në lidhjen e tyre intime. Në veçanti, 60,6% e grave të abuzuara emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim ishin gjithashtu të abuzuara edhe psikologjikisht. Veç kësaj, 44,9% e grave të abuzuara emocionalisht ishin gjithashtu të dhunuara edhe fizikisht, dhe 15,0% ishin të dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Në këtë mënyrë, abuzimi emocional është një parashikues i saktë i llojeve të tjera të abuzimit dhe dhunës në martesën ose lidhjen e tyre intime (shihni gjithashtu tabelën 11, 12 dhe 13 në shtojcë).

përrjetojnë gjithashtu lloje të tjera të abuzimit dhe të dhunës në martesën ose në lidhjen e tyre intime (shihni gjithashtu tabelën 14, 15 dhe 16 në shtojcë).

Tabela 4.8 tregon lidhjen mes dhunës fizike dhe llojeve të tjera të dhunës në familje Gratë e dhunuara fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim kanë dukshëm shumë më tepër gjasa të përrjetojnë abuzim emocional, abuzim psikologjik dhe dhunë seksuale, krahasuar me gratë që nuk janë të dhunuara fizikisht. Në veçanti, 95,5% e grave të dhunuara fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim ishin gjithashtu të dhunuara

**Tabela 4.7. Lidhja mes abuzimit psikologjik dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

Abuzimi psikologjik	Nr.=1587				Nr.=1823				Nr.=1823			
	Abuzimi emocional				Dhuna fizike				Dhuna seksuale			
	Po		Jo		Po		Jo		Po		Jo	
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Po	751	92.6	60	7.4	573	56.6	440	43.4	243	24.0	770	76.0
Jo	489	63.0	287	37.0	122	15.1	688	84.9	28	3.5	782	96.5

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela 4.7 tregon lidhjen mes abuzimit psikologjik dhe llojeve të tjera të dhunës në familje Gratë e abuzuara psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim kanë dukshëm më shumë gjasa të përrjetojnë abuzim emocional, si dhe dhunë fizike dhe seksuale. Në veçanti, 92,6% e grave të abuzuara psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim ishin gjithashtu të abuzuara edhe emocionalisht. Veç kësaj, 56,6% e grave të abuzuara psikologjikisht ishin gjithashtu të dhunuara edhe fizikisht, dhe 24,0% ishin të dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Kini parasysh se abuzimi psikologjik është një parashikues edhe më i saktë që gratë

edhe emocionalisht. Veç kësaj, 82,4% e grave të dhunuara fizikisht ishin gjithashtu të abuzuara edhe psikologjikisht, dhe 35,8% ishin të dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Prania e dhunës fizike është një parashikuese akoma më e saktë se ndodhin llojet e tjera të abuzimit dhe të dhunës në martesë ose në lidhjen intime (shihni gjithashtu tabelën 17, 18 dhe 19 në shtojcë).

Në përfundim, tabela 4.9 tregon lidhjen mes dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës në familje Gratë e dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim kanë dukshëm

**Tabela 4.8. Lidhja mes dhunës fizike dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

Dhuna fizike	Nr.=1661				Nr.=1823				Nr.=1988			
	Abuzimi emocional				Abuzimi psikologjik				Dhuna seksuale			
	Po		Jo		Po		Jo		Po		Jo	
	nr	%	Nr.	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Po	588	95.5	3	.5	573	82.4	122	17.6	289	35.8	519	64.2
Jo	723	67.6	347	32.4	440	39.0	688	61.0	41	3.5	1,139	96.5

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.



shumë më tepër gjasa të përjetojnë abuzim emocional, abuzim psikologjik dhe dhunë fizike, krahasuar me gratë që nuk janë të dhunuara seksualisht. Në veçanti, 99,5% e grave të

abuzim emocional dhe psikologjik, dhe 35% të sigurt që ajo dhunohet edhe seksualisht në martesën ose lidhjen e saj intime.

**Tabela 4.9. Lidhja mes dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

Dhuna seksuale	Nr.=1661				Nr.=1823				Nr.=1988			
	Abuzimi emocional				Abuzimi psikologjik				Dhuna fizike			
	Po		Jo		Po		Jo		Po		Jo	
	nr	%	nr	%	nr	%	Nr	%	nr	%	nr	%
Po	196	99.5%	1	.5	243	89.7	28	10.3	289	87.6	41	12.4
Jo	1,115	76.2	349	23.8	770	49.6	782	50.4	519	31.3	1,139	68.7

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim ishin gjithashtu të abuzuara edhe emocionalisht. Veç kësaj, 89,7% e grave të dhunuara seksualisht ishin gjithashtu të dhunuara edhe psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim, dhe 87,6% ishin të dhunuara fizikisht.

Gratë zakonisht nuk flasin për dhunimin seksual në martesën ose lidhjen e tyre intime; por kur e bëjnë një gjë të tillë, ne mund të jemi gati 90% të sigurt që një grua e dhunuar seksualisht është gjithashtu edhe një viktimë e abuzimit emocional, psikologjik dhe e dhunës fizike.

Prania e dhunës seksuale, ashtu si dhe dhuna fizike, është një parashikuese shumë e saktë e llojeve të tjera të abuzimit dhe e viktimave në martesë ose në lidhjen intime (shihni gjithashtu tabelën 20, 21 dhe 22 në shtojcë).

Pavarësisht niveleve të ndryshme të viktimizimit në jetën e shumë grave, një pjesë e madhe e tyre e durojnë abuzimin dhe dhunën duke i vuajtur ato në heshtje. Dhuna në familje është një formë shumë e rëndë e dhunës ndaj grave që shkakton pasoja serioze në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Tabelat 4.6 deri te 4.9 eliminojnë idenë e gabuar që gratë përjetojnë vetëm një formë të dhunës në martesën ose lidhjen e tyre intime. Ne nuk shikojmë të nxira dhe shenja nga abuzimi emocional dhe psikologjik, por nëse ne shikojmë një grua me të nxira, dëmtime dhe shenja nga abuzimi fizik jemi gati 80% deri në 90% të sigurt që gruaja e dhunuar fizikisht po përjeton edhe

#### Viti i martesës/lidhjes në të cilin fillon dhuna në familje

Tabela 4.10 tregon që pjesa më e madhe e grave të cilat kanë përjetuar dhunën në familje në

**Tabela 4.10. Viti pas martesës/bashkëjetesës kur ka filluar dhuna në familje si pas llojit të dhunës**

Vitet	Nr=581		Nr=569		Nr=771		Nr=295	
	Abuzimi emocional		Abuzimi psikologjik		Dhuna fizike		Dhuna seksuale	
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
1 vit	262	45.1	294	51.7	383	49.7	166	56.3
2-3 vjet	214	36.8	179	31.5	266	34.5	93	31.5
4-5 vjet	72	12.4	61	10.7	81	10.5	24	8.1
6-7 vjet	14	2.4	16	2.8	18	2.3	3	1.0
8-20 vjet	19	3.3	19	3.3	23	3.0	9	3.1

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

martesën ose lidhjen e tyre intime raportuan se dhuna kishte filluar brenda vitit të parë të martesës ose të bashkëjetesës me partnerin e tyre intim. Një pjesë tjetër prej 1/3 e grave raportuan se dhuna fizike ka filluar në vitin e 2-të ose të 3-të të martesës ose të bashkëjetesës me partnerin intim. Kështu, 82% deri në 88% e grave të cilat kishin përjetuar dhunën në familje raportuan se dhuna – emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale – kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës ose të bashkëjetesës me bashkëshortin ose partnerin e tyre intim. Nuk duhet harruar se gratë në kampion varionin nga mosha 15 deri në 49 vjeç, kështu që shumë prej tyre kanë jetuar për 10 deri në 30 vjet me dhunën në familje në martesën/lidhjen intime dhe në familjen e tyre.

### Dëmtimet që lidhen me dhunën në familje


Gratë e dhunuara shpesh përjetojnë dëmtime fizike nga dhuna fizike dhe seksuale. Shpeshherë dëmtimet fizike ekzistojnë në mënyrë të renditura nga dëmtime të lehta deri në më të rënda; ku më të rëndat janë ato me pasojë vdekjen nga dhunimi. Është e rëndësishme të kujtojmë se gratë e dhunuara shpeshherë ngurrojnë t'i raportojnë dëmtimet që ato pësojnë nga dhuna në familje, madje edhe te mjekët ose te punonjësit e kujdesit shëndetësor. Pavarësisht nga sfida për t'i bërë gratë të flasin rreth dëmtimeve të tyre, vrojtimi

ishte projektuar që të maste edhe dëmtimet e grave të lidhura me incidentet e dhunës në familje.

Figura 4.16 tregon se gratë që ishin të dhunuara fizikisht dhe seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim vuanin dëmtime të shkallëve të ndryshme. Bazuar në një kampion prej 808 grash të dhunuara fizikisht dhe 330 grash të dhunuara seksualisht, 43,6% e grave të dhunuara seksualisht dhe 37,0% e grave të dhunuara fizikisht raportuan se ishin dëmtuar me prerje, mavijosje dhe/ose vuanin dhembjet. Veç kësaj, 16,4% e grave të dhunuara seksualisht dhe 10,8% e grave të dhunuara fizikisht kishin përjetuar dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje dhe/ose nxjerrje të gjymtyrëve si rezultat i dhunës në familje. Gjithashtu, 4,8% e grave të dhunuara seksualisht dhe 4,6% e grave të dhunuara fizikisht kishin humbur ndjenjat si rezultat i dhunës. Në përfundim, 1% e grave të dhunuara seksualisht dhe fizikisht kishin përjetuar plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer dhe/ose dëmtime serioze (shihni gjithashtu tabelën 23 në shtojcë)

Tabela 4.11 tregon se gratë të cilat kanë vuajtur dëmtime që lidhen me dhunën në familje shpeshherë kanë qenë të paafta për të punuar për shkak të dëmtimeve të tyre. Numri mesatar i ditëve që gratë ishin të paafta për të punuar për shkak të dëmtimeve të dhunës në familje ishte 5.4 ditë. Nga 301 gra të cilat kishin përjetuar prerje,

Figura 4.16. Dëmtimet që lidhen me dhunën në familje



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela 4.11. Dëmtimet që lidhen me dhunën në familje si pas ndërprerjes nga puna**

	E paaftë për të punuar për shkak të dëmtimit		Numri i ditëve në të cilat janë të paaftha për punë					
			1-4 ditë		5-9 ditë		10-15 ditë	
Lloji i Dëmtimeve	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Prerje, mavijosje, dhembje	78	25.9	62	81.6	11	14.5	3	3.9
Dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh	44	50.6	29	69.0	10	23.8	3	7.1
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz	6	66.7	0	0.0	2	50.0	2	50.0
Humbje e ndjenjave	19	52.8	10	58.8	4	23.5	3	17.6

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

mavijosje dhe/ose dhembjet, 25,9% ishin të paaftha për të punuar për shkak të dëmtimeve të marra. Nga 76 gratë që raportuan se ishin të paaftha për të punuar për shkak të prerjeve, mavijosjeve dhe dhembjeve, 81,6% ishin të paaftha për të punuar për një deri në katër ditë, 14,5% ishin të paaftha për të punuar për pesë deri në nëntë ditë, dhe 3,9% ishin të paaftha për të punuar për 10 deri në 15 ditë për shkak të dëmtimit.

Nga 87 gra të cilat kishin përjetuar dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje dhe/ose nxjerrje të gjymtyrëve, 50,6% ishin të paaftha për të punuar për shkak të dëmtimeve të marra. Nga 42 gratë që raportuan se ato nuk ishin në gjendje të punonin për shkak të dëmtimeve të syrit, djegieve, ndrydhjeve dhe nxjerrjes së gjymtyrëve, 69,0% ishin të paaftha për të punuar për një periudhë nga një deri në katër ditë, 23,8% ishin të paaftha të punonin nga pesë deri në nëntë ditë dhe 7,1% ishin të paaftha të punonin nga 10 deri në 15 ditë për shkak të dëmtimit.

Nga nëntë gratë të cilat kishin përjetuar plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer dhe/ose dëmtim serioz, 66,7% ishin të paaftha për të punuar për shkak të dëmtimit. Në katër prej këtyre grave, 50,0% ishin të paaftha të punonin nga pesë deri në nëntë ditë dhe 50,0% ishin të paaftha të punonin nga 10 deri në 15 ditë për shkak të dëmtimit.

Në përfundim, nga 36 gratë që kishin përjetuar humbje të ndjenjave, 52,8% ishin të paaftha për të punuar për shkak të dëmtimit. Nga 17 gra që ishin të paaftha për të punuar për shkak të humbjes së

ndjenjave, 58,8% ishin të paaftha për të punuar për një deri në katër ditë, 23,5% ishin të paaftha për të punuar për pesë deri në nëntë ditë dhe 17,6% ishin të paaftha për të punuar për 10 deri në 15 ditë për shkak të dëmtimit; (shihni gjithashtu tabelat 24 dhe 25 në shtojcë).

Shpeshherë gratë e dhunuara vuajnë dëmtime të ndryshme si rezultat i dhunës në familje. Me kalimin e kohës, incidentet e përsëritura të dhunës në familje mund të rezultojnë në dëmtime të ndryshme të cilat kanë një ndikim negativ akumulues në shëndetin dhe mirëqenien e grave. Tabela 4.12 tregon që 94,3% nga 87 gratë që raportuan dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje dhe/ose nxjerrje gjymtyrësh si rezultat i dhunës në familje, kishin përjetuar gjithashtu edhe prerje, mavijosje dhe/ose dhembje. Veç kësaj, 29,9% e këtyre grave kishin përjetuar humbje të ndjenjave si rezultat i dhunës dhe 10,3% kishin përjetuar plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dhe/ose dëmtime serioze. Është e rëndësishme të theksohet që 88,9% e grave të cilat kishin përjetuar plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer dhe/ose dëmtime serioze si rezultat i dhunës në familje, kishin përjetuar gjithashtu humbje të ndjenjave dhe 100% e këtyre grave kishin përjetuar prerje, mavijosje, dhembje, dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje, dhe/ose nxjerrje gjymtyrësh.

Gratë që kishin përjetuar humbje të ndjenjave kishin gjithashtu shumë më tepër gjasa që të përjetonin secilën prej formave të tjera të dëmtimit fizik. Martesat dhe lidhjet intime abuzive

janë qartësisht të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e grave (shihni gjithashtu tabelën 26 në shtojcë).

dhe se ato rrezikojnë të infektohen nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Figura 4.17 tregon lidhjen mes abuzimit seksual

**Tabela 4.12. Llojet e dëmtimeve që lidhen me dhunën në familje**


Dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh	Prerje, mavijosje, dhembje				Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz				Humbje e ndjenjave			
	Po		Jo		Po		Jo		Po		Jo	
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
Po	82	94.3	5	5.7	9	10.3	78	89.7	26	29.9	61	70.1
Jo	219	29.9	514	70.1	0	0.0	733	100.0	10	1.4	723	98.6

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Ndonëse gratë nuk u pyetën në mënyrë specifike rreth dëmtimeve që lidhen me abuzimin seksual, gratë u pyetën: nëse bashkëshorti/partneri intim i tyre ka refuzuar ndonjëherë që ato të përdorin kontrollin e lindjeve ose të përdorin kontraktivët; rreth rrezikut të marrjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (STD), duke përfshirë këtu HIV/AIDS; dhe nëse kanë pasur ndonjëherë një sëmundje seksualisht të transmetueshme. Dikush mund të supozojë që gratë e dhunuara seksualisht kanë shumë më tepër gjasa të raportojnë se bashkëshorti/partneri i tyre intim nuk i lejon ato të përdorin kontraktivë

dhe kufizimeve të grave në përdorimin e kontraktivëve dhe rrezikun e infektimit me sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Nga 377 gra të anketuara, gratë e dhunuara seksualisht ishin gati tre herë më shumë që raportonin se bashkëshorti/partneri i tyre intim i kufizonte ose refuzonte që ato të përdornin kontraktivë, krahasuar me gratë jo të dhunuara seksualisht. Në veçanti, 21,1% e grave të dhunuara seksualisht raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre intim refuzonte ose i kufizonte ato në përdorimin e kontraktivëve.

**Figura 4.17. Dhunimi seksual dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Nga 1988 gra të anketuara, gratë e dhunuara seksualisht ishin rreth dy herë më shumë që mendonin se ato rrezikonin infektimin nga një sëmundje seksualisht e transmetueshme, përfshirë këtu HIV/AIDS, krahasuar me gratë jo të dhunuara seksualisht. Veç kësaj, gratë e dhunuara seksualisht ishin dy herë më shumë që kishin vuajtur nga një sëmundje seksualisht e transmetueshme, krahasuar me gratë jo të dhunuara seksualisht. Për më tepër, 30% nga 330 gratë e dhunuara seksualisht raportuan se vuanin nga një sëmundje seksualisht e transmetueshme (shihni gjithashtu tabelat 27 dhe 28 në shtojcë).

### Alkooli dhe dhuna në familje

Lidhja mes përdorimit/abuzimit me alkoolin dhe dhunës në familje është e ndërlikuar. Një nga mitet e dhunës në familje është që alkooli është një shkak madhor i dhunës në familje. Megjithatë, në realitet, alkooli nuk është shkaktar i dhunës në familje. Disa bashkëshortë/partnerë abuzivë mbështeten te përdorimi/abuzimi me alkoolin duke e përdorur këtë si një shfajësim kur bëhen të dhunshëm. Në raste të tilla, alkooli i mundëson


ushtruar forcë dhe kontroll mbi një person tjetër; kështu që nuk përfaqëson një humbje të kontrollit (19).

Nga 2590 gra të anketuara, 38,1% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre intim konsumonte alkool. Përveç kësaj, 4,6% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre dehet shpesh dhe 26,4% raportuan se kjo ndodh vetëm ndonjëherë (shihni tabelën 29 në shtojcë).

Figura 4.18 tregon se gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave përdorin/abuzonin me alkoolin kishin më shumë gjasa që të përjetonin dhunë në familje – emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale, krahasuar me gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave nuk konsumonin alkool. Në fakt, gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave konsumonin alkool kishin gati dy deri në tre herë më shumë gjasa që të përjetonin dhunë fizike dhe seksuale në martesën ose në lidhjen e tyre intime (shihni gjithashtu tabelën 30 në shtojcë).

Mund të thuhet gjithashtu se konsumimi i alkoolit mund të ketë një ndikim në ashpërsinë

**Figura 4.18. Konsumimi i alkoolit nga ana e bashkëshortit/partnerit intim dhe dhuna në familje**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

bashkëshortit/partnerit abuziv që të shfajësohet për sjelljet e tij të dhunshme si rezultat i alkoolit (18). Megjithëse përdorimi/abuzimi me alkoolin i një dhunuesi mund të ketë një ndikim në ashpërsinë e dhunës ose në lehtësinë me të cilën bashkëshorti/partneri intim mund të shfajësojë veprimet e tij, një bashkëshort/partner intim nuk bëhet i dhunshëm si rezultat i alkoolit. Pija nuk bën që një bashkëshort/partner abuziv të humbë kontrollin e tij. Dhuna në familje përdoret për të

e dhunës dhe në dëmtimet që gratë e dhunuara vuajnë si rezultat i dhunës në familje. Figura 4.19 tregon se nga 876 gratë e dhunuara fizikisht dhe/ose seksualisht, gratë të cilat raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre intim përdorte/abuzonte me alkoolin kishin më shumë gjasa të përjetonin dëmtime që lidhen me dhunën në familje. Në veçanti, gratë e dhunuara bashkëshortët/partnerët intim të të cilave

**Figura 4.19. Konsumimi i alkoolit nga ana e bashkëshortit/partnerit intim dhe dëmtimet që lidhen me dhunën në familje mes grave të dhunuara fizikisht dhe seksualisht**



\*Shënim: Përçiqndjet e krahasimit bazohen në përçiqndje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.


konsumonin alkool kishin dy herë më shumë gjasa që të përjetonin prerje, mavijosje dhe/ose dhembje që lidheshin me dhunën në familje. Gjithashtu, ato kishin pesë herë më shumë gjasa që të përjetonin dëmtime të syrit, djegie, ndrydhje dhe/ose nxjerrje gjymtyrësh nga dhuna në familje. Veç kësaj, ato kishin katër herë më shumë gjasa që të përjetonin plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer dhe/ose dëmtime serioze, dhe gjashtë herë më shumë gjasa që të përjetonin humbje të ndjenjave (shihni gjithashtu tabelën 31 në shtojcë)

### Dhuna në familje dhe niveli arsimor i bashkëshortit

U analizua lidhja mes nivelit arsimor të bashkëshortëve dhe katër llojeve të dhunës në


familje – emocionale, psikologjike, fizike dhe seksuale – të përjetuar nga gratë. Nuk pati një lidhje statistikore të theksuar mes nivelit arsimor të bashkëshortëve dhe eksperiencave të grave me dhunën seksuale në martesën e tyre (shihni tabelën 35 në shtojcë). Figura 4.20 tregon se gratë të cilat kishin përjetuar abuzim emocional ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre kishte arsim 9-vjeçar (46,1%) ose arsim të mesëm (45,2%), në krahasim me gratë të cilat nuk kishin përjetuar abuzim emocional (përkatësisht 33,3% dhe 42,1%). Ndërsa gratë të cilat nuk kishin përjetuar abuzim emocional (22,1%) ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre kishte arsim universitar, krahasuar me gratë që kishin përjetuar abuzim emocional (6,6%; shihni gjithashtu tabelën 32 në shtojcë).

**Figura 4.20. Abuzimi emocional sipas nivelit të arsimimit të bashkëshortit**



\*Shënim: Përçiqndjet e krahasimit bazohen në përçiqndje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Figura 4.21. Abuzimi psikologjik sipas nivelit të arsimit të bashkëshortit



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Figura 4.21 tregon se gratë të cilat kishin përjetuar abuzim psikologjik ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre kishte arsim të mesëm (44,3%) krahasuar me gratë të cilat nuk kishin përjetuar abuzim psikologjik (40,6%). Gratë të cilat nuk kishin përjetuar abuzim psikologjik (12,5%) ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre kishte arsim universitar, krahasuar me gratë që kishin përjetuar abuzim psikologjik (8,5%; shihni gjithashtu tabelën 33 në shtojcë).


Në përfundim, figura 4.22 tregon se gratë të cilat kishin përjetuar dhunë fizike (49,5%) ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre kishte arsim 9-vjeçar, krahasuar me gratë të cilat nuk kishin përjetuar dhunë fizike (38,9%). Ndërsa gratë të cilat nuk kishin përjetuar dhunë fizike (13,9%) ishin ato që raportuan më së shumti

se bashkëshorti i tyre kishte arsim universitar, krahasuar me gratë që kishin përjetuar dhunë fizike (4,9%); shihni gjithashtu tabelën 34 në shtojcë.


#### Dhuna në familje dhe statusi i punësimit të bashkëshortit

U analizua gjithashtu dhe lidhja mes statusit të punësimit të bashkëshortit dhe katër llojeve të dhunës në familje – emocionale, psikologjike, fizike dhe seksuale – të përjetuar nga gratë. Nuk pati një lidhje statistikore të theksuar mes statusit të punësimit të bashkëshortit dhe eksperiencave të grave me abuzimin emocional, dhunën fizike ose dhunën seksuale në martesën e tyre (shihni gjithashtu tabelat 32, 33 dhe 34 në shtojcë). Megjithatë, figura 4.23 tregon që kishte një lidhje

Figura 4.22. Dhuna fizike sipas nivelit të arsimit të bashkëshortit



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Figura 4.21. Abuzimi psikologjik sipas nivelit të arsimit të bashkëshortit**

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

të theksuar mes eksperiencave të grave me abuzimin psikologjik dhe me statusin e punësimit të bashkëshortit të tyre. Në veçanti, gratë të cilat kishin përjetuar abuzim psikologjik (88,0%) ishin ato që raportuan më së shumti se bashkëshorti i tyre punonte 20 orë ose më shumë jashtë shtëpisë në muajin para intervistës, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzim psikologjik (81,0%; shihni gjithashtu tabelën 33 në shtojcë).

### Dhuna në familje nga anëtarët e saj

Dhuna në familje ndaj grave jo gjithmonë ndodh nga ish-bashkëshortët/partnerët intimë ose aktualë, shpeshherë edhe anëtarë të tjerë të familjes (p.sh. prindërit, vëllezërit, motrat, krushqit dhe të afërm të tjerë) mund të ushtrojnë dhunë fizike ndaj grave. Në vrojtim gratë u pyetën nëse

ato ishin qëlluar, goditur me shuplakë, me shkelm ose nëse ishin lënduar fizikisht që nga moshë 15 vjeçare nga anëtarë të tjerë të familjes.

Tabela 4.13 tregon që nga 2590 gra të anketuara, që prej moshës 15 vjeçare, 13,8% e grave kanë qenë të dhunuara fizikisht nga nëna/njerka e tyre, 13,4% kanë qenë të dhunuara fizikisht nga babai/njerku i tyre dhe 9,7% nga motra/vëllai. Çuditërisht, vetëm 2% e grave raportuan se ishin të dhunuara fizikisht nga vjehrra ose vjehri.

### Ndikimi i dhunës në familje te fëmijët

Fëmijët janë shpesh viktimat e harruara të dhunës në familje, megjithëse ata shpesh janë dëshmitarë të dhunës ose janë të vetëdijshëm kur ajo ndodh në shtëpi, sepse ato dëgjojnë britmat dhe debatet, shohin dëmtimet dhe shohin dëmin ndaj pronës. Për më tepër, fëmijët të cilët rriten në një mjedis të dhunshëm kanë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë ndaj tyre. Edhe nëse fëmijët nuk janë viktimat e drejtpërdrejta të dhunës në familje, ata shpesh vuajnë të njëjtat probleme psikologjike dhe të mënyrës së sjelljes, ashtu si fëmijët që dhunohen fizikisht (20,21). Fëmijët që janë të ekspozuar ndaj dhunës në familje shpesh vuajnë nga problemet fizike, sociale dhe ato të zhvillimit (p.sh. probleme të të nxënimit, aftësi sociale të kufizuara, vuajnë nga depresioni ose nga ankthi i madh dhe/ose shfaqin sjellje të dhunshme, të rrezikshme ose kriminale).

Fëmijët e të gjitha moshave, por veçanërisht ata në moshë të vogël, janë të pambrojtur nga dhuna

**Tabela 4.13. Abuzimi fizik nga anëtarë të tjerë të familjes**

	Nr.=2590	
	I dhunuar fizikisht	
Abuzuesi	nr	%
Nëna/Njerka	357	13.8
Babai/Njerku	348	13.4
Motra/Vëllai	252	9.7
Vajza/Djali	4	.2
Vjehrra	32	1.2
Vjehri	29	1.1
Të afërm të tjerë	40	1.5

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=1,828; 70,6%)



në familje dhe mund të dëmtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga dhuna në shtëpi (22,23).

Çuditërisht, nga 2590 gra të anketuara vetëm 7,9% e grave kanë mendonin se dhuna në shtëpi ka pasur ndikim te fëmijët e tyre; por 51% e grave nuk iu përgjigjen kësaj pyetjeje. Tabela 4.14 tregon se nga 2590 gra të anketuara, 7,2% raportuan se fëmijët e tyre kanë qenë dëshmitarë të dhunës, 3,9% thanë se fëmijët e tyre ishin lënduar ose dëmtuar si rezultat i dhunës dhe 3,6% thanë se fëmijët e tyre kishin jetuar në frikë për shkak të dhunës në shtëpi. Veç kësaj, 2,6% thanë se dhuna kishte shkaktuar probleme të të nxënimit te fëmijët dhe 4% thanë se fëmijët e tyre kishin braktisur shtëpinë dhe tani po jetonin me të afërm të tjerë.

**Tabela 4.14. Ndikimi i dhunës në familje te fëmijët**

	Nr.=2590	
	nr	%
Fëmijët dëshmitarë të dhunës	186	7.2
Fëmijët jetojnë në frikë	94	3.6
Fëmijët ishin lënduar ose dëmtuar	100	3.9
Fëmijët kanë braktisur shtëpinë dhe tani jetojnë me të afërm të tjerë	10	.4
Dhuna ka shkaktuar probleme të të nxënimit te fëmijët	67	2.6

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=2,386; 92,1%)

### Kërkimi i ndihmës nga gratë e dhunuara

Gratë e dhunuara shpeshherë hezitojnë të flasin për dhunën në familje. Në fakt, figura 4.23 tregon që pjesa më e madhe e grave të dhunuara nuk kërkojnë ndihmë për dhunën që ushtrohet në martesën ose lidhjen e tyre intime. Në përgjithësi, vetëm 16% deri në 28% e grave kanë kërkuar ndihmë për dhunën që ushtrohet në martesën ose në lidhjen e tyre intime. Në mënyrë më specifike, 16,8% e 776 grave të dhunuara emocionalisht kanë kërkuar ndihmë, 20% e 715 grave të dhunuara psikologjikisht kanë kërkuar ndihmë, 20% e 808 grave të dhunuara fizikisht kanë kërkuar ndihmë dhe 27,3% e 300 grave të


**Tabela 4.15. Kërkimi i ndihmës nga gratë e dhunuara**

Kush kërkoi ndihmë nga:	Nr=193	
	nr	%
Familja e tyre	176	90.7
Familja e bashkëshortit/partnerit	68	34.0
Të afërm të tjerë	27	13.9
Shokët	18	9.3
Drejtuesit fetarë	2	1.0
Mjekët/profesionistë	3	1.5
Policia	3	1.5
Avokati	6	3.1
Gjykatësi	11	5.7
Organizatrat e shërbimit social	1	.5
Të tjera	2	1.0

dhunuara seksualisht kanë kërkuar ndihmë (shihni gjithashtu tabelën 34 në shtojcë).

Është e rëndësishme të kuptohet se kur gratë

**Figura 4.23. Kërkimi i ndihmës nga gratë e dhunuara sipas llojit të dhunës në familje**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela 4.16. Arsyet e mos kërkimit të ndihmës**

Arsyet e mos kërkimit të ndihmës	Nr=190	
	nr	%
Nuk do të kishte asnjë përmirësim	49	25.8
Nuk dinë se ku mund të kërkojnë ndihmë	35	18.4
I tremben faktit se mund të njollosin emrin e familjes së tyre	35	18.4
Frika se mund të dhunohen më shumë	29	15.3
Mendon se mund të fajësohet për vetë viktimizimin e saj	19	10.0
Frika nga divorci ose përfundimi i lidhjes	19	10.0
Mendon se nuk do të merret seriozisht ose nuk do të besohet nga të tjerët ose do të tallet	15	7.9
Frika e humbjes së fëmijëve të saj	10	5.3
Dhuna është normale dhe nuk ka asnjë arsye për t'u ankuar	7	3.7

kërkojnë ndihmë për dhunën në familje, në martesën ose në lidhjen e tyre intime, pjesa më e madhe e grave i drejtohet për ndihmë familjes së tyre. Tabela 4.15 tregon se nga 193 gra të dhunuara të cilat kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje, 90,7% kanë kërkuar ndihmë nga familja e tyre, 34,0% kanë kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/partnerit të tyre dhe 13,9% kanë kërkuar ndihmë nga të afërm të tjerë.

Tabela 4.15 tregon se pak gra kanë kërkuar ndihmë jashtë familjes së tyre; vetëm 9,3% e grave të dhunuara kanë kërkuar ndihmë nga miqtë dhe akoma më pak kanë kërkuar ndihmë nga krerët fetarë, mjekët, forcat rendit publik ose të gjyqësorit ose nga organizatat e shërbimit social. Mos harroni se gratë mund të kërkojnë ndihmë nga më shumë se një burim i vetëm.

Pjesa më e madhe e grave të dhunuara nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje dhe arsyet janë të shumta. Tabela 4.16 tregon se nga 190 gra të dhunuara, 25,8% mendonin se nuk do të kishte asnjë përmirësim në sjelljen e bashkëshortit/partnerit të tyre intim nëse ato do të kërkonin ndihmë, 18,4% nuk dinin se ku mund të kërkonin ndihmë, 18,4% kishin frikë se mos turpëronin ose njolloshnin emrin e familjes së tyre dhe 15,3%

kishin frikë se mos dhunoheshin akoma më shumë.

Veç kësaj, 10% e grave të dhunuara mendonin se ato do të fajësoheshin për vetë viktimizimin e tyre dhe një 10% tjetër i grave të dhunuara fizikisht kishin gjithashtu frikë të flisnin për dhunën se kjo mund të çonte në divorc ose në përfundim të lidhjes së tyre. Në përfundim, 5,3% e grave shqetësoheshin se nëse ato do të flisnin për dhunën në familje, ato mund të humbnin fëmijët e tyre.

### Referenca

1. US Department of Justice, Office on Violence Against Women. Retrieved on March 11, 2009 from <http://www.ovv.usdoj.gov/domviolence.htm>
2. Sackett & Saunders (1999). The Impact of Different Forms of Psychological Abuse on Battered Women. *Violence and Victims*, 14(1), pp. 105-117.
3. Sackett & Saunders (1999).
4. Sackett & Saunders (1999).
5. Sackett & Saunders (1999).
6. Haarr (2007). Wife Abuse in Tajikistan. *Feminist Criminology*, Vol. 2, No. 3, pp. 245-270.
7. Abraham (2002). *Speaking the Unspeakable: Wife Abuse among South Asian Immigrants in the United States*. Rutgers, NJ: Rutgers University Press.
8. Haarr (2007).
9. Abraham (2002).
10. Bergen (2006). Martial Rape: New Research and Directions. Retrieved from [http://new.vawnet.org/category/Main\\_Doc.php?docid=248](http://new.vawnet.org/category/Main_Doc.php?docid=248)
11. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence against Women*. Geneva, Switzerland: World Health Organization.
12. Bergen (2006).
13. Garcia-Moreno et al., 2005.
14. Bergan, 2006.
15. Bennice & Resick (2003). Marital Rape: History, Research and Practice. *Trauma, Violence and Abuse*, Vol. 4, pp. 228-246.
16. Bergan, 2006.
17. Garcia-Moreno et al., 2005.

18. Myths about Alcohol and Domestic Violence. Retrieved from [http://www.stopvaw.org/Myths\\_About\\_Alcohol\\_and\\_Domestic\\_Violence.html](http://www.stopvaw.org/Myths_About_Alcohol_and_Domestic_Violence.html)
19. Myths about Alcohol and Domestic Violence.
20. Behind Closed Doors: The Impact of Domestic Violence on Children. Retrieved from [http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH\\_report.pdf](http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH_report.pdf)
21. Brown & Bzostek (2003). Violence in the Lives of Children. *Cross Currents*, Issue 1, Child Trends DataBank.
22. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children*. Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
23. Behind Closed Doors: The Impact of Domestic Violence on Children. Retrieved from [http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH\\_report.pdf](http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH_report.pdf)

## Kapitulli 5: Dhuna në familje ndaj fëmijëve

Në shtëpi dhe në ambientet familjare fëmijët përjetojnë sulme dhe akte të tjera të dhunës fizike, të abuzimit seksual, të poshtërimit dhe lloje të tjera të abuzimit emocional dhe psikologjik, si edhe neglizhim. Megjithatë, shpesh herë fëmijët janë viktimat e padukshme dhe të harruara të dhunës në familje. Në shtëpi, përgjegjësit për dhunën ndaj fëmijëve përfshijnë prindërit, njerkt, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Gjithashtu, fëmijët janë viktimat direkte dhe indirekte të dhunës në familje që ndodh në shtëpi ndërmjet anëtarëve të tjerë të familjes (1).

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje të përjetuar nga fëmijët e moshës 10 deri në 14 vjeç. Ky kapitull përfshin gjithashtu krahasime të dhunës në familje të përjetuar nga fëmijët në bazë të gjinisë, moshës dhe vendbanimit (urban kundrejt atij rural).

### Dhuna në familje ndaj fëmijëve

Nga 991 fëmijët e anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes. Tabela 5.1 tregon se 56,8% raportuan se një anëtar


i familjes i ka goditur, i ka gjuajtur me grusht ose me shkelm. Përveç kësaj, 12,8% e fëmijëve raportuan se dikush në familjen e tyre i ka goditur me objekte dhe 0,4% raportuan se ishin djegur me cigare ose një objekt tjetër të nxehtë. Vetëm katër fëmijë raportuan se ishin kërcënuar me armë ose thikë nga një anëtar i familjes.

Fëmijët që raportuan se kishin përjetuar ndonjëherë dhunë në shtëpi u pyetën nëse ata e kishin përjetuar këtë dhunë në familje gjatë 12 muajve të fundit dhe për shpeshësinë e kësaj dhune (p.sh. "Sa shpesh ju ka ndodhur kjo gjë gjatë 12 muajve të fundit?"). Tabela 5.1 tregon se 55,8% e fëmijëve raportuan se gjatë 12 muajve të fundit, një anëtar i familjes i ka goditur me shuplakë, me grusht ose me shkelm në raste të shumta (nga ndonjëherë deri në shpeshherë). Përveç kësaj, 12,4% e fëmijëve raportuan se gjatë 12 muajve të fundit një anëtar i familjes i ka goditur me objekte në raste të shumta (nga ndonjëherë deri në shpeshherë). Vetëm një fëmijë raportoi se ishte djegur me cigare ose diçka të nxehtë gjatë 12 muajve të fundit. Gjithashtu, një fëmijë raportoi se ishte kërcënuar me armë ose thikë gjatë 12 muajve të fundit.

**Tabela 5.1. Dhuna në familje e përjetuar nga fëmijët e moshës 10deri në 14 vjeç**

	Nr.=991									
	Ndonjëherë		Aktualisht		Shpeshësia gjatë 12 muajve të kaluar					
	nr	%	nr	%	Shpesh		Ndonjëherë		Aspak	
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%
<b>Dhuna fizike</b>										
Të goditur me objekte	127	12.8	123	12.4	18	1.8	105	10.6	4	.4
Të goditur me shuplakë, me grusht, me shkelm	563	56.8	553	55.8	55	5.5	498	50.3	10	1.0
Të djegur me cigare ose diçka tjetër të nxehtë	4	.4	1	.1	0	0.0	1	.1	3	.3
<b>Abuzimi psikologjik</b>										
Të kërcënuar me armë ose thikë	4	.4	1	.1	0	0.0	1	.1	3	.3

**Figura 5.1. Format e ndryshme të dhunës në familje të përjetuara nga fëmijët e moshës 10deri në 14 vjeç**



\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=21; 2,1%)

Shpesh fëmijët e rrahur përjetojnë forma të ndryshme të dhunës. Figura 5.1 tregon përqindjen e fëmijëve që kanë raportuar se kanë përjetuar një ose më shumë nga format e dhunës të përmendura në tabelën 5.1. Është e rëndësishme të theksohet se nga 991 fëmijë të anketuar, 40,2% raportuan se nuk kishin përjetuar asnjë nga format e dhunës në familje të matura në vrojtim; megjithatë, ata mund të kenë përjetuar forma të tjera të dhunës fizike që nuk janë matur në vrojtim. Për shembull, vrojtimi nuk matë abuzimin emocional dhe përfshiu vetëm një formë të abuzimit psikologjik, kështu që fëmijët mund të kenë përjetuar forma të abuzimit emocional ose psikologjik që nuk janë matur në këtë vrojtim.


Figura 5.1 tregon se nga 991 fëmijë të anketuar, 45,8% raportuan se kishin përjetuar një formë dhune të tabelës 5.1, 11,5% kishin përjetuar dy forma dhune dhe 0,4% e fëmijëve kishin përjetuar tre ose katër forma dhune. Efektet afatgjata të

dhunës në familje në format e saj të ndryshme janë të rënda për fëmijët e abuzuar (shihni gjithashtu tabelën 37 në shtojcë).

Për të kuptuar ndryshimet demografike në eksperiencat e fëmijëve me dhunën në familje, të dhënat u përdorën për të përcaktuar nëse një fëmijë ka përjetuar ndonjëherë një ose më shumë nga format e ndryshme të dhunës të listuara në tabelën 5.1. Pas kësaj, janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore demografike të theksuara, të cilat mund të na ndihmonin për të kuptuar abuzimin e fëmijëve në shtëpi (shihni gjithashtu tabelën 38 në shtojcë).

Figura 5.2 tregon se megjithëse një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve – djem dhe vajza – kanë përjetuar dhunë fizike në shtëpi, nga 970 fëmijë të anketuar, djemtë (66,7%) në mënyrë në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa

**Figura 5.2. Dhuna fizike sipas gjinisë së fëmijës**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

sesa vajzat (51,1%) që të përjetonin dhunë fizike në përgjithësi. Në mënyrë më specifike, djemtë (66,1%) kishin më shumë gjasa sesa vajzat (49,9%) që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes. Megjithatë, nuk kishte ndryshim të theksuar ndërmjet djemve dhe vajzave për sa i përket të qenit të goditur me objekte të ndryshme nga anëtarët e familjes.

të goditur me objekte të ndryshme nga anëtarët e familjes (shihni gjithashtu tabelën 39 në shtojcë).

Gjithashtu, kishte ndryshime të theksuara midis zonave urbane dhe rurale për sa i përket eksperiencës së fëmijëve me dhunën fizike në shtëpi. Figura 5.4 tregon se nga 970 fëmijë të anketuar, fëmijët që jetonin në zonat rurale (67,5%) në mënyrë të theksuar kishin më shumë

**Figura 5.3. Dhuna fizike sipas moshës së fëmijës**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Figura 5.3 tregon gjithashtu disa ndryshime të theksuara midis kategorive të moshave për sa i përket eksperiencës së fëmijëve me dhunën fizike në shtëpi. Nga 970 fëmijë të anketuar, në mënyrë të theksuar fëmijët e moshës 10 dhe 11 vjeç (66,0%) kishin më shumë gjasa që të përjetonin dhunë fizike krahasuar me fëmijët e moshës 13 dhe 14 vjeç (përkatesisht 55,5% dhe 51,5%). Në mënyrë më specifike, 10 dhe 11 vjeçarët kishin më shumë gjasa që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes krahasuar me 12, 13 dhe 14 vjeçarët. Nuk kishte ndryshime të theksuara bazuar te mosha për sa i përket të qenit

gjasa që të dhunoheshin fizikisht nga një anëtar i familjes krahasuar me fëmijët që jetonin në zonat urbane (51,2%). Në mënyrë më specifike, fëmijët në zonat rurale (66,4%) kishin më shumë gjasa që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes krahasuar me fëmijët në zonat urbane (50,4%). Përveç kësaj, fëmijët në zonat rurale (16,4%) në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa sesa fëmijët në zonat urbane (10,1%) që të goditeshin me objekte të ndryshme nga anëtarët e familjes (shihni gjithashtu tabelën 40 në shtojcë).

**Figura 5.4. Dhuna fizike sipas vendbanimit urban kundrejt atij rural**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

### Cilët anëtarë të familjes abuzojnë me fëmijët?

Shpesh fëmijët abuzohen fizikisht nga prindërit e tyre, megjithatë, motrat dhe vëllezërit, gjyshërit, dhe të afërm të tjerë mund të jenë gjithashtu abuzues, veçanërisht kur familjet jetojnë në të njëjtën shtëpi me dy dhe tre breza. Tabela 5.2 tregon se nga 991 fëmijë të anketuar, 45,1% e fëmijëve raportuan se nëna/ njerka i lëndonte ata fizikisht, 29,3% raportuan se babai/njerku abuzonte mbi ta fizikisht dhe 24,4% raportuan se motra dhe/ose vëllai i tyre abuzonte fizikisht me ta. Një pjesë më e vogël e fëmijëve raportuan se gjyshërit e tyre (3,6%), të afërmit (2,7%) ose anëtarët e tjerë të familjes (1,4%) abuzonin fizikisht me ta. Meqenëse nënat/njerkat shpenzojnë më shumë kohë të angazhuara me rritjen e fëmijëve, nuk është për t'u çuditur që nënat/njerkat identifikoheshin më shpesh nga fëmijët si personat që i lëndonin ata fizikisht.

Është e rëndësishme të theksohet se 61,4% e fëmijëve që raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga babai/njerku ishin të dhunuar gjithashtu edhe nga nëna/njerka dhe 24,5% ishin gjithashtu të dhunuar nga motra dhe/ose vëllai. Në krahasim, 39,8% e fëmijëve që ishin dhunuar nga nëna/njerka ishin gjithashtu të dhunuar fizikisht edhe nga babai/njerku dhe 31,5% ishin të dhunuar nga motra/vëllai i tyre. Kjo është e rëndësishme, sepse tregon që shpesh fëmijët dhunohen nga më shumë se një anëtar i familjes së tyre nukleare.


**Tabela 5.2. Dhunimi fizik sipas anëtarëve të familjes**

	Nr=991	
	I dhunuar fizikisht	
Abuzuesi	nr	%
Babai/njerku	290	29,3
Nëna/njerka	447	45,1
Motra/vëllai	242	24,4
Gjyshi/gjyshja	36	3,6
Familja e afërt	27	2,7
Të afërm të tjerë	14	1,4

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=357; 36,0%)

Kishte disa ndryshime të theksuara ndërmjet djemve dhe vajzave për sa i përket faktit se kush i abuzon ato në shtëpi. Figura 5.5 tregon se nga 634 fëmijë të anketuar, në mënyrë të theksuar djemtë (52,0%) kishin më shumë gjasa sesa vajzat (38,2%) që të dhunoheshin fizikisht nga babai/njerku i tyre, kurse vajzat (42,2%) në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa sesa djemtë (34,7%) që të dhunoheshin fizikisht nga motra dhe/ose vëllai. Është e rëndësishme të theksohet se nuk kishte ndryshime të theksuara ndërmjet djemve dhe vajzave për sa i përket abuzimit fizik nga nëna/njerka, gjyshërit, farefisi i afërt, ose të afërm të tjerë (shihni gjithashtu tabelën 41 në shtojcë).

**Figura 5.5. Kategoria e abuzuesit sipas gjinisë së fëmijës**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

## Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e abuzuar

Në mënyrë tipike fëmijët kanë pak status brenda familjeve dhe shpeshherë zërat e tyre nuk dëgjoen. Përveç kësaj, në familje, dhuna fizike ose ndëshkimi trupor përdoret shpesh për të kontrolluar dhe për të disiplinuar fëmijët; kështu që goditja me shuplakë, të gjuajturit dhe rrahja e fëmijës zakonisht nuk konsiderohet një formë dhune ndaj fëmijëve. Në këtë mënyrë, fëmijët e dhunuar shpesh hezitojnë të flasin për dhunën në familje.

Figura 5.6 tregon se nga 634 fëmijë të dhunuar, 53,3% e fëmijëve të dhunuar fizikisht raportuan se kishin kërkuar ndihmë nga dikush në përpjekje për ta ndaluar abuzuesin e tyre që të mos abuzonte përsëri. Në mënyrë më specifike, 64,6% e fëmijëve që ishin goditur me objekte të ndryshme dhe 53,5% e fëmijëve që ishin goditur me shuplakë, me grusht ose me shkelm kanë kërkuar ndihmë nga dikush. Veç kësaj, 25,0% e fëmijëve që ishin djegur me cigare dhe sende të tjera të nxehta ose që ishin kanosur me armë, rrallë herë kanë kërkuar ndihmë (shihni gjithashtu tabelën 42 në shtojcë).

Është e rëndësishme të kuptohet se megjithëse një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve kanë kërkuar ndihmë nga dikush për dhunën që ato po përjetonin në familje, shumica e fëmijëve e kanë kërkuar ndihmën nga një anëtar i familjes. Rrallëherë një fëmijë i ka treguar dikujt jashtë familjes së tyre rreth abuzimit ose dhunës. Tabela 5.3 tregon se nga 340 fëmijë të dhunuar fizikisht, 86,2% kanë kërkuar ndihmë nga prindërit e tyre.

**Tabela 5.3. Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e abuzuar**


	Nr=340	
	nr	%
Prindi (prindërit)	263	86,2
Gjyshërit	119	39,0
Shokët	5	1,6
Mësuesit	10	3,3
Familja e afërt	17	5,6
Drejtuesit fetarë	1	0,3
Mjeku/personeli mjekësor	0	0,0
Policia	0	0,0

Në rastin kur një nga prindërit e tyre i dhunonte fizikisht, zakonisht ata kërkonin ndihmë nga prindi tjetër. Në rastin kur dikush tjetër përveç prindërve i dhunonte ata, ata mund të kenë kërkuar ndihmë nga të dy prindërit. Përveç kësaj, 39,0% e fëmijëve të dhunuar kanë kërkuar ndihmë nga gjyshërit e tyre. Përtej prindërve dhe gjyshërve, fëmijët kishin tendencën të mos kërkonin ndihmë nga të tjerë.

Janë kryer edhe ndarjet në tabela me disa variabla për të përcaktuar nëse ka pasur ndryshime statistikore demografike të theksuara, të cilat mund të na ndihmonin për të kuptuar sjelljet e fëmijëve për kërkimin e ndihmës.

Figura 5.7 tregon gjithashtu se nga 634 fëmijë të anketuar, në mënyrë të theksuar vajzat (59,5%) kishin më shumë gjasa sesa djemtë (48,6%) që të

**Figura 5.6. Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e abuzuar sipas llojit të dhunës**




\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.



kërkimin ndihmë për dhunën në familje në jetën e tyre. Nuk kishte ndryshime të theksuara në kërkimin e ndihmës bazuar në moshën e fëmijës (shihni gjithashtu tabelën 43 në shtojcë).


**Figura 5.7. Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e dhunuar sipas gjinisë**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Figura 5.8 tregon se nga 634 fëmijë të anketuar, fëmijët e dhunuar fizikisht në zonat rurale (58,5%) në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa që të kërkonin ndihmë nga familja për dhunën në familje në jetën e tyre, krahasuar me fëmijët në zonat urbane (47,1%; shihni gjithashtu tabelën 43 në shtojcë).

**Figura 5.8. Kërkimi i ndihmës nga fëmijët e dhunuar sipas vendbanimit urban kundrejt atij rural**



\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

## Vetëdija e fëmijës për dhunën në familje ndaj nënës së tij/saj

Vetëm 17,4% e 991 fëmijëve të anketuar raportuan të kishin parë ose dëgjuar ndonjëherë dhunë ndërmjet prindërve të tyre. Problemi mund të qëndrojë në lidhje me përdorimin e termit “dhunë”. Fëmijët mund të mos e konsiderojnë goditjen e nënës nga babai si dhunë, por si disiplinë. Nuk kishte ndryshime të theksuara midis djemve dhe vajzave, zonave urbane kundrejt atyre rurale ose midis kategorive të moshave për sa i përket faktit nëse fëmijët ishin të pranishëm në skena dhune midis prindërve të tyre.

Prej atyre 146 fëmijëve që kishin qenë të pranishëm në akte të tilla dhune në familje vetëm 23,6% i kanë thënë dikujt për këtë dhunë.

## References

1. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children*. Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.

## Kapitulli 6: Përfundime dhe diskutime

Kërkimet në mbarë botën kanë zbuluar se dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës që përjetohet nga gratë dhe fëmijët në shumicën e vendeve në të gjithë botën (1,2). Në mënyrë të ngjashme, ky vrojtım konfirmon se dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve është një problem mjaft i përhapur në familjet dhe komunitetet në të gjithë Shqipërinë. Për më tepër, ky vrojtım ilustron se gratë dhe fëmijët e dhunuar vuajnë dëmtime fizike dhe probleme serioze të shëndetit që lidhen me dhunën, dhe shpesh dëmtimet pengojnë aftësinë e grave për të punuar. Këto rezultate tregojnë se dhuna në familje ka efekte negative mbi shëndetin fizik dhe mirëqenien e grave dhe të fëmijëve të dhunuar, si dhe mbi shëndetin dhe mirëqenien e familjeve dhe komuniteteve në përgjithësi. Në prizmin e këtyre rezultateve, parandalimi i dhunës në familje duhet të renditet në nivelet e larta të axhendës kombëtare të shëndetit publik të Qeverisë së Shqipërisë.

### Dhuna në familje ndaj grave

Nga 2590 gra të anketuara, 50,6% e grave të anketuara vetëraportuan përjetimin e abuzimit emocional në martesën ose lidhjen e tyre, 39,1% kanë përjetuar abuzim psikologjik, 31,2% kanë përjetuar dhunë fizike dhe 12,7% kanë përjetuar dhunë seksuale. Në varësi të llojit të dhunës në familje të përjetuar nga gratë kishte disa ndryshime të theksuara bazuar në nivelin arsimor, statusin e punësimit, grupmoshën dhe në gjendjen civile të grave. Gjithashtu, kishte ndryshime të theksuara bazuar në ndarjen midis zonave urbane dhe rurale dhe ndërmjet rretheve.

Këto rezultate tregojnë se gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një lloj dhune – emocionale, psikologjike, fizike ose seksuale – në martesën ose në lidhjen e tyre intime, por shpesh përjetojnë njëkohësisht lloje të ndryshme të dhunës. Për shembull, 60,6% e grave të abuzuara

emocionalisht raportuan gjithashtu se ishin abuzuar edhe psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri intim, 44,9% ishin gjithashtu të dhunuara edhe fizikisht dhe 15,0% ishin të abuzuara edhe seksualisht. Gratë e dhunuara ishin në rrezik edhe më të madh nga format e tjera të abuzimit. Në mënyrë specifike, 95,5% e grave të dhunuara fizikisht raportuan gjithashtu se ishin abuzuar edhe emocionalisht nga bashkëshorti/partneri intim, 82,4% raportuan se ishin të abuzuara psikologjikisht dhe 35,8% ishin të dhunuara seksualisht nga bashkëshorti/partneri intim.

Shumica e grave që kishin përjetuar dhunë në familje raportuan se dhuna ka filluar brenda vitit të parë të martesës ose të bashkëjetesës me partnerin e tyre intim. Një pjesë tjetër prej 1/3 e grave raportuan se dhuna fizike ka filluar në vitin e 2-të ose të 3-të të martesës ose të bashkëjetesës me partnerin intim. Në këtë mënyrë, 82% deri në 88% e grave raportuan se dhuna në familje – emocionale, psikologjike, fizike dhe seksuale – ka filluar brenda tre viteve të para të martesës ose të bashkëjetesës me partnerin. Kështu që shumë prej grave kanë jetuar me dhunë në martesën dhe në familjen e tyre për 10 deri në 30 vjet.

Gratë e dhunuara shpesh përjetojnë dëmtime fizike nga dhuna fizike dhe seksuale. Këto rezultate tregojnë se gratë të cilat ishin dhunuar fizikisht dhe seksualisht nga bashkëshorti/partneri intim, vuajnë dëmtime të rënda të shkallëve të ndryshme. Në mënyrë specifike, 48,3% e grave të dhunuara raportuan se ato ishin dëmtuar me prerje, mavijosje, dhe/ose dhimbje; 18,1% kanë përjetuar dëmtime në sy, djegie dhe/ose nxjerrje gjymtyrës; 5,4% kanë përjetuar humbje ndjenjash dhe 1% ka përjetuar plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer dhe/ose dëmtime serioze. Shumica e grave që kanë vuajtur dëmtime që lidhen me dhunën në familje ishin të paafta për punë për një periudhë nga një deri në 15 ditë për shkak të dëmtimeve të tyre.

Këto rezultate tregojnë qartësisht se dhuna në familje ndaj grave është e lidhur në mënyrë të theksuar me një gamë dëmtimesh fizike. Përveç kësaj, kërkimi në mbarë botën ka treguar që dhuna në familje nuk është vetëm një faktor domethënës rreziku nëpërmjet impaktit të saj direkt mbi shëndetin fizik, riprodhues dhe mendor të grave, por gjithashtu kontribuon në barrën e përgjithshme të sëmundjeve dhe infeksioneve afatgjata.

Këto rezultate kanë implikime serioze për sektorin mjekësor të kujdesit shëndetësor, duke qenë se shumë punonjës mjekësor të kujdesit shëndetësor shohin dhe trajtojnë gra që jetojnë në marrëdhënie të dhunshme dhe fëmijë që jetojnë në familje të dhunshme, me dijeni ose pa dijeni. Në shume raste, stafi mjekësor mund të jetë pika e parë e kontaktit për të mbijetuarit e dhunës në familje.

Këto rezultate tregojnë gjithashtu se gratë që raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre intim përdorte ose abuzonte me alkoolin, në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje – emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale – krahasuar me gratë bashkëshorti/partneri intim i të cilave nuk konsumonte alkool. Në mënyrë specifike, gratë bashkëshorti/partneri intim i të cilave pinte alkool kishin rreth dy deri në tre herë më shumë gjasa që të përjetonin dhunë fizike dhe seksuale në martesën ose lidhjen e tyre intime.

Gratë e dhunuara që raportuan se bashkëshorti i tyre përdorte/abuzonte me alkoolin kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa që të përjetonin dëmtime që lidhen me dhunën në familje. Është e rëndësishme të mbahet mend se alkooli është në një farë mase faktor kontribuues në dhunën në familje, por nuk është shkaku i dhunës në familje.

Është e rëndësishme të mbahet mend se dhuna në familje ndaj grave nuk ndodh gjithmonë nga bashkëshortët/partnerët aktualë ose të mëparshëm, dhe këto rezultate tregojnë se anëtarë të tjerë të familjes (p.sh. prindërit, vëllezërit, motrat, krushqit dhe të afërm të tjerë) gjithashtu kryejnë akte të dhunës fizike ndaj grave.

Gratë e dhunuara shpeshherë hezitojnë të flasin për dhunën në familje. Në fakt, këto rezultate tregojnë se vetëm 16% deri në 28% të grave kanë

kërkuar ndihmë për dhunën në martesën ose në lidhjen e tyre intime. Nga ato gra të cilat kanë kërkuar ndihmë, gati 91% e grave kanë kërkuar ndihmë nga familja e tyre ose të afërm të tjerë dhe shumë pak gra kanë dalë jashtë familjes për ndihmë për dhunën në jetët e tyre.

Arsyet përse një grua e dhunuar nuk kërkon ndihmë dhe mbështetje nga shërbimet e mbështetjes së viktimave ose nga nëpunësit ligjorë janë të shumta, duke përfshirë: mungesën e shërbimeve të ofruara ndaj viktimave femra të dhunës në familje, në veçanti në zonat rurale; familja dhe miqtë i këshillojnë shumë gra se ato nuk duhet të kërkojnë ndihmë nga agjencitë qeveritare ose shërbimet e komunitetit; shumë gra ia vënë fajin vetes për viktimizimin e tyre; dhe shumë gra kanë frikë se nëse flasin ose kërkojnë ndihmë ato do të fajësohen për viktimizimin e tyre. Kjo thekson nevojën për shërbime mbështetëse lehtësisht të arritshme, ku gratë mund të flasin të sigurt për eksperiencat e tyre me dhunën dhe të marrin shërbime dhe asistencë cilësore. Ofrimi i shërbimeve cilësore për viktimat e dhunës në familje është thelbësorë në pakësimin e impaktit të dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve.

### **Dhuna në familje dhe niveli arsimor**

Gratë e të gjitha niveleve arsimore kishin përjetuar dhunë në familje; megjithatë, eksperiencat e grave me dhunën në familje ndryshonin sipas nivelit arsimor. Në veçanti, gratë me arsim universitar kishin në mënyrë të theksuar shumë më pak gjasa se gratë me arsim të mesëm, arsim 9-vjeçar, arsim fillor ose pa arsim, që të përjetonin abuzim emocional, abuzim psikologjik dhe dhunë fizike nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Interesant është fakti se nuk kishte ndryshime të theksuara bazuar në nivelin arsimor të grave për sa i përket përvojave të grave me dhunën seksuale – gratë pa arsim ose me pak arsim kishin po aq gjasa që të përjetonin dhunë seksuale në martesën e tyre ose në lidhjen intime sa edhe gratë me arsim të mesëm ose universitar.

Meshkujt e të gjitha niveleve arsimore kryejnë akte të dhunës në familje ndaj bashkëshorteve dhe/ose partnereve të tyre intime. Analiza tregon se gratë që kanë përjetuar abuzim emocional në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa që të raportonin

se bashkëshorti i tyre kishte arsim 9-vjeçar ose të mesëm. Përveç kësaj, gratë të cilat kishin përjetuar abuzim psikologjik dhe/ose dhunë fizike në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa që të raportonin se bashkëshorti i tyre kishte arsim të mesëm. Megjithatë, gratë të cilat nuk kishin përjetuar abuzim emocional, psikologjik ose dhunë fizike, ishin ato që raportuan se bashkëshorti i tyre kishte arsim universitar. Nuk kishte lidhje të theksuar midis nivelit arsimor të bashkëshortit dhe eksperiencës së grave me dhunën seksuale në martesën e tyre.

### **Dhuna në familje dhe statusi i punësimit**

Nuk kishte ndryshime të theksuara në eksperiencat e grave me abuzimin psikologjik, dhunën fizike dhe/ose dhunën seksuale bazuar në statusin e punësimit të grave. Me fjalë të tjera, gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë për të paktën 20 orë në javë në kohën e vrojtimit, kishin po aq gjasa që të përjetonin abuzim psikologjik, dhunë fizike dhe dhunë seksuale në martesën ose në lidhjen e tyre intime sa edhe gratë të cilat nuk punonin jashtë shtëpisë.

Ndryshimi i vetëm që u shfaq në bazë të statusit të punësimit lidhej me dukurinë e abuzimit emocional. Gratë që nuk punonin jashtë shtëpisë kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa që të përjetonin ndonjëherë abuzim emocional krahasuar me gratë që punonin jashtë shtëpisë për të paktën 20 orë në javë në kohën e vrojtimit.

Gjithashtu u ekzaminua lidhja midis statusit të punësimit të bashkëshortit dhe katër llojeve të dhunës në familje të përjetuara nga gratë. Nuk kishte lidhje statistikore të theksuara midis statusit të punësimit të bashkëshortit dhe eksperiencës së grave me abuzimin emocional, dhunën fizike ose dhunën seksuale në martesën e tyre. Megjithatë, gratë që kishin përjetuar abuzim psikologjik ishin ato që raportuan në mënyrë të theksuar se bashkëshorti i tyre punonte jashtë shtëpisë për 20 orë në kohën e vrojtimit.

### **Dhuna në familje dhe moshë**

Gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç u grupuan në nëntë grupime të ndryshme moshash (shihni

kapitullin 3). Gratë në secilën grupmoshë kishin përjetuar dhunë në familje dhe nuk kishte ndryshime të theksuara midis grupmoshës për sa i përket eksperiencës së grave me abuzimin emocional ose psikologjik. Megjithatë, kishte ndryshime të theksuara midis grupmoshave për sa i përket eksperiencës së grave me dhunën fizike dhe seksuale. Në veçanti, gratë në moshën 26 vjeçare e sipër në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin dhunuar fizikisht dhe/ose seksualisht nga bashkëshorti/partneri intim, krahasuar me gratë e grupmoshave 15 deri në 17 vjeç, 18 deri në 21 vjeç dhe 22 deri në 25 vjeç.

Ky ndryshim mund të shpjegohet pjesërisht nga fakti se gratë 26 vjeç e sipër në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa që të ishin të martuara ose të bashkëjetonin me një partner intim krahasuar me gratë nën moshën 26 vjeç, dhe është brenda kontekstit të martesës dhe lidhjes intime që duket se ndodh një nivel i lartë i dhunës fizike dhe seksuale në jetën e grave.

### **Dhuna në familje dhe gjendja civile**

Dhuna në familje ndodh në kontekstin e martesës dhe lidhjeve intime. Prandaj u analizua, lidhja midis gjendjes civile – e martuar ose bashkëjeton me dikë kundrejt e divorcuar ose e ndarë – dhe eksperiencës së grave me dhunën në familje. Kishte pak ndryshime të theksuara në eksperiencën e grave me abuzimin emocional bazuar në gjendjen civile; megjithatë, gratë e divorcuara ose të ndara kishin në mënyrë të theksuar më pak gjasa sesa gratë e martuara të raportonin se ato përjetonin "aktualisht" abuzim emocional (brenda 12 muajve të fundit para intervistës). Në fakt, 60% deri në 67% e grave të divorcuara ose të ndara, raportuan se aktualisht ato përjetonin një nga format e abuzimit emocional, krahasuar me 85% deri në 96% të grave të martuara ose të atyre që jetonin me një partner intim.

Kishte ndryshime të theksuara bazuar në gjendjen civile për sa i përket eksperiencës së grave me abuzimin psikologjik, dhunën fizike dhe dhunën seksuale në martesën ose lidhjen e tyre intime. Gratë që ishin të divorcuara ose të ndara kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa që të kishin përjetuar ndonjëherë abuzim psikologjik, dhunë fizike dhe dhunë seksuale në martesën e

tyre, krahasuar me gratë që aktualisht ishin të martuara ose që jetonin me dikë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se gratë që aktualisht ishin të martuara ose që jetonin me dikë, ishin në mënyrë të theksuar ato që raportuan më së shumti se përjetonin "aktualisht" dhunë fizike dhe/ose seksuale, krahasuar me gratë e divorcuara ose të ndara. Megjithatë, 44% deri në 68% të grave të divorcuara ose të ndara raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike brenda 12 muajve të fundit para intervistës.

### Dhuna në familje dhe vendbanimi

Kishte disa ndryshime të theksuara ndërmjet grave që banonin në zonat rurale dhe urbane dhe të eksperiencave të tyre me dhunën në familje. Edhe pse një pjese e konsiderueshme e grave në të dyja zonat si urbane, ashtu dhe rurale përjetojnë abuzim emocional dhe dhunë fizike, gratë nga zonat rurale kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa që të përjetonin abuzim emocional dhe dhunë fizike nga bashkëshorti/partneri intim, krahasuar me gratë në zonat urbane.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se nuk kishte ndryshime të theksuara midis zonave urbane dhe rurale për sa i përket eksperiencave të grave me abuzimin psikologjik dhe dhunën seksuale nga bashkëshorti/partneri intim.

### Dhuna në familje ndaj fëmijëve

Nga 991 fëmijë të anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes dhe disa fëmijë kishin përjetuar njëkohësisht forma të ndryshme të dhunës fizike. Kishte disa ndryshime të theksuara në eksperiencat me dhunën në familje bazuar në gjininë (djemtë kundrejt vajzave) dhe moshën. Gjithashtu, kishte ndryshime të theksuara bazuar në ndarjen midis zonave urbane dhe rurale.

Fëmijët shpesh dhunohen fizikisht nga prindërit e tyre, megjithatë, motrat dhe vëllezërit, gjyshërit dhe të afërm të tjerë mund të jenë gjithashtu dhunues. Këto rezultate tregojnë se 45,1% e fëmijëve raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga nëna/njerka e tyre, 29,3% ishin dhunuar nga babai/njerku i tyre dhe 24,4% ishin dhunuar nga

motra dhe/ose vëllai i tyre. Është e rëndësishme të theksohet se djemtë në mënyrë të theksuar kishin më shumë gjasa se sa vajzat që të dhunoheshin fizikisht nga babai/njerku; ndërsa vajzat kishin në mënyrë të theksuar më shumë gjasa sesa djemtë që të dhunoheshin fizikisht nga vëllai dhe/ose motra e tyre. Djemtë dhe vajzat kishin të njëjtat gjasa që të dhunoheshin fizikisht nga nëna/njerka e tyre.

Meqë në mënyrë tipike fëmijët kanë status të vogël brenda familjeve dhe dhuna fizike shpesh përdoret si një mjet disiplinimi për fëmijët, ata hezitojnë të flasin rreth dhunës në familje. Edhe pse një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve kishin kërkuar ndihmë nga dikush për dhunën që ata përjetonin në familje, shumica e fëmijëve kërkonin ndihmë nga një anëtar i familjes. Rrallëherë një fëmijë i ka treguar dikujt jashtë familjes së tyre rreth abuzimit ose dhunës. Gjithashtu kishte ndryshime të theksuara ndërmjet djemve dhe vajzave dhe fëmijëve në zonat urbane dhe rurale dhe sjelljes në kërkimin e ndihmës. Së fundmi, vetëm 17,4% e fëmijëve raportuan se ishin të vetëdijshëm për dhunën në familje ndërmjet prindërve të tyre.

### Teoritë mbi dhunën në familje

Gjatë 50 viteve të fundit, janë paraqitur nga studiues perëndimorë një shumëllojshmëri teorish për të shpjeguar dhunën në familje. Për ato që me punën e tyre trajtojnë dhunën në familje dhe zhvillojnë masa dhe politika efektive parandaluese, mbrojtëse dhe ligjore, është e rëndësishme të kuptojnë perspektivat e ndryshme teorike, dhe se jo të gjitha teoritë janë mbështetur nga kërkuesit.

Në nivelin individual të analizës, disa studiues vlerësojnë se dhuna në familje është e lidhur me çrregullime të personalitetit ose me shëndetin mendor të grave të dhunuara (3,4,5,6,7). Megjithatë, rezultatet e kërkimeve nuk mbështesin në mënyrë konsekuente praninë e çrregullimeve të personalitetit ose të sëmundjeve mendore midis grave të dhunuara ose burrave që dhunojnë. Përkundrazi, kërkuesit thonë se në fakt është problematike t'i referohesh sjelljes së grave të dhunuara si pasje të një çrregullimi mendor ose të personalitetit, sepse personaliteti i një gruaje të dhunuar mund të jetë rezultati i viktimizimit

sistematik në martesë ose në lidhjen intime (8,9). Në realitet, vetëm një pjesë e vogël e të gjitha rasteve të dhunës në familje përfshin njerëz me çrregullime psikologjike ose sëmundje mendore (10, 11). Kërkimet kanë treguar se shumica e rasteve të dhunës në familjes nuk mund të shpjegohet me këto teori të nivelit individual. Ka vetëm pak mbështetje ndaj propozimit se çrregullimet e personalitetit ose që sëmundja mendore është përgjegjëse për shkakimin e dhunës në familje (12).

Në nivelin strukturor të analizës, janë përdorur dy teori të ndryshme – teoria e dhunës në familje dhe teoria feministe – për të shpjeguar dhunën në familje. Këto teori pohojnë se dhuna në familje është sjellje e mësuar nëpërmjet vrojtimit dhe përforcimit si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Dhuna në familje përsëritet, sepse ajo funksionon – dhuna në familje lejon që dhunuesi të fitojë kontroll mbi viktimën nëpërmjet frikës dhe imponimit. Përveç kësaj, dhunuesi është i aftë ta përforcojë sjelljen e tij abuzive për shkak të besimeve të sanksionuara në nivel shoqëror që thonë se burrat kanë të drejtë të kontrollojnë gratë në familje dhe në lidhjet intime, si dhe të përdorin dhunën për "kauza të drejta" për të kontrolluar dhe disiplinuar bashkëshorten/partneren intime dhe/ose fëmijët.

Teoria e dhunës në familje i konsideron sulmet fizike nga një anëtar i familje mbi një anëtar tjetër si një përgjigje taktike ndaj konflikteve që janë të pandara në jetën familjare (13,14). Ndërkohë që pushteti mund të zotërohet njëlloj nga bashkëshorti dhe bashkëshortja, abuzimi me bashkëshorten ndodh më shpesh në familjet në të cilat bashkëshorti ka më shumë pushtet se sa bashkëshortja dhe/ose bashkëshortja konsiderohet prona ose është nën kontroll të bashkëshortit të saj (15). Përveç kësaj, shpeshherë dhuna ndaj fëmijëve ushtrohet nga prindërit, motrat ose vëllezërit e mëdhenj, dhe të afërm të tjerë më të mëdhenj që kanë pushtet dhe kontroll mbi fëmijët më të vegjël.

Sipas teorisë së dhunës në familje, familja shihet si një arenë ku sjellja e dhunshme mësohet dhe transmetohet nëpër breza, raste në të cilat ka cikle dhune brenda familjeve. Kërkuesit debatojnë mbi shkallën e mbështetjes empirike që në fakt ekziston për teorinë e dhunës familjare (16).

Ndërkohë që një numër studimesh kanë zbuluar se dhunuesit janë abuzuar kur kanë qenë fëmijë ose kanë qenë të pranishëm në dhunimin e nënave nga baballarët e tyre, studime të tjera nuk kanë gjetur ndonjë lidhje domethënëse ndërmjet eksperiencave të fëmijërisë me dhunën familjare dhe ushtrimin të dhunës në familje si një i rritur (17,18). Mungesa e konsistencës në zbulime mund të jetë për shkak të mos konsiderimit nga teoria e dhunës në familje e çekuilibrit të pushtetit ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes dhe prindërve dhe fëmijës (19).

Një tjetër teori është se gratë e dhunuara vuajnë nga një "pamundësi vepruese të mësuar" si rezultat i dhunimeve të përsëritura, të cilat i parandalojnë ato t'i rezistojnë dhunës ose t'i largohen lidhjes. Kjo teori nuk trajton arsyet ekonomike, shoqërore dhe familjare që shtojnë stresin në marrëdhëniet e familjes dhe ndikojnë në mundësinë e grave për t'u larguar nga martesat/lidhjet intime të dhunshme. Për shembull, kjo teori nuk trajton besimet zakonore dhe fetare që një grua në emër të ruajtjes së familjes dhe të mbrojtjes së emrit të familjes duhet të qëndrojë në martesë dhe të durojë dhunën në familje pavarësisht rrethanave. Për viktimat e dhunës në familje, ky nocion i ruajtjes dhe i përgjegjësisë së familjes pengon me ndjekjen penale dhe ndërhyrjen efektive në rastet e dhunës në familje.

Teoria e pamundësisë vepruese të mësuar nuk trajton gjithashtu çështjen e përpalljes me strehimit, i cili shpeshherë është i kufizuar. Në fakt, shumë gra të dhunuara nuk kërkojnë asistencë ligjore kundër bashkëshortit/partnerit të tyre intim abuzues, sepse ato nuk kanë mundësi për një strehim alternativ. Mungesa e strehimit të përballeshëm dhe alternativ ndikon mbi gratë e dhunuara, të cilat mund të dëshirojnë të largohen nga abuzimi dhe dhuna në martesën/lidhjen intime, por nuk kanë alternativa të arsyeshme duke marrë parasysh mungesën e burimeve ekonomike.

Kërkuesit debatojnë mbi argumentin mbështetës së teorisë së pamundësisë vepruese të mësuar, sepse shumë gra të dhunuara në fakt i bëjnë rezistencë abuzimit dhe dhunës në martesën/lidhjen e tyre intime në disa mënyra të ndryshme, dhe angazhohen në një sërë strategjish për mbijetesë dhe përbalim (duke përfshirë largimin

e përhershëm ose të përkohshëm nga një lidhje e dhunshme).

Në fund, teoritë feministe e konsiderojnë dominimin mashkullor si një element kyç në dhunën në familje ndaj grave (20,21). Varësia e grave ndaj autoritetit mashkullor besohet të jetë institucionalizuar në strukturën e shoqërive patriarkale, e cila konsiston në një strukturë shoqërore që i jep grave një status inferior, dhe një kulturë që shërben për të përfunduar pranimin e këtij rregulli (22,23). Ky vlerësim është mbështetur nga kërkues nëpër kultura dhe shoqëri të cilat kanë shfaqur lidhje të ndërsjellët ndërmjet strukturave shoqërore patriarkale dhe shifrave të dhunës ndaj grave. Veçanërisht, besimet patriarkale të bashkëshortëve u zbuluan se ishin të lidhur me rrahjen e grave (24,25,26). Studimet ndër-kulturore sugjerojnë se abuzimi i bashkëshortëve është një praktikë e zakonshme në shoqëritë patriarkale ku vlerat kulturore, duke përfshirë normat dhe besimet shoqërore dhe fetare diktojnë dominimin mashkullor në marrëdhëniet gjinore, falin dhunën ndaj grave dhe krijojnë kode të ndryshme sjellje për burrat dhe gratë (27,28,29,30). Në krahasim, pushteti ekonomik dhe autoriteti në familje i grave është parë se lidhet në mënyrë të ndërsjellët me nivele të ulëta të dhunës ndaj bashkëshortëve (31,32,33).

Teoritë feministe gjithashtu konsiderojnë stereotipat rreth roleve dhe përgjegjësi "të duhura" të burrave dhe grave në familje të cilët përforcojnë besimin se meshkujt janë dominues dhe femrat janë të varura ndaj meshkujve. Pritet që gratë të tregojnë bindje dhe respekt ndaj bashkëshortëve të tyre, dhe meshkujt kanë të drejtë të disiplinojnë dhe kontrollojnë bashkëshortet e tyre nëpërmjet çdo mjeti të nevojshëm për ruajtjen e statusit dominues në familje. Në fakt, kërkimet kanë treguar se këndvështrimi mbi gratë si të varura ndaj burrave është një shkak themelor i dhunës në familje ndaj grave. Në fakt, shumë burra dhe gra e shikojnë dhunën si një pjesë normale të një marrëdhënieje intime dhe martesore.

Për të vazhduar me teorinë feministe, dhuna në familje është një manifestim i pabarazisë gjinore që ekziston në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, dhuna në familje shërben që të përjetësojë akoma më tej pabarazinë e grave. Pabarazia gjinore reflektohet gjithashtu në përgjigjen e grave ndaj dhunës në

familje, veçanërisht frikën e tyre për të folur ose për të kërkuar ndihmë për dhunën në familje. Në një periudhë afatgjatë, promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave kanë gjasa të jenë ndërhyrjet kryesore në pakësimin e prekmërisë së grave nga dhuna në familje (34).

Ka shumë argumente mbështetëse në kërkimet për teoritë feministe të dhunës në familje. Prandaj, është e rëndësishme të sfidohet varësia e grave dhe të kundërshtohen sjelljet dhe besimet që falin përdorimin e dhunës nga burri ndaj bashkëshortes së tij, si edhe që parandalojnë ballafaqimin dhe diskutimin brenda komunitetit të abuzimit me bashkëshorten. Është gjithashtu e rëndësishme që të sfidohen sjelljet dhe besimet se fëmijët nuk kanë të drejta si dhe ato që falin ndëshkimet trupore ndaj fëmijëve si një mjet për disiplinimin dhe kontrollimin e fëmijëve. Me fjalë të tjera, parandalimi i dhunës në familje kërkon ndryshimin e besimeve dhe sjelljeve të burrave dhe të grave Shqiptare që mbështesin dominimin mashkullor në marrëdhëniet gjinore dhe që falin dhunën ndaj grave.

Teoritë feministe gjithashtu kërkojnë vendosjen e sanksioneve ndaj dhunimit dhe strehim për gratë e dhunuara, së bashku me fuqizimin shoqëror, ekonomik, ligjor dhe politik të grave (35).

Në përfundim, gjetjet nga kjo anketë kombëtare theksojnë nevojën për veprim nga një gamë e gjerë aktorësh, duke përfshirë qeverinë e Shqipërisë, organizatat kombëtare, OJQ-të lokale, policia, zyrtarët ligjorë dhe gjyqësor, punonjës të përkujdesje shëndetësore, dhe drejtuesit e komunitetit. Fushat në të cilat duhet të punohet përfshijnë:

- fuqizimin e angazhimit dhe veprimit kombëtar në trajtimin e dhunës në familje (p.sh. në promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, si dhe pajtimin me marrëveshjet ndërkombëtare; drejtimin e fushatave efektive të lobimit rreth çështjes së dhunës në familje; themelimin, implementimin dhe monitorimin e përgjigjeve shumë-sektoriale të koordinuar për të trajtuar dhunën në familje; përfshirjen e drejtuesve politik, të komunitetit, fetar dhe të tjerë për të folur kundër dhunës në familje; përmirësimin e kapacitetit të mbledhjes së të dhënave në monitorimin e dhunës në familje);

- promovimin e parandalimit (p.sh., fushata për ndryshimin e sjelljes për të pakësuar dhunën në familje);
- fuqizimin e reagimit të sektorit mjekësor të kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje (p.sh., zhvillimin e një reagimi gjithëpërfshirës të sektorit mjekësor të kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje që do të përmirësonte veprimet e punonjësve mjekësor të kujdesit shëndetësor në identifikimin, trajtimin, mbështetjen, dhe këshillimin e viktimave të dhunës në familje; trajnimin e punonjësve mjekësor të kujdesit shëndetësor mbi problemet e shëndetit fizik, riprodhues dhe mendor të përjetuar nga viktimat e dhunës në familje; zhvillimin e procedurave, protokolleve, dhe mjeteve të vlerësimit për identifikimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje).
- mbështetjen e grave që jetojnë me dhunë në familje dhe ofrimin e mbështetjes dhe shërbimeve ndaj grave që kërkojnë të largohen nga marrëdhëniet e dhunshme së bashku me fëmijët e tyre (p.sh., fuqizimin e mbështetjes së qendrave të ndihmës për gratë që jetojnë me dhunë në familje; ofrimin e shërbimeve strehuese ndaj grave kur ato duan të largohen nga një marrëdhënie e dhunshme; zhvillimin e një sistemi referimi);
- Sensibilizimin e policisë, zyrtarëve ligjorë dhe gjyqësor ndaj dhunës në familje, nevojave të viktimave të dhunës në familje, dhe praktikave më të mira për ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje; dhe
- ndëshkrimin e dhunuesve

Praktikat më të mira mbarëbotërore tregojnë që përfshirja e komunitetit në trajtimin e dhunës në familje sjell presion shoqëror mbi dhunuesit dhe është më e suksesshme për dhënien fund të dhunës në familje sesa metodat e tjera, përfshirë ndëshkrimin ligjor.

## Referenca

1. WHO, 2005, pp. 90-91.
2. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children*. Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
3. Bui & Morash (1999). Domestic Violence in the Vietnamese Immigrant Community: An Exploratory Study. *Violence Against Women*, Vol. 5, No. 7, pp. 769-795.
4. Gleason (1993). Mental Disorders in Battered Women: An Empirical Study. *Violence and Victims*, Vol. 8, pp. 353-368.
5. Snell, Rosenwald & Robey (1964). The Wife Beater's Wife: A Study of Family Interaction. *Archives of General Psychiatry*, Vol. 11, pp. 107-112.
6. Walker (1979). *Battered Women*. New York: Harper and Row.
7. Weitzman & Dreen (1982). Wife Beating: A Review of the Marital Dyad. *Social Casework*, Vol. 36, pp. 259-265.
8. Bui & Morash, 1999, p. 771.
9. Gelles & Cornell (1990). *Intimate Violence in Families*. Newbury Park, CA: Sage Publications.
10. Bui & Morash, 1999, p. 771.
11. Gelles (1993). Alcohol and Other Drugs are Associated with Violence – They are not its Cause. In Gelles & Loseke (Eds.), *Current Controversies on Family Violence* (pp. 182-196). Newbury Park, CA: Sage Publications.
12. Bui & Morash, 1999, p. 771.
13. Bui & Morash, 1999, p. 771.
14. Bui & Morash, 1999, p. 772.
15. Dobash & Dobash (1979). *Violence Against Wives: A Case Against the Patriarchy*. New York: Free Press.
16. Straus, Gelles & Steinmetz (1980). *Behind Closed Doors: Violence in the American Family*. New York: Anchor.
17. Bui & Morash, 1999, p. 771.
18. Bui & Morash, 1999, p. 771.
19. Ceaser (1998). Exposure to Violence in the Families of Origin Among Wife Abusers and Maritally Non-Violent Men. *Violence and Victims*, Vol. 3, pp. 49-63.
20. Straus et al., 1980.
21. Bui & Morash, 1999, p. 771.
22. Bui & Morash, 1999, p. 772.
23. Dobash & Dobash, 1979.
24. Bui & Morash, 1999, p. 772.
25. Dobash & Dobash, 1979.
26. Smith (1990). Patriarchal Ideology and Wife Beating: A Test of Feminist Hypothesis. *Violence and Victims*, Vol. 5, pp. 257-273.
27. Bui & Morash, 1999, p. 772.
28. Haarr (2007). Wife Abuse in Tajikistan. *Feminist Criminology*, Vol. 2, No. 3, pp. 245-270.
29. Hegland (1992). Wife Abuse and the Political System: A Middle Eastern Case Study. In Counts, Brown & Campbell (Eds.), *Sanctions and Sanctuary: Cultural Perspectives on the*



- Beating of Wives* (pp. 203-227). Boulder, CO: Westview.
30. Abraham (2002). *Speaking the Unspeakable: Wife Abuse among South Asian Immigrants in the United States*. Rutgers, NJ: Rutgers University Press.
  31. Bui & Morash, 1999, p. 772.
  32. Bui & Morash, 1999, pp. 772-773.
  33. Levinson (1989). *Family Violence in Cross-Cultural Perspective*. Newbury, CA: Sage Publications.
  34. World Health Organization, *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence against Women* (Geneva, Switzerland: WHO, 2005).
  35. WHO, 2005.

## Tabelat e shtojcës

**Tabela shtojcë 1. Arsimimi dhe statusi i punësimit të grave sipas vendbanimit urban kundrejt atij rural**

	Nr=2590				Testi i rëndësisë	
	Urban		Rural		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
Arsimi	nr	%	Nr	%		
Pa arsim	4	.3	1	.1	302.91	.00
Arsim fillor	23	1.6	12	1.1		
Arsim 9-vjeçar	495	33.7	743	66.7		
Arsim të mesëm	683	46.5	312	28.0		
Arsim universitar	262	17.8	46	4.1		
<b>Statusi i punësimit</b>						
Punësim jashtë shtëpisë*	684	46.4	368	32.9	48.56	.00
Po, por me leje lindjeje	12	.8	8	.7		
Nuk punon jashtë shtëpisë	777	52.7	741	66.3		

\* Raportuan se punonin jashtë shtëpisë për të paktën 20 orë në javë gjatë muajit të fundit

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 2. Arsimimi dhe statusi i punësimit të grave sipas vendbanimit urban kundrejt atij rural**

	Nr=2590				Testi i rëndësisë	
	Mashkull		Femër		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
Vendbanimi	nr	%	nr	%		
Urban	271	54.0	239	48.9	2.59	.06
Rural	231	46.0	250	51.1		
<b>Mosha</b>						
10 vjeç	99	19.7	92	18.8	1.42	.84
11 vjeç	106	21.1	96	19.6		
12 vjeç	99	19.7	91	18.6		
13 vjeç	98	19.5	108	22.1		
14 vjeç	100	19.9	102	20.9		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 3. Format e ndryshme të abuzimit emocional të përjetuara nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç**

Numri i formave të abuzimit emocional	Nr=2,590	
	nr	%
Asnjë abuzim emocional	350	13.5
Një formë	445	17.2
Dy forma	356	13.7
Tre forma	190	7.3
Katër forma	174	6.7
Pesë forma	75	2.9
Gjashtë forma	27	1.0
Shtatë forma	44	1.7

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=929; 35,5%)

Shënim: Format e abuzimit emocional përfshijnë: xhelozinë ose nevrikosjen nëse jeni parë duke i folur burrave të tjerë; akuzime për mungesë ndershmërie; vë në dyshim besnikërinë tuaj ndaj tij; ju bërtet dhe ju ofendon; thotë ose bën gjëra që t'ju poshtërojnë përpara të tjerëve; ju injoron; ju flet në një mënyrë që ju bën të ndiheni keq ose e pavlerë.

**Tabela shtojcë 4. Abuzimi emocional sipas demografisë së grave**

	Nr=1,661				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi emocional					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Grupmosha</b>					6.69	.57
15-17 vjeç	8	100.0	0	0.0		
18-21 vjeç	40	74.1	14	25.9		
22-25 vjeç	93	73.8	33	26.2		
26-29 vjeç	141	78.8	38	21.2		
30-33 vjeç	191	81.3	44	18.7		
34-37 vjeç	203	79.3	53	20.7		
38-41 vjeç	203	81.2	47	18.8		
42-45 vjeç	180	77.9	51	22.1		
46-49 vjeç	252	78.3	70	21.7		
<b>Gjendja civile</b>					5.39	.07
E martuar/bashkëjeton me dikë	1,272	78.8	343	21.2		
E divorcuar/e ndarë	39	86.7	6	13.3		
<b>Niveli arsimor</b>					45.74	.00
Pa arsim	3	75.0	1	25.0		
Arsim fillor	17	77.3	5	22.7		
Arsim 9-vjeçar	652	83.5	129	16.5		
Arsim të mesëm	518	78.6	141	21.4		
Arsim universitar	115	61.2	73	38.8		

<b>Statusi i punësimit</b>						
Punon jashtë shtëpisë	530	74.3	183	25.7	16.22	.00
Po, por me leje lindjeje	13	76.5	4	23.5		
Nuk punon jashtë shtëpisë	768	82.5	163	17.5		
<b>Vendbanimi</b>						
Urban	690	75.4	225	24.6	15.17	.00
Rural	621	83.2	125	16.8		

\* Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=929; 35,5%)

**Tabela shtojcë 5. Format e ndryshme të abuzimit psikologjik të përjetuara nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç**

<b>Numri i formave të abuzimit psikologjik</b>	<u>Nr=2590</u>	
	<u>nr</u>	<u>%</u>
Asnjë abuzim psikologjik	804	31.0
Një formë	456	17.6
Dy forma	277	10.7
Tre forma	156	6.0
Katër forma	53	2.0
Pesë forma	15	.6
Gjashtë forma	6	.2

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=929; 31,0%)

Shënim: Format e abuzimit psikologjik përfshijnë: nuk ju jep para; nuk ju lejon që të takoni shoqet; kufizon kontaktin me familjen tuaj; insiston që të vihet në dijeni për vendndodhjen tuaj gjatë të gjithë kohës; kërcënon se do t'ju lëndojë juve ose dikë të afërt për ju; ju kërcënon me thikë ose me një armë tjetër.

**Tabela shtojcë 5. Format e ndryshme të abuzimit psikologjik të përjetuara nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç**

<b>Numri i formave të abuzimit psikologjik</b>	<u>Nr=2590</u>	
	<u>nr</u>	<u>%</u>
Asnjë abuzim psikologjik	804	31.0
Një formë	456	17.6
Dy forma	277	10.7
Tre forma	156	6.0
Katër forma	53	2.0
Pesë forma	15	.6
Gjashtë forma	6	.2

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=929; 31,0%)

Shënim: Format e abuzimit psikologjik përfshijnë: nuk ju jep para; nuk ju lejon që të takoni shoqet; kufizon kontaktin me familjen tuaj; insiston që të vihet në dijeni për vendndodhjen tuaj gjatë të gjithë kohës; kërcënon se do t'ju lëndojë juve ose dikë të afërt për ju; ju kërcënon me thikë ose me një armë tjetër.

Tabela shtojcë 6. Abuzimi psikologjik sipas demografisë së grave

	Nr=1823				Testi i rëndësisë	
	Psychological abuse					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Grupmosha</b>						
15-17 vjeç	7	77.8	2	22.2	7.69	.47
18-21 vjeç	34	54.8	28	45.2		
22-25 vjeç	76	56.7	58	43.3		
26-29 vjeç	113	59.2	78	40.8		
30-33 vjeç	149	56.2	116	43.8		
34-37 vjeç	166	59.7	112	40.3		
38-41 vjeç	153	54.3	129	45.7		
42-45 vjeç	136	52.9	121	47.1		
46-49 vjeç	179	51.9	166	48.1		
<b>Gjendja civile</b>						
E martuar/bashkëjeton me dikë	976	55.0	799	45.0	9.46	.01
E divorcuar/e ndarë	36	76.6	11	23.4		
<b>Niveli arsimor</b>						
Pa arsim	2	66.7	1	33.3	10.03	.07
Arsim fillor	15	62.5	9	37.5		
Arsim 9-vjeçar	486	56.9	368	43.1		
Arsim të mesëm	412	56.2	321	43.8		
Arsim universitar	93	46.0	109	54.0		
<b>Statusi i punësimit</b>						
Punon jashtë shtëpisë	414	52.9	368	47.1	3.84	.15
Po, por me leje lindjeje	9	56.3	7	43.8		
Nuk punon jashtë shtëpisë	590	57.6	435	42.4		
<b>Vendbanimi</b>						
Urban	569	55.8	450	44.2	.07	.42
Rural	444	55.2	360	44.8		

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 7. Format e ndryshme të dhunës fizike të përjetuara nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç

	Nr=2590	
	nr	%
<b>Numri i formave të dhunës fizike</b>		
Asnjë dhunë fizike	1180	45.6
Një formë	331	12.8
Dy forma	254	9.8

Tre forma	130	5.0
Katër forma	37	1.4
Pesë forma	29	1.1
Gjashtë forma	27	1.0

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=602; 23,2%)

Shënim: Format e dhunës fizike përshijnë: ju hedh ose ju shtyn, ju rreh, ju shkul flokët, ju godet me një objekt ose diçka tjetër që mund t'ju lëndoje, ju gjuan me shkelm ose ju tërheq zvarrë, është përpjekur t'ju mbysë ose t'ju djegë.

**Tabela shtojcë 8. Dhuna fizike sipas demografisë së grave**

	Nr=1988				Testi i rëndësisë	
	Dhuna fizike					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Grupmosha</b>					48.40	.00
15-17 vjeç	2	22.2	7	77.8		
18-21 vjeç	10	15.6	54	84.4		
22-25 vjeç	32	22.1	113	77.9		
26-29 vjeç	80	38.8	126	61.2		
30-33 vjeç	133	46.8	151	53.2		
34-37 vjeç	139	45.4	167	54.6		
38-41 vjeç	124	40.0	186	60.0		
42-45 vjeç	121	43.2	159	56.8		
46-49 vjeç	167	43.5	217	56.5		
<b>Gjendja civile</b>					14.47	.00
E martuar/bashkëjeton me dikë	776	40.0	1,163	60.0		
E divorcuar/e ndarë	32	66.7	16	33.3		
<b>Niveli arsimor</b>					48.11	.00
Pa arsim	2	50.0	2	50.0		
Arsim fillor	19	70.4	8	29.6		
Arsim 9-vjeçar	422	44.7	523	55.3		
Arsim të mesëm	314	39.8	474	60.2		
Arsim universitar	48	22.1	169	77.9		
<b>Statusi i punësimit</b>					2.15	.34
Punon jashtë shtëpisë	346	39.4	533	60.6		
Po, por me leje lindjeje	5	29.4	12	70.6		
Nuk punon jashtë shtëpisë	457	41.8	635	58.2		
<b>Vendbanimi</b>					31.23	.00
Urban	385	35.1	712	64.9		
Rural	423	47.5	468	52.5		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 9. Format e ndryshme të dhunës seksuale të përjetuara nga gratë e moshës 15 deri në 49 vjeç**

Numri i formave të dhunës fizike	Nr=2590	
	nr	%
Asnjë dhunë seksuale	1658	64.0
Një formë	298	11.5
Dy forma	32	1.2

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=602; 23,2%)

Shënim: Format e dhunës seksuale përshijnë: ju detyron që të kryeni marrëdhënie seksuale kur ju nuk doni, dhe ju detyron të kryeni veprime poshtëruese seksuale, të cilat ju nuk doni t'i kryeni.

**Tabela shtojcë 10. Dhuna seksuale sipas demografisë së grave**

	Nr=1988				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po	Jo			$\chi^2$	Rëndësia
Grupmosha	n	%	n	%		
15-17 vjeç	0	0.0	9	100.0	18.65	.02
18-21 vjeç	4	6.3	60	93.8		
22-25 vjeç	11	7.6	134	92.8		
26-29 vjeç	37	18.0	169	82.0		
30-33 vjeç	50	17.6	234	82.4		
34-37 vjeç	49	16.0	257	84.0		
38-41 vjeç	55	17.7	255	82.3		
42-45 vjeç	49	17.5	231	82.5		
46-49 vjeç	75	19.5	309	80.5		
<b>Gjendja civile</b>						
E martuar/bashkëjeton me dikë	314	16.2	1625	83.8	10.14	.01
E divorcuar/e ndarë	16	33.3	32	66.7		
<b>Niveli arsimor</b>						
Pa arsim	1	25.0	3	75.0	3.36	.65
Arsim fillor	6	22.2	21	77.8		
Arsim 9-vjeçar	166	17.6	779	82.4		
Arsim të mesëm	128	16.2	660	83.8		
Arsim universitar	29	13.4	188	86.6		
<b>Statusi i punësimit</b>						
Punon jashtë shtëpisë	154	17.5	725	82.5	1.00	.61
Po, por me leje lindjeje	3	17.6	14	82.4		
Nuk punon jashtë shtëpisë	173	15.8	919	84.2		
<b>Vendbanimi</b>						
Urban	178	16.2	919	83.8	.25	.33
Rural	152	17.1	739	82.9		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 11. Lidhja ndërmjet abuzimit emocional dhe abuzimit psikologjik**

	Nr.=1587				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi psikologjik					
	Po		Jo			
Abuzim emocional	n	%	n	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	751	60.6	489	39.4	203.18	.00
Jo	60	17.3	287	82.7		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 12. Lidhja ndërmjet abuzimit emocional dhe dhunës fizike**

	Nr.=1661				Testi i rëndësisë	
	Dhuna fizike					
	Po		Jo			
Abuzimi emocional	nr	%	Nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	588	44.9	723	55.1	233.27	.00
Jo	3	.9	347	99.1		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 13. Lidhja ndërmjet abuzimit emocional dhe dhunës seksuale**

	N=1661				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo			
Abuzimi emocional	nr	%	Nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	196	15.0	1115	85.0	56.83	.00
Jo	1	.3	349	99.7		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 14. Lidhja ndërmjet abuzimit psikologjik dhe abuzimit emocional**

	Nr.=1587				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi emocional					
	Po		Jo			
Abuzimi psikologjik	nr	%	Nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	751	92.6	60	7.4	203.18	.00
Jo	489	63.0	287	37.0		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.



**Tabela shtojcë 15. Lidhja ndërmjet abuzimit psikologjik dhe dhunës fizike**

	N=1823				Testi i rëndësisë	
	Dhuna fizike					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	Nr	%			
Abuzimi psikologjik						
Po	573	56.6	440	43.4	328.66	.00
Jo	122	15.1	688	84.9		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 16. Lidhja ndërmjet abuzimit psikologjik dhe dhunës seksuale**

	N=1823				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
Abuzimi psikologjik						
Po	243	24.0	770	76.0	149.92	.00
Jo	28	3.5	782	96.5		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 17. Lidhja ndërmjet abuzimit fizik dhe abuzimit emocional**

	Nr=1661				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi emocional					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
Dhuna fizike						
Po	588	99.5	3	.5	233.27	.00
Jo	723	67.6	347	32.4		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 18. Lidhja ndërmjet dhunës fizike dhe abuzimit psikologjik**

	Nr=1823				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi psikologjik					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
Dhuna fizike						
Po	573	82.4	122	17.6	328.66	.00
Jo	440	39.0	688	61.0		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 19. Lidhja ndërmjet dhunës fizike dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

	N=1988				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo			
Dhuna fizike	nr	%	nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	289	35.8	519	64.2	361.26	.00
Jo	41	3.5	1,139	96.5		

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 20. Lidhja ndërmjet dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës në familje**

	Nr=1661				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi emocional					
	Po		Jo			
Dhuna seksuale	nr	%	nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	196	99.5	1	.5	56.83	.00
Jo	1,115	76.2	349	23.8		

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 21. Lidhja ndërmjet dhunës seksuale dhe abuzimit psikologjik**

	N=1823				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi psikologjik					
	Po		Jo			
Dhuna seksuale	nr	%	nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	243	89.7	28	10.3	149.92	.00
Jo	28	77.0	49.6	50.4		

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 22. Lidhja ndërmjet dhunës seksuale dhe dhunës fizike**

	Nr=1988				Testi i rëndësisë	
	Dhuna fizike					
	Po		Jo			
Dhuna seksuale	nr	%	nr	%	$\chi^2$	Rëndësia
Po	289	87.6	41	12.4	361.26	.00
Jo	519	31.3	1,139	68.7		

\*Shënim: Përçindjet e krahasimit bazohen në përçindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 23. Lidhja ndërmjet dhunës fizike dhe seksuale dhe dëmtimeve nga dhuna në familje**

	N=808		N=330	
	Dhuna fizike		Dhuna seksuale	
Prerje, mavijosje, dhembje	nr	%	nr	%
Po	299	37.0	144	43.6
Jo	477	59.0	154	46.7
Dëmtime të syve, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh				
Po	87	10.8	54	16.4
Jo	689	85.3	244	73.9
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz				
Po	8	1.1	3	.9
Jo	767	94.9	295	89.4
Humbje e ndjenjave				
Po	36	4.5	16	4.8
Jo	740	91.6	282	85.5

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=32; 4,0% dhunë fizike; 9,7% dhunë seksuale)

**Tabela shtojcë 24. Dëmtimet e lidhura me dhunën në familje sipas shkëputjes nga puna**

Dëmtimet	Nr=820				Testi i rëndësisë	
	E paaftë për të punuar për shkak të dëmtimit					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
Prerje, mavijosje, dhembje	78	25.9	233	74.1	120.54	.00
Dëmtime të syve, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh	44	50.6	43	49.4	166.60	.00
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz	6	66.7	3	33.3	30.59	.00
Humbje e ndjenjave	19	52.8	17	47.2	71.73	.00

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 25. Dëmtimet e lidhura me dhunën në familje sipas numrit të ditëve të paaftësisë për punë**

Dëmtimet	Nr=84						Testi i rëndësisë	
	Nr. i ditëve të paaftësisë për punë							
	1-4 ditë		5-9 ditë		10-15 ditë		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%	nr	%			
Prerje, mavijosje, dhembje	62	81.6	11	14.5	3	3.9	1.96	.38
Dëmtime të syve, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh	29	69.0	10	23.8	3	7.1	5.98	.05
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz	0	0.0	2	50.0	2	50.0	24.64	.00
Humbje e ndjenjave	10	58.8	4	23.5	3	17.6	9.50	.01

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 26. Lidhja ndërmjet llojeve të dëmtimeve

	Nr=820				Testi i rëndësisë	
	Dëmtime të syve,djegje,ndrydhje,nxjerrje gjymtyrësh					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Prerje,mavijosje,dhembje</b>					138.72	.00
Po	82	94.3	5	5.7		
Jo	219	29.9	514	70.1		
<b>Plagë të thella,kocka të thyera,dhëmbë të thyer,dëmtim serioz</b>					76.67	.00
Po	9	10.3	78	89.7		
Jo	0	0.0	733	100.0		
<b>Humbje e ndjenjave</b>					150.71	.00
Po	26	29.9	61	70.1		
Jo	10	1.4	723	98.6		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 27. Lidhja ndërmjet dhunimit seksual dhe kontrollit të kontraktivëve nga ana e bashkëshortit/partnerit intim

	Nr=377				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Bashkëshorti/partneri refuzon përdorimin e kontraktivëve</b>					8.92	.01
Po	12	21.1	26	8.1		
Jo	45	78.9	294	91.9		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 28. Lidhja ndërmjet dhunimit seksual dhe SST-ve

	Nr=1988				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Rreziku i SST-ve</b>					103.46	.00
Po	20	6.1	49	3.0		
Jo	210	63.6	1,435	86.6		
<b>Vuan nga ndonjë SST</b>					48.45	.00
Po	101	30.6	244	14.7		
Jo	229	69.4	1,414	85.3		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 29. Konsumimi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri intim

Konsumimi i alkoolit	Nr=2590	
	nr	%
Po	988	38.1
Jo	1040	40.2
<b>Shpeshtësia e dehjes</b>		
Shpesh	119	4.6
Ndonjëherë	683	26.4
Asnjëherë	186	7.2

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (n=562, 21,7% konsumim alkooli; n=1602, 61,9% shpeshtësia e dehjes)

Tabela shtojcë 30. Konsumimi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri intim dhe dhuna në familje

	Konsumimi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri				Testi i rëndësisë	
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
	nr	%	nr	%		
<b>Abuzimi emocional</b>						
Po	698	88.7	613	70.1	85.72	.00
Jo	89	11.3	261	29.9		
<b>Abuzimi psikologjik</b>						
Po	586	66.2	427	45.5	78.97	.00
Jo	299	33.8	511	54.5		
<b>Dhuna fizike</b>						
Po	550	56.0	258	25.6	189.89	.00
Jo	432	44.0	748	74.4		
<b>Dhuna seksuale</b>						
Po	230	23.4	100	9.9	65.24	.00
Jo	752	76.6	906	90.1		

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 31. Konsumimi i alkoolit nga bashkëshortit/partnerit intim dhe dëmtimet e lidhura me dhunën në familje mes grave të dhunuara seksualisht dhe/ose fizikisht

	Nr=817				Testi i rëndësisë	
	Konsumimi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri				χ <sup>2</sup>	Rëndësia
	Po		Jo			
Të prera, mavijosje, dhembje	nr	%	nr	%		
Po	249	45.4	51	19.0	54.44	.00
Jo	299	54.6	218	81.0		
<b>Dëmtime të syve, djegie, ndrydhje, nxjerrje gjymtyrësh</b>						
Po	80	14.6	7	2.6	27.29	.00
Jo	468	85.4	262	97.4		

<b>Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, dëmtim serioz</b>						
Po	8	1.5	1	.4	1.96	.15
Jo	540	98.5	268	99.6		
<b>Humbje e ndjenjave</b>						
Po	34	6.2	2	.7	12.77	.00
Jo	514	93.8	267	99.3		

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

\* Të dhëna që mungojnë në sistem (nr=32; 3,8%)

**Tabela shtojcë 32. Gratë e abuzuara emocionalisht sipas demografisë së bashkëshortit.**

	Nr=1567				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi emocional					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Niveli arsimor</b>					74.86	.00
Pa arsim	1	.1	0	0.0		
Me arsim fillor	18	1.5	7	2.1		
Me arsim 9-vjeçar	570	46.1	110	33.3		
Me arsim të mesëm	559	45.2	139	42.1		
Me arsim universitar	82	6.6	73	22.1		
<b>Statusi i punësimit</b>					.04	.45
Punon jashtë shtëpisë	1046	84.7	278	84.2		
Nuk punon jashtë shtëpisë	189	15.3	52	15.8		

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela shtojcë 33. Gratë e abuzuara psikologjikisht sipas demografisë së bashkëshortit**

	N=1722				Testi i rëndësisë	
	Abuzimi psikologjik					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Niveli arsimor</b>					9.80	.08
Pa arsim	2	.2	0	0.0		
Me arsim fillor	14	1.5	10	1.3		
Me arsim 9-vjeçar	418	44.3	316	40.6		
Me arsim të mesëm	425	45.1	352	45.2		
Me arsim universitar	80	8.5	97	12.5		
<b>Statusi i punësimit</b>					16.35	.00
Punon jashtë shtëpisë	829	88.0	630	81.0		
Nuk punon jashtë shtëpisë	113	12.0	148	19.0		

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 34. Dhuna fizike sipas demografisë së bashkëshortit

	N=1881				Testi i rëndësisë	
	Dhuna fizike					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Niveli arsimor</b>						
Pa arsim	1	.1	1	.1	53.04	.00
Me arsim fillor	15	2.0	13	1.2		
Me arsim 9-vjeçar	378	49.5	435	38.9		
Me arsim të mesëm	331	43.4	509	45.5		
Me arsim universitar	35	4.6	155	13.9		
<b>Statusi i punësimit</b>						
Punon jashtë shtëpisë	650	85.3	948	84.9	.06	.43
Nuk punon jashtë shtëpisë	112	14.7	169	15.1		

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 35. Gratë e dhunuara fizikisht sipas demografisë së bashkëshortit

	N=1881				Testi i rëndësisë	
	Dhuna seksuale					
	Po		Jo		χ <sup>2</sup>	Rëndësia
nr	%	nr	%			
<b>Niveli arsimor</b>						
Pa arsim	1	.3	1	.1	8.78	.12
Me arsim fillor	8	2.6	20	1.3		
Me arsim 9-vjeçar	145	46.8	668	42.5		
Me arsim të mesëm	132	42.6	708	45.1		
Me arsim universitar	23	7.4	167	10.6		
<b>Statusi i punësimit</b>						
Punon jashtë shtëpisë	264	1.41	1,334	85.0	.00	.52
Nuk punon jashtë shtëpisë	46	14.8	235	15.0		

\* Shënim: Përqindjet e krahasimit bazohen në përqindje të vlefshme dhe nuk i pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela shtojcë 36. Kërkimi i ndihmës nga gratë e dhunuara sipas llojit të dhunës në familje

	Kërkimi i ndihmës për dhunën në familje				Testi i rëndësisë	
	Po		Jo			
	nr	%	nr	%	χ <sup>2</sup>	Rëndësia
<b>Abuzimi emocional</b>						
Po	130	16.8	646	83.2	7.89	.00
Jo	3	4.2	69	95.8		
<b>Abuzimi psikologjik</b>						
Po	143	20.0	572	80.0	30.34	.00
Jo	14	5.4	247	94.6		

<b>Dhuna fizike</b>						
Po	159	19.7	649	80.3	39.88	.00
